

# Pulsi gjinor i mediave në fushatën zgjedhore

Monitorimi mediatik i zgjedhjeve  
parlamentare në Mal të Zi 2023 me  
fokus në perspektivën gjinore



Podgoricë, 2023.

# PULSI GJINOR I MEDIAVE NË FUSHATËN ZGJEDHORE

Monitorimi mediatik i zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi 2023 me fokus në perspektivën gjinore

## Botuesi:

Qendra për Arsim Qytetar (QAQ)



## Redakotre:

Daliborka Ulareviq

## Autorët/et:

Milica Zindoviq  
Damir Nikoçeviq  
Jelena Jovanoviq Maroviq  
Dajana Zeçeviq  
Danijell Radeviq  
Ollivera Komar  
Dejana Ponosh  
Mirjana Ivanoviq Boshkoviq

## Bashkpunëtorët:

Nikolla Gjurasheviq  
Nikolla Obradoviq

## Përktheu në gjuhën shqipe:

Monika Mrnjaçeviq

## Dizajni dhe produksioni:

Qendra për Arsim Qytetar (QAQ)

Publikimi është pjesë e projektit “SPINoFACT 7 - Monitorimi mediatik i zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi 2023 me fokus në perspektivën gjinore”, të cilin QAQ e zbaton me mbështetjen e Qeverisë së RF të Gjermanisë.



Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e QAQ-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të interpretohet si qëndrim zyrtar i Qeverisë së RF të Gjermanisë dhe as Ambasadës së RF të Gjermanisë në Podgoricë.

# **Pulsi gjinor i mediave në fushatën zgjedhore**

Monitorimi mediatik i zgjedhjeve  
parlamentare në Mal të Zi 2023  
me fokus në perspektivën gjinore

Podgoricë, 2023.

# Përmbajtja

<b>PËRMBAJTJA</b> _____	<b>4</b>	qartël – Partia Boshnjake _____	<b>45</b>
<b>HYRJE</b> _____	<b>5</b>	<b>ADRIJAN VUKSANOVIC, bartës i listës NCK</b> – Në anë të drejtë të botës _____	<b>49</b>
<b>TEMA E BARAZISË GJINORE</b> <b>NË PROGRAMET ZGJEDHORE</b> _____	<b>7</b>	<b>VLLADIMIR LLEPOSAVIQ, bartës i listës</b> „Drejtësi për të gjithë!“ _____	<b>53</b>
<b>Përçindja e grave në lista</b> <b>rreth minimumit ligjor</b> _____	<b>10</b>	<b>VLLADIMIR JOKOVIC, bartës i listës PPS –</b> <b>DEMOS – PËR TY</b> _____	<b>60</b>
<b>MEDIAT TË INTERESUAR PËR FUSHATËN,</b> <b>PARTITË NUK KOMUNIKOJNË ÇESHTJEN</b> <b>E BARAZISË GJINORE</b> _____	<b>15</b>	<b>DEJAN VUKSHIQ, bartës i listës</b> „KOALICIONI POPULLOR – BASHKË DHE PIKË“ (Dejan Vukshiq – Levizja Demokratike e Krishterë; Marko Millaçiq – Mali i Zi i Vërtetë; Vlladisllav Dajković – Mali i Zi i Lirë; Dragica Perović – Partia Demokratike Serbe; dr Novica Stanić – Levizja për Plevlën) _____	<b>64</b>
Përmbledhja e përgjithshme _____	15	<b>GENCI NIMANBEGU, bartës i</b> listës Aleanca Shqiptare _____	<b>68</b>
Analiza e pranisë së mediave të listave zgjedhore _____	16	<b>SRGJAN PERIQ, bartës i listës Kthesë për</b> një Mal të Zi të sigurt _____	<b>73</b>
Përfaqësimi i temave në fushatën zgjedhore _____	18	<b>DRAGICA PEROVIC IVANOVIQ, bartëse</b> e listës „Po. Ne mundemi për Malin e Zi qytetarë“ _____	<b>76</b>
Vlerësimi cilësor – barazia gjinore _____	23	<b>DANIJELL ZHIVKOVIQ, bartës i listës</b> BASHKË! Për të ardhmen që të takon (PDS, SD, UDSH, PL) _____	<b>80</b>
Analiza e pranisë së grave dhe burrave në billborde dhe në spotet televizive _____	26	<b>MILLOJKO SPAJIQ, bartës i listës Evropa</b> tani _____	<b>85</b>
Vlerësimi cilësor i vizualizmit të njoftimeve mediatike _____	29	<b>NIKOLLA GJURASHKOVIQ, bartës i listës</b> PSD – Për shtëpinë tonë _____	<b>87</b>
Monitorimi i reklamave _____	30		
<b>BRAZIA GJINORE E HARRUAR</b> <b>NË RRJETET SOCIALE</b> _____	<b>34</b>		
<b>PYETJET MBI BARAZINË GJINORE DHE</b> <b>PJESËMARRJES POLITIKE TË GRAVE</b> <b>NËPËRMJET VIZIONIT TË UDHËHEQËSVE/</b> <b>EVE TË LISTAVE PËR ZGJEDHJET</b> <b>PARLAMENTARE</b> _____	<b>44</b>	<b>REKOMANDIME PËR RAPORTIMIN</b> <b>MEDIATIK TË GRAVE NË PROCESET</b> <b>ZGJEDHORE</b> _____	<b>92</b>
ERVIN IBRAHIMOVIQ, bartës i listës Është e			

# Hyrje

Në ciklin zgjedhor, zakonisht përmendet vetëm rezultati, ndërsa shumë rrallë përmbajtja e fushatës në kuptimin e mesazheve kyçe dhe programeve zgjedhore. Temat mbi barazinë gjinore mbeten në margjina, siç tregojnë edhe zgjedhjet e fundit të jashtëzakonshme parlamentare në Mal të Zi të mbajtura më 11 qershor 2023.

Tema e barazisë gjinore, por edhe marrëdhënia mes partive politike dhe mediave, ndikojnë në masë të madhe në realitetin shoqëror. Informimi objektivë dhe i pa-diskriminueshëm i opinionit për proceset zgjedhore është shumë i rëndësishëm për përmirësimin e kulturës politike në përgjithësi. Përmes projektit “SPINoFACT 7 - Monitorimi mediatik i zgjedhjeve parlamentare në Mal të Zi 2023 me fokus në perspektivën gjinore”, i realizuar nga Qendra për Arsimit Qytetar (QAQ), me mbështetjen e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Mal të Zi, synimi ishte të vihej në fokus publik mbulimi mediatik i përgjegjshëm gjinor, si pjesë e promovimit të pjesëmarrjes politike të grave, sidomos në kontekstin e rritjes së mizogjinisë në Mal të Zi, e cila tashmë ka efekt të përmbysëm në angazhimin e grave në çështjet publike. Po ashtu, synimi ishte të nxisë diskutimin mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, sidomos profesionistëve të medias, organizatave jo-qeveritare dhe përfaqësuesve të partive politike, lidhur me çështje të rëndësishme të raportimit të mediave gjatë fushatës për zgjedhjet parlamentare të vitit 2023 në Mal të Zi.

Gjetjet e monitorimit të mediave bëjnë të ditur nënvlerësimin e çështjeve të barazisë gjinore në komunikimin politik publik. Gjatë fushatës, janë regjistruar vetëm 178 ose 2% postime të lidhura me barazinë gjinore, ndërsa vetëm 3% e postimeve mediatike ka krijuar një imazh pozitiv për gratë. Kjo fushatë është karakterizuar edhe nga një atmosferë më e qetë në krahasim me ciklet zgjedhore të mëparshme, por kjo nuk ka ndihmuar mediat të tregohen më neutrale dhe të balancuara në raportimin e tyre, edhe pse ka pasur disa përmirsime të dukshme.

Gjatë zgjatjes së projektit, kemi bërë dhe analizën e programeve zgjedhore të listave dhe kemi konstatuar se tema e barazisë gjinore nuk është e përfaqësuar në to. Po ashtu, përqindja e grave në listat ishte rreth minimumit ligjor. Përmes intervistave me udhëheqësit/et e listave zgjedhore, kemi marrë pikëpamjet e tyre mbi çështjet e barazisë gjinore, dhe këto intervista janë pjesë integrale e këtij publikimi.

Monitorimi i mediave që u realizua me ndihmën profesionale të agjencisë Arhimed përfshiu 25 institucione mediatike, më së shumti deri tani që kur QAQ ka kryer monitorim të ngjashëm. Në raportimin e 10 kanaleve televizive, 3 gazetave ditore dhe 12 portaleve janë evidentuar dhe analizuar 9861 postime mediatike. Të dhënat e marrura japin përgjigjen se si listat zgjedhore komunikonin çështjet e barazisë gjinore, si u trajtua pjesëmarrja politike e grave në media, por edhe më gjerësisht si mediat raportuan për listat zgjedhore. Është e dukshme që partitë politike dhe koalicionet më të mëdha kanë krijuar më së shumti postime mediatike, si pozitive ashtu edhe negative. Analiza e

përmbajtjes mediatike tregon edhe polarizimin brenda mediave në Mal të Zi, me tifozeri të dukshme në raportim në vend të raportimit të balancuar. Përveç analizës së reklamave të partive politike në televizion, stacione radio, media të shkruara, rrjetet sociale, dhe vendosjes së bilbordeve reklamash, kemi llogaritur gjithashtu kuj i ka „kushtuar“ më shumë dhe kuj më pak një mandat deputeti në këtë pjesë.

Grupi i 6 monitorëve të pavarur nga shoqëria civile dhe komuniteti mediatik, të punësuar nga QAQ, ka ndjekur fushatën në rrjetet sociale - Facebook, Twitter dhe Instagram - ku janë analizuar më shumë se 6600 postime, dhe janë ndjekur afërsisht 120 faqe zyrtare të partive politike, listave zgjedhore, koalicioneve, liderëve/eve të listave. Fatkeqësisht, pati shumë pak njoftime që synonin promovimin e barazisë gjinore.

Billbordët janë njohur si mjet i rëndësishëm i komunikimit politik, dhe janë analizuar në të gjitha komunat e Malit të Zi në kuptimin e prezencës së grave, si dhe në raportin midis figurave mashkullore dhe femërore, në bilborde dhe spote televizive.

Për më tepër, pjesë të veçantë të projektit përbëjnë 11 infografikë, por edhe video animacioni që përmbledh gjetjet kyçe të të gjitha hulumtimeve. Besojmë që këto materiale informuese dhe të disponueshme do të jenë një gjurmë e vlefshme për analiza krahasuese gjatë cikleve zgjedhore të ardhshme.

Barazia gjinore është një parim themelor i shoqërisë moderne, dhe procesi zgjedhor dhe mediat kanë rolin kyç në promovimin e saj. Qëllimi i projektit ishte të hidhte dritë mbi rëndësinë dhe pozicionin e kësaj çështjeje në Mal të Zi, e gjitha kjo si pjesë e një kontributi në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë. Në këtë kontekst, stereotipet e ndjeshme gjinore duhet të thyhen çdo ditë, veçanërisht përmes partive politike dhe proceseve zgjedhore, sepse kjo është hapësira që mundëson ose pengon dukshëm përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në pozitë vendimmarrëse. Kuotat nuk janë të mjaftueshme, dhe këtë e tregon përbërja e re e Kuvendit, që kishte vetëm 21% gra në seancën konstituive.

Publikimi *“Pulsi gjinor i mediave në fushatat zgjedhore”* është një nga pjesët mozaike të kësaj teme komplekse që duhet të jetë më në fokus për të gjithë ne. Shprehim falënderim të veçantë ndaj Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë në Mal të Zi, që e ka njohur dhe e ka mbështetur këtë projekt.

# Tema e barazisë gjinore në programet zgjedhore

**Çështjet e barazisë gjinore dhe të drejtave të grave, si dhe pozicioni i tyre në skenën publike, sociale dhe politike të Malit të Zi, janë trajtuar drejtpërdrejt ose tërthorazi nga vetëm 6 subjekte politike, ose nga 40% e numrit total të pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare 2023.** Pjesa e mbetur prej 60% e aktorëve nuk kanë në programin e tyre asnjë pikë në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore dhe është veçanërisht shqetësuese që në atë 60% janë edhe ato subjekte politike që kanë arritur rezultatet më të mira në zgjedhjet parlamentare. Fatekeqësisht, me këtë çështje janë më tepër përfshirë partitë politike që kanë fituar shumë pak mandate ose nuk kanë kaluar pragun zgjedhor, me përjashtim të koalicionit “*Bashkë!*” dhe *Partisë Boshnjake*. Gjithashtu, është interesante se temën e barazisë gjinore e kanë trajtuar më në detaje partitë e pakicave në Mal të Zi (*Partia Boshnjake, Aleanca Shqiptare dhe Forumi Shqiptar*), të cilët, bashkë me koalicionin “*PO. Ne mundemi për Malin e Zi qytetar*” dhe *Lëvizja për Ndryshim*, i kanë përkushtuar një kapitull të tërë kësaj teme në programet e tyre zgjedhore.

Ndër subjektet politikë që kanë përkushtuar një pjesë më të konsiderueshme të programit të tyre kësaj çështjeje, është **Partia Boshnjake (PB)**<sup>1</sup>, dhe ky segment përbën **4.65%** të programit të tyre zgjedhor. Pasi kjo parti përfaqëson një numër më të vogël të popullsisë në Mal të Zi, kanë kushtuar vëmendje grave të kombit boshnjakë. Kështu, problematizohet se gratë e pakicave përjetojnë marginalizim shtesë krahasuar me gratë e tjera në skenën politike, dhe deri më tani nuk kanë zënë pozicione të rëndësishme udhëheqëse në shtet. Për më tepër, PB shpreh angazhimin për të bërë që pjesëtarët e kombësisë boshnjake të jenë më të pranishme në pozicionet e larta, më të dukshme në publik, dhe aktore më aktive në hartën shoqërore dhe politike të Malit të Zi, duke hequr stereotipet që i shoqërojnë ato. Përveç kësaj, për të ndryshuar gjendjen aktuale në këtë fushë, PB përmend disa mekanizma konkrete që planifikon të aplikojë: promovimi i arsimit dhe edukatës së grave përmes Forumit të Grave, organizimi i trajnimeve për të fuqizuar ndërmarrjen e grave, rritja e kompensimeve për gratë në gjendje të lindjes, lufta kundër diskriminimit të grave, etj.

**Lëvizja për Ndryshim (LpN)**<sup>2</sup> i kushtoi 4.5% të programit zgjedhor çështjes së pozitës së grave, duke përfshirë një seksion të veçantë. Duke vërejtur se barazia gjinore është nevojë për shoqërinë

---

<sup>1</sup> Programi zgjedhor “*ËSHTË E QARTË!* – Partia Boshnjake – mr Ervin Ibrahimoviq”

<sup>2</sup> Programi zgjedhor Lëvizja për Ndryshim – Mali i Zi në vend të parë: Reforma për të shpëtuar vendin

malazeze, LpN problematizon dominimin e burrave në vendet vendimmarrëse, mungesën e barazisë gjinore në punësim, dhunën ndaj grave, stereotipet që shkaktojnë dhunën fizike dhe psikike ndaj grave, diskriminimin gjinor me theks në gratë nga kategoritë e rrezikuara, ekspozimin ndaj dhunës verbale, etj. LpN jep edhe rekomandime që do të kontribuojnë në afirmimin e grave, përfshirë: fuqizimin ekonomik të grave dhe forcimin e ndërmarrjes të grave me masa të përcaktuara; diskriminimin pozitiv dhe masa stimuluese për gratë me aftësi të kufizuara, nënat beqare, gratë viktime të dhunës familjare; pensionet sociale dhe kompensimet monetare për kategori të caktuara të grave; masa mbështetjeje gjatë periudhës së shtatzënisë dhe lindjes; krijimin e Fondit për kompensimin e dëmit të viktimave të dhunës; pozicionimin e Klubit të Grave si një organ pune të rregullt të Kuvendit; ndëshkimin e dhunës verbale ndaj grave në jetën publike; promovimin e pjesëmarrjes së më shumë grave në vendet vendimmarrëse, etj.

Koalicioni **“PO. Ne mundemi për Malin e Zi qytetar”**<sup>3</sup> thekson përmirësimin e pozicionit të grave në shoqëri si një prej prioriteteve të tyre në programin zgjedhor<sup>4</sup> dhe i kushton **4%**, duke propozuar një sërë masash në këtë drejtim. Këto masa, *inter alia*, përfshijnë: barazinë gjinore dhe përfaqësimin më të mirë të grave në vendet e rëndësishme për marrjen e vendimeve; nxitjen e grave për pjesëmarrje më të fortë politike; krijimin e një legjislacioni zgjedhor që zgjidh vërtet çështjen e përfaqësimit të (pa)barabartë të grave dhe burrave; luftën kundër diskriminimit të grave, veprime konkrete për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në bazë të gjinisë, dhunës ndaj grave, dhunës në familje dhe tregtisë së grave; fuqizimin dhe krijimin e mekanizmave të rinj institucionalë për barazi gjinore; masa që lidhen me familjen, arsimimin e fëmijëve, punën e grave në shtëpi, etj. Gjithashtu, ata bëjnë thirrje për nevojën e përdorimit të gjuhës së ndjeshme ndaj gjinës, si dhe për rritjen e ndërgjegjësimit të përgjithshëm rreth rëndësisë së këtyre çështjeve.

Në programin zgjedhor të **Aleancës Shqiptare**<sup>5</sup> segmenti me titullin “Gratë” përbën **6.44%** dhe trajton hollësisht disa çështje, por ofron edhe masa për adresimin e tyre. Fokusi është fuqizimi ekonomik i grave shqiptare në Mal të Zi dhe politikat që synojnë këtë, përfshirë lehtësimet tatimore për gratë, përparësitë në ndarjen e fondeve dhe subvencioneve, etj. Kjo listë është e vetmja që ka ngritur çështjen e trashëgimisë së pasurisë familjare, me premtimin se do të marrë masa ligjore konkrete për të siguruar trajtimin e barabartë të grave në këtë fushë. Gjithashtu theksojnë të drejtat e vajzave për arsim, ndihmën për shpenzimet e shkollimit të grave në shoqërinë shqiptare të Malit të Zi, si dhe programe bursash për gratë brenda dhe jashtë vendit. Specifike i këtij programi zgjedhor është gjithashtu rëndësia e rritjes së nivelit të mbrojtjes sociale dhe shërbimeve shëndetësore për nevojat e caktuara të grave. Në program theksohet qartazi edhe dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, për të cilat kërkohen masa ligjore të rrepta, si dhe ndryshimi i ndërgjegjësimit shoqëror, si dhe eliminimi i stereotipeve dhe paragjyqimeve që shtyjnë veprimtari të dhunshme dhe diskriminuese. Përfundimisht, rëndësi të madhe i kushtohet rritjes së pjesëmarrjes së grave në pozita vendimmarrëse, lista zgjedhore dhe funksione të ndryshme.

---

**3** Koalicioni përbëhet nga dy subjekte: Lëvizja Qytetare “Ne mundemi” dhe Malit të Zi Qytetarë

**4** Programi zgjedhor i grupit qytetar “Ne mundemi”

**5** Platforma zgjedhore - Koalicioni “Aleanca Shqiptare” (Forca - Partia Demokratike - Lidhja Demokratike në Mal të Zi - Lëvizja - Tuz)



**Forumi Shqiptar<sup>6</sup>** ka përkushtuar **1.70%** të programit të tyre zgjedhor për të drejtat e grave. Ky subjekt politik, nëpërmjet seksionit “Të Drejtat e Grave”, shprehë që *afirmon veçanërisht barazinë gjinore dhe të drejtat e grave të bazuar në dinjitetin njerëzor dhe parimet moderne të civilizimit*. Ata, nëpërmjet programit, angazhohen të vazhdojnë të mbështesin masat e politikave afirmative, si dhe rritjen e përfshirjes së barabartë të grave në jetën politike, ekonomike dhe shoqërore, por në bazë të meritokracisë.

Çështjet e grave në programin e Koalicionit “**BASHKË! - për të ardhmen që të takon - Danijell Zhivković (PDS, SD, UDSH, PL)**”<sup>7</sup> përbëjnë **2.35%** të programit të përgjithshëm. Ky koalicion shkurtimisht ka prioritet zhvillimin e ndërmarrjes së grave, kreative dhe sociale. Po ashtu, ata angazhohen për të forcuar “*kapacitetet e personelit të institucioneve arsimore dhe të kujdesit shoqëror në luftën kundër dhunës ndaj të rinjve, dhunës ndaj grave, dhe të moshuarve, etj*”. Ky subjekt politik ka parashikuar themelimin e strehimeve për gratë viktime të dhunës, si dhe ndryshimet ligjore për shqyrtimin e krimeve të rënda, si femicidi, dhuna ndaj të rinjve, dhuna ndaj të moshuarve, etj.

Në programin zgjedhor të **lëvizjes „Kthesa”**<sup>8</sup> vetëm **0.30%** e përmbajtjes prek rëndësinë e barazisë gjinore. Në seksionin me titullin “Të drejtat e njeriut”, në një frazë theksohet se është i nevojshëm “*promovimi i barazisë gjinore në të gjitha nivelet me akcent të veçantë në të drejtat e barabarta në sferën private dhe në punë*”. Po ashtu, *Kthesa* angazhohet në luftën kundër diskriminimit dhe ndalimin e çdo lloji të diskriminimit.

---

**6** Programi Zgjedhor dhe Politik i Forumit Shqiptar - Forumi Shqiptar - Nik Gjelošhaj “BESA per Zhvillim European”

**7** Programi zgjedhor – Mali i Zi në levizje – Bashkë!

**8** Programi i lëvizjes Ndryshime i disponueshëm në: <https://www.preokret.me/program>

# Përqindja e grave në lista rreth minimumit ligjor

Me analizen e listave zgjedhore që morën pjesë në zgjedhjet parlamentare, të mbajtura më 11 qershor 2023, ekipi hulumtues i Qendrës për Arsim Qytetar (QAQ), ka ndjekur zbatimin e dispozitave të **Ligjit mbizgjedhjen e këshilltarëve dhe deputetëve**, të cilat, si masë afirmative, parashikojnë një kuotë minimale prej 30% për gjininë më pak të përfaqësuar dhe renditjen e kandidatëve/ve në listë, që do të thotë që një anëtar/e i/e kësaj gjinie duhet të gjindet në çdo të katërin emër në listë. Synimi ishte përcaktimi i numrit, ose përqindjes së përfaqësimit të gjinisë më pak të përfaqësuar (përfshihen kryesisht gratë) në 15 listat zgjedhore që morën pjesë në këto zgjedhje. Përveç kësaj, u bë krahasimi me zgjedhjet parlamentare të mëparshme, të mbajtura më 30 gusht 2020, për të regjistruar trendet në përfaqësimin e grave në listat zgjedhore dhe zbatimin e këtyre masave afirmative.

Për qëllime studimi, janë analizuar të gjitha 15 listat zgjedhore: *Është e qartë!* – Partia Boshnjake – mr Ervin Ibrahimoviq; NCK – Në anë të drejtë të botës; “Drejtësi për të gjithë!” – dr Vladimir Llepasoviq; PPS – DEMOS – Për ty; Koalicioni Popullor – bashkë dhe pikë“ (Dejan Vukshiq – Levizja Demokratike e Krishterë; Marko Milaçiq – Mali i Zi i Vërtetë; Vladislav Dajkoviç – Mali i Zi i Lirë; Dragica Peroviç – Partia Demokratike Serbe; dr Novica Staniç – Levizja për Plevlën); Aleanca shqiptare; Kthesë për një Mal të Zi të sigurt – Srgjan Periq; Levizja për Ndryshime – Mali i Zi në vend të parë – Nebojsa Medojeviç – Reforma për shpëtimin e vendit; PO. Ne mundemi për Malin e Zi qytetarë!; BASHKË! Për të ardhmën që të takon – Danijell Zhivkoviç (PDS, SD, UDSH, PL); Evropa tani – Millojko Spajiq; PSD – Për shtëpinë tonë; Alleksa dhe Dritani – Guximi vlerësohet!; Për të ardhmen e Mali të Zi (Demokracija e Re Serbe, Partia Popullore Demokratike e Malit të Zi, Partia e Punës); dhe Forumi shqiptar – Nik Gjelogshaj “BESA për Zhvillim Evropian”.

Gjithashtu, vlen të theksohet se për të marrë pjesë në zgjedhjet parlamentare, Komisionit Shtetëror i Zgjedhjeve (KSZH) i janë dorëzuar 17 kandidatura, por dy prej tyre janë refuzuar. Këtu bëhet fjalë për listen *Veprimi Qytetar Malazet* dhe lëvizjen *La casa de papel*, të cilat, pas kthimit të dosjeve për shtesë nga ana e KSZH-së, nuk i kanë shfrytëzuar ato në mënyrë adekuate.<sup>9</sup> Interesante është fakti që lista **Po. Ne mundemi për Mal të Zi!**, e cila ishte e vetmja që një grua ishte bartëse e listës, po ashtu është kthyer për shtesë, sepse i mungonin 170 nënshkrime, por edhe për shkak të numrit të pakët të kandidatëve të gjinisë më pak të përfaqësuar, të cilët në këtë rast ishin burrat.

---

<sup>9</sup> Lista e Veprimit Qytetar Malazet u refuzua për shkak se i mungonin 35 nënshkrime të vlefshme, dhe për lëvizjen *La casa de papel*, KSZH nuk mundi të konkludonte qartë se kë përfaqësonte lëvizja, sepse në aplikimin zgjedhor kishte deklaruar se përfaqëson komunitetin italian në Mal të Zi, ndërsa objektivat programore të lëvizjes thonë se ai përfaqëson komunitetin kroat në Mal të Zi.

**Analiza e 15 listave zgjedhore tregon se të gjitha subjektet politike kanë respektuar kornizën ligjore që kërkon 30% përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar. Gjithashtu, të gjithë aktorët zgjedhor kishin një nga katër emrat në listat e tyre zgjedhore që i përkisnin gjinisë më pak të përfaqësuar.** Megjithatë, praktika ka treguar se partitë më së shpeshti, si në rastin e cikleve zgjedhore të mëparshme, e kuptonin këtë bukqualisht, kështu që rrallëherë kishte subjekte që e kalonin minimumin ligjor, ndërsa çdo vend i katërt, i teti, i dymbëdhjetë, i gjashtëmbëdhjetë, etj., ishte përgjithësisht i rezervuar për gratë, **me çka partitë edhe një herë demonstuan papjekurinë dhe keqkuptimin themelor të kësaj mase të veprimit afirmativ.** Në mbështetje të kësaj është fakti se, megjithëse u shënua një përparim i caktuar numerik, veçanërisht në listat e partive minoritare, me **përrjashtim të lëvizjes *Ne mundemi*, e cila kishte bartësen e listës, gratë nuk ishte në dy vendet e para të çdo listë tjetër zgjedhore.** Nga katër vendet e para, gjashtë lista vendosën gruan në vendin e katërt, shtatë në vendin e tretë, lista PPS – Demos kishte grua në vendin e tretë dhe të katërt, ndërsa lëvizja *Ne mundemi* kishte një burrë në vendin e katërt. **Ky pozicionim i grave në pozita më të ulëta në listë, veçanërisht me supozimin se disa lista më të vogla nuk do të marrin aq mandate sa do të mjaftonin që të paktën një grua nga një parti e caktuar të hynte në Kuvend, flet për një qëllim të qartë për të skualifikuar gratë nga proceset kyçe dhe për të reduktuar edhe më shumë numrin e tyre në këtë seancë<sup>10</sup>.**

Përfundimisht, analiza tregon se në zgjedhjet parlamentare kanë marrë pjesë **398 gra** dhe kanë qenë në listat zgjedhore, pra **35,76%** e numrit të përgjithshëm të pjesëmarrësve (**1113**).

Lista zgjedhore	Numri dhe përqindja e përfaqësimit të grave në listë	Renditja e kandidatëve/eve në listë (1 nga 4 vende)
Është e qartë! – Partia Boshnjake - mr Ervin Ibrahimoviq	33 ( <b>41%</b> )	renditja e respektuar
NCK – Në anë të drejtë të botës	29 ( <b>41%</b> )	renditja e respektuar
Drejtësi për të gjithë! – dr Vlladimir Llepasoviq	17 ( <b>31%</b> )	renditja e respektuar
PPS – DEMOS – Për ty	26 ( <b>32%</b> )	renditja e respektuar
Koalicioni Popullor – bashkë dhe pikë“ (Dejan Vukshiq – Levizja Demokratike e Krishterë; Marko Millaçiq – Mali i Zi i Vërtetë; Vlladislav Dajkoviq – Mali i Zi i Lirë; Dragica Peroviq – Partia Demokratike Serbe; dr Novica Staniq – Levizja për Plevlën)	25 ( <b>31%</b> )	renditja e respektuar
Aleanca Shqiptare	21 ( <b>31%</b> )	renditja e respektuar

<sup>10</sup> Në seancën konstituive të Kuvendit, nga gjithsej 81 mandate parlamentare, vetëm 17 (21%) do t'u ndahen grave, dhe asnjë nga nëntë listat që fituan mandatet për mbledhjen e re parlamentare nuk do të ketë më shumë se 30% deputete në seancën konstituive, ndërsa deri në katër lista që së bashku kanë gjashtë mandate dhe nuk kanë gra në përbërjen e tyre.

Kthesë për një Mal të Zi të sigurt – Srgjan Periq	17 <b>(31%)</b>	renditja e respektuar
Levizja për Ndryshime – Mali i Zi në vend të parë – Nebojsa Medojeviq – Reforma për shpëtimin e vendit	30 <b>(37%)</b>	renditja e respektuar
PO. Ne mundemi për Malin e Zi qytetarë!	45 <b>(58%)</b>	renditja e respektuar
BASHKË! Për të ardhmën që të takon – Danijell Zhivkoviq (PDS, SD, UDSH, PL)	32 <b>(40%)</b>	renditja e respektuar
Evropa tani – Millojko Spajiq	28 <b>(35%)</b>	renditja e respektuar
PSD – Për shtëpinë tonë	26 <b>(32%)</b>	renditja e respektuar
Alleksa dhe Dritani – Guximi vlerësohet!	25 <b>(31%)</b>	renditja e respektuar
Për të ardhmen e Mali të Zi (Demokracia e Re Serbe, Partia Popullore Demokratike e Malit të Zi, Partia e Punës)	26 <b>(32%)</b>	renditja e respektuar
Forumi shqiptar – Nik Gjeloshaj „BESA per Zhvillim Evropian“	18 <b>(30%)</b>	renditja e respektuar

Tabela 1. Përfaqësimi i grave në listat zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2023.

Gratë ishin më së paku të përfaqësuara në listën e **Forumit Shqiptar - Nik Gjeloshaj “BESA për zhvillimin Evropian”**. Ndër 60 kandidatët/e për deputetë/e, vetëm **18** ose **30%** në këtë listë zgjedhore ishin gra, që është minimumi i nevojshëm për të plotësuar kuotën e përcaktuar me ligj për gjininë më pak të përfaqësuar.

Edhe këto lista nuk ishin larg minimumit ligjor: **Drejtësi për të gjithë! – dr Vladimir Llepasaviq; Koalicioni Popullor - bashkë dhe pikë; Aleanca Shqiptare, Kthesë për një Mal të Zi të sigurt - Srgjan Periq, Alleksa dhe Dritani – Guximi vlerësohet!** E zakonshme për këto lista zgjedhore është përqindja e përfaqësimit të grave, që është- **31%**.

Ndër listat që kishin një përqindje dukshëm më të lartë të përfaqësimit të grave në krahasim me ato të përmendura, spikat lista **Po. Ne mundemi për Malin e Zi qytetarë** me 58%, pra 45 gra nga numri i përgjithshëm i kandidatëve/eve. Kjo paraqet një specifikë të veçantë të ofertës zgjedhore në skenën politike të Malit të Zi për sa i përket përfaqësimit dhe pozicionimit të grave në listat zgjedhore dhe një tregues se gratë vlerësohen dhe motivohen në masë shumë më të madhe kur ajo listë kryesohet nga një grua. Gjithashtu, duhen veçuar edhe listat e **NCK** dhe **PB**, parti që përfaqësojnë popujt pakicë dhe që kishin **41%** gra në listat e tyre. Më tej, në listën zgjedhore të koalicionit **BASHKË!** të drejtuar nga PDS, nga numri i përgjithshëm i kandidatëve/eve, **32** ishin gra, pra **40%**. Vijon edhe lista e **Lëvizjes Evropa tani** me **35%**, ndërsa të gjitha listat e tjera ishin rreth minimumit ligjor.

**QAQ bëri një krahasim me zgjedhjet parlamentare të mbajtura në vitin 2020.** Në 11 listat zgjedhore në atë kohë ishin gjithsej **778 kandidatë të të dy gjinive**, ndërsa numri i grave ishte **269**, pra **34,58%**, që është **rreth 1% më pak se përqindja e zgjedhjeve të vitit 2023 (35,76%)**. Edhe atëherë, vetëm një listë kryesohej nga një grua (Draginja Vuksanović Stanković - PSD - Mali i Zi i Fortë!), dhe gjysma e partive formalisht respektuan minimumin ligjor. Ngjashmëria është gjithashtu se edhe atëherë partitë pakicë (PB dhe NCK) u dalluan për sa i përket përqindjes së grave në listat e tyre, ndërsa SD, që u kandidua në mënyrë të pavarur, kishte 40% gra dhe Partia Reformuese Kroate madje kishte 69% gra, më shumë se lëvizja Ne Mundemi në zgjedhjet e vitit 2023.

**Gjithsesi, siç u përmend tashmë, këto ndryshime të vogla në shifra totale nuk sjellin dhe nuk mund të sjellin një ndryshim cilësor dhe as nuk janë një masë adekuate e përfaqësimit të ardhshëm të grave në Kuvend,** përderisa kuotat merren formalisht, pa synim bindës të mundësohet një pozicionim më i mirë për gratë si gjinisë më pak të përfaqësuar.

Lista zgjedhore	Numri dhe përqindja e përfaqësimit të grave në listë	Renditja e kandidatëve/eve në listë (1 nga 4 vende)
Socijaldemokrat - Ivan Brajović - Ne vendosim NDIQSHËM	33 <b>(40.74%)</b>	renditja e respektuar
Partia Boshnjake - Saktë - Rafet Husović	29 <b>(35.80%)</b>	renditja e respektuar
NCK. Me gjithë zemër për Malin e Zi!	19 <b>(36.54%)</b>	renditja e respektuar
PSD – Mali i Zi i fortë!	27 <b>(33.33%)</b>	renditja e respektuar
Partia Reformuese Kroate e Mali të Zi- PRK	20 <b>(69%)</b>	renditja e respektuar
dr Dritan Abazović – Bardhë në zi – dr Srgjan Paviqević – (Lëvizja civile URA, Partia e Drejtësisë dhe Pajtitimit, Grupi i votuesve CIVIS dhe intelektualë të pavarur) – Qytetarët!	26 <b>(32.10%)</b>	renditja e respektuar
Koalicioni shqiptar „Bashkë një za“ Partia Demokratike, Unioni Demokratik i Shqiptarëve dhe Lidhja Demokratike në Mal të Zi	15 <b>(30.60%)</b>	renditja e respektuar
Të vendosur për Malin e Zi! PDS – Millo Gjukanović	25 <b>(30.86%)</b>	renditja e respektuar

Për të ardhmen e Malit të Zi - Fronti Demokratik (Demokracia e Re Serbe, Lëvizja për Ndryshim, Partia Popullore Demokratike), Partia Popullore Socialiste e Malit të Zi, Mali i Zi i vërtetë, Mali i Zi i Bashkuar, Partia e Punëtorëve, Partia e Pensionistëve të Bashkuar dhe Personave me Aftësi të Kufizuara të Malit të Zi, Partia Komuniste Jugosllave e Malit të Zi, Partia Radikale Serbe, Partia e Pensionistëve me Aftësi të Kufizuara dhe Drejtësisë Sociale të Malit të Zi	25 <b>(30.86%)</b>	renditja e respektuar
Lista Shqiptare - Genci Nimanbegu, Nik Gjelošhaj	25 <b>(30.86%)</b>	renditja e respektuar
Alleksa Beçiq - Miodrag Llekiq - "Paqja është kombi ynë" - Demokratët - Mali i Zi Demokratik - Demos - Partia e Pensionistëve invalidë dhe dëmshpërblimit - LC Majta e Re	25 <b>(30.86%)</b>	renditja e respektuar

Tabela 2. Përfaqësimi i grave në listat zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2020.

# Mediat të interesuar për fushatën, partitë nuk komunikojnë çeshtjen e barazisë gjinore

Për qëllimet e këtij projekti u krye monitorimi i përmbajtjes mediatike, synimi i të cilit ishte vlerësimi i përfaqësimit të temave që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, pjesëmarrjen e grave në komunikim/aktivitetet publike parazgjedhore dhe prezencën e tyre në përmbajtje mediatike krahasuar me burrat. Gjithashtu, monitorimi synonte të tregonte se sa janë përfaqësuar listat zgjedhore në përmbajtjen e mediave të monitoruara, në sa njoftime janë përmendur kandidatët/et, dhe si është raporti i informacioneve të shpallura.

Monitorimi përfshinte 25 media dhe krahasuar me të gjitha projektet e mëparshme të realizuara nga QAQ, ky është numri më i madh i mediave të analizuara. Më saktësisht, monitorimi përfshin **10 stacione televizive** - TVCG, TV Vijesti, Nova M, Prva TV, Adria TV, Gradska TV, TV E, TV 7, TV A+, PINK M, pastaj **3 gazeta ditore** - Dan, Vijesti, Pobjeda, si dhe **12 portale** - Vijesti, CdM, Analitika, RTCG, Antena M, IN4S, Standard, Gradski, Borba, Dan, Pobjeda, Aktuelno.


Sipas të dhënave të Komisionit Shtetëror Zgjedhor (KSHZ), 101 anëtarë/e të redaksive (gazetarë, kameramanë, fotografë, montues teknikë) nga Mali i Zi, rajoni dhe jashtë shtetit janë akredituar për monitorimin mediatik të fushatës zgjedhore parlamentare.

## Përmbledhja e përgjithshme


Nga monitorimi i përmbajtjes së mediave të vëzhguara në periudhën nga 11 maj deri më 9 qershor 2023 janë regjistruar gjithsej **9861 njoftime mediatike** që përmbajnë informacione lidhur me zgjedhjet parlamentare në Mal të Zi.<sup>11</sup> Për shkak të diferencës në funksionimin e tre llojeve të mediave të vëzhguara, duke përfshirë hapësirën e disponueshme mediatike për vendosjen e informacionit, si dhe numrin e mediave të vëzhguara, siç pritej, portalet kryesojnë në përfaqësimin e informacionit lidhur me zgjedhjet parlamentare, me 7861 njoftime në media (80%). Si numri total ashtu edhe numri i publikimeve sipas llojit të medias, tregojnë prani të konsiderueshme mediatike të temës së vëzhguar, gjë që nga njëra anë tregon se qytetarët/et janë të informuar mirë dhe nga ana tjetër, ekspozimi i tyre i lartë ndaj informacionit që në fund mund të çojë në konfuzion gjatë zgjedhjeve personale. Portali Gradski.me ka pasur më së shumti njoftime nga të gjitha portalet, gazeta ditore “Dan” ndër mediat e shkruara dhe TV Vijesti për sa i përket televizionit.

---

<sup>11</sup> Monitorimi i mediave ka përfunduar të premtën, 9 qershor në orën 00:00 me fillimin e heshtjes zgjedhore.



Grafikët 1 dhe 2. Numri i publikimeve dhe % sipas llojit të medias



Grafiku 3. Numri i postimeve sipas mediave individuale


Përderisa në pjesën e parë të fushatës nuk u vunë re polemika të theksuara të konkurrencës politike, në pjesën e dytë të fushatës (pas 22 majit), regjistrohet ashtuquajtura fushata ofenduese, pra negative. Gjegjesisht, subjektet politike kanë shfrytëzuar hapësirën mediatike në dispozicion për të prezantuar programin e partisë, por shumë parti dhe koalicione kanë sulmuar edhe konkurrencën politike në këtë kuadër. Shumë polemika të vëzhguara u përcaktuan si nga fushata ashtu edhe nga rastet që ndodhën gjatë fushatës (p.sh. afera “Do Kwon”).

### Analiza e pranisë së mediave të listave zgjedhore

Më e pranishme në media gjatë fushatës zgjedhore ishte lista e kryesuar nga PDS me 3222 njoftime mediatike. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se kjo listë është e paraqitur mirë dmth. se në këtë numër njoftimesh ka pasur rastin t’u drejtohet qytetarëve. Përkundrazi, një numër i konsiderueshëm i përmendjeve të kësaj liste janë të paplanifikuara (përmendjet nga media, analistë, KSHZ dhe shpesh nga konkurrentët politikë) dhe potencialisht negative. Kjo listë gjeneroi 818 postime negative, që



është 25% e totalit të përmendjeve të kësaj liste. Vetëm lista e udhëhequr nga Lëvizja Evropë tani ka një përqindje më të keqe të postimeve me tone të ndryshme me një përqindje postimesh negative prej 34% (928 postime negative), gjë që tregon se PDS-ja nuk është më një parti politike që vuan kritika negative nga të tjerët subjektë politikë.




Grafiku 4. Numri i njoftimeve me tone të ndryshme - sipas listave individualisht

Polarizimi mediatic më së shumti reflektohet në tonin e njoftimeve mediatike në raport me subjektet më të mëdha politike. Kur bëhet fjalë për top 5 subjektet më të mëdha politike - **Evropa tani** kishte postimet më pozitive në portalin Vijesti - 68, dhe postimet më negative në portalin Borba - 125, ndërsa koalicioni i

mbledhur rreth PDS-së kishte postimet më pozitive në portalin Gradski.me - 168, kurse ato më negative në portalin Borba - 114. Koalicioni **“Për të ardhmen e Malit të Zi”** ka pasur postimet më pozitive në portalin Borba - 82, dhe më negativë në portalin Gradski.me - 58. Koalicioni **Demokratë - URA** kishte publikimet më pozitive në media në portalin Vijesti - 87, dhe postimet më negative në portalin Gradski.me - 69. Partia Boshnjake gjeneroi një numër jashtëzakonisht të vogël postimesh negative, dhe shumica e tyre ishin në portalin Borba - 5, ndërsa postimet më pozitive ishin në portalin e shërbimit publik RTCG.me - 24.

## Përfaqësimi i temave në fushatën zgjedhore

Në narrativën e përgjithshme të krijuar nga të gjitha subjektet politike gjatë fushatës parazgjedhore dominon tema “korrupsioni/krimi/sundimi i ligjit”, ndjekur nga “temat e përgjithshme politike”, më pas “ekonomia dhe çështjejt ekonomike” dhe “parashikimi i rezultateve dhe prognoza”. Disa subjekte politike, narrativa e mëparshme politike e të cilave kishte një ton specifik të dallueshëm (çështjet e identitetit, krimi dhe korrupsioni...) kësaj radhe korrigjuan ndjeshëm praninë e tyre mediatike dhe e përshtatën atë me konkurrencën politike (ekonomia, çështjet sociale, etj.). Përfaqësimi i temave lidhur me barazinë gjinore ishte jashtëzakonisht i ulët. Vetëm një temë që lidhet me barazinë gjinore, më saktësisht “pjesëmarrja politike e grave” kalon 1% të shpërndarjes totale, ndërsa prezenca mediatike e temave të tjera të vëzhguara lidhur me barazinë gjinore është nën 1% ose mungonte plotësisht.



Grafiku 5. Numri i shpalljeve - TEMAT për të cilat folën pjesëmarrësit në zgjedhje - PRIMARE PREZENTE

Vështrimi i përgjithshëm i temave tregoi se narrativa e përgjithshme, krahasuar me fushatat e vëzhguara më parë, u zhvendos ndjeshëm drejt temave ekonomike dhe atyre që kanë të bëjnë me cilësinë e jetës së qytetarëve/eve, por edhe se një nivel i konsiderueshëm i përmendjes së çështjeve të identitetit është mbajtur, megjithëse të formuluar ndryshe. Gjithashtu, një pasqyrë e temave parësore të trajtuara individualisht nga listat, sjell një tjetër konfirmim **të interesimit të dobët të përgjithshëm të pjesëmarrësve në zgjedhjet parlamentare për temën e barazisë gjinore**, gjë që dërgon mesazhin se partitë besojnë se çështja gjinore nuk do të ndikojë në vendimin për mbështetje.

- **Çështjet e identitetit**, në një pjesë më të madhe të prezantimit të tyre trajtuan partitë pakicë,

NCK dhe PB, të ndjekura nga PSD, si dhe koalicioni Për të ardhmën e Malit të Zi dhe koalicioni i bashkuar nga PDS. Koalicioni i mbledhur rreth PDS-së e trajtoi çështjen e identitetit në mënyrë indirekte, duke theksuar suksesin dhe identitetin evropian të Malit të Zi dhe nevojën që Mali i Zi të rivendosë “harmoninë e prishur multietnike dhe të kthehet në rrugën e BE-së”. Lista e PSD-së nga vetë emri (Për shtëpinë tonë) theksonte komponentin e përkatësisë së identitetit, ndërsa listat e tjera të përmendura theksonin identitetet konkrete kombëtare (interesat e boshnjakëve, kroatëve, shqiptarëve, serbëve...). Rastet individuale gjatë periudhës së vëzhguar, të cilat nuk ishin domosdoshmërisht të lidhura drejtpërdrejt me fushatën zgjedhore, çuan në rritje të ndjeshme narrativën e kësaj teme. Rasti i parë i “provokuar” nga aktualiteti në Kosovë ishte pjesë e një fushate specifike zgjedhore (një tubim proteste në Nikshiq i udhëhequr nga koalicioni Për të ardhmën e Malit të Zi). E dyta ka të bëjë me rastin “Vranesh”, gjegjësisht reagimin ndaj deklaratës kontroverze të kryetarit të Komunës së Plevlës, Darko Vranesh, lidhur me festimin e 21 majit - Ditës së Pavarësisë së Malit të Zi.

- **Çështjet sociale** u përfaqësuan në mënyrë të konsiderueshme në narrativën e përgjithshme dhe trajtoheshin kryesisht me çështjen e banimit, pra mundësinë e blerjes apo marrjes me qira të pronave të paluajtshme, por edhe mënyrat e mbështetjes së familjes dhe përfitimeve sociale, mbështetjes së të rinjve dhe kujdesit shëndetësor në një masë të vogël. Pyetjet kushtuar kulturës mungonin plotësisht. Sipas numrit të përmendjeve të “temave sociale”, ranë në sy listat “Kthesë”, “Ne mundemi” dhe PPS dhe Demos. Tema ishte e përfaqësuar edhe në listat e tjera, por në shakllë statistikiq më të vogël në krahasim me përfaqësimin e temave të tjera në narrativën e përgjithshme të planifikuar të atyre listave.
- Koalicioni “Guxim vlerësohet”, i cili përbëhej nga Demokratët e Malit të Zi dhe URA, mori primatin në temën **“korrupsioni, krimi, sundimi i ligjit”**, megjithëse tema ishte mjaft e pranishme në narrativat e planifikuara të listës Për të ardhmën e Malit të Zi dhe LpN (pra, konstituentët politikë të ish-Frontit Demokratik - FD), por edhe listën e lëvizjes Evropa tani, “Koalicionit Popullor”, pastaj edhe listës së udhëhequr nga Vlladimir Lleposaviq. Një prezencë më domethënëse e kësaj teme në narrativën e planifikuar të koalicionit të udhëhequr nga PDS u vu re në pjesën e dytë të fushatës zgjedhore dhe si përgjigje ndaj narrativës së përgjithshme të krijuar në atë periudhë. Gjegjësisht, ndonëse kjo temë është përmendur qartë nga shumë subjekte/lista politikë më parë (pjesa e parë e fushatës, pra para rastit “Do Kwon”, rritja e saj e shpejtë është vërejtur pas ekspozimit mediatic të rastit “Do Kwon” d.m.th. përmendja e lidhjeve të supozuara të Millojko Spajiq, bartës i listës Evropa tani!, me shtetasin e komprometuar të Koresë së Jugut të arrestuar në Mal të Zi me urdhër të Interpolit. Kjo temë u shënua nga një fushatë negative, d.m.th. partitë më së shpeshti kritikuan njëra-tjetrën (e ashtuquajtura fushata e sulmit) duke treguar për aktivitetet e supozuara kriminale të listave të tjera.
- Mbështetja për integrimin evropian nga të gjithë pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare të 2023 është e dukshme përmes një numri të konsiderueshëm njoftimesh për temën e **integritimit në BE** nga të gjitha partitë dhe koalicionet, si dhe përmendja e shpeshtë e “vlerave evropiane” si vlera mbi të cilat ekziston marrëveshje e përgjithshme. Megjithatë, sipas numrit të përmendjeve të kësaj teme, veçohen partitë pakicë, si dhe PSD dhe koalicioni rreth PDS-së. Nga ana tjetër, **NATO**-ja si temë nuk ishte në rendet e para në axhendën e asnjë partie. Përrjashtim ishte festimi i përvjetorit të anëtarësimit të Malit të Zi në NATO, kur koalicioni i mbledhur rreth PDS, NCK, PB

dhe LET shprehen mbështetjen për anëtarësimin e Malit të Zi në këtë organizatë ndërkombëtare. Pikërisht atëherë u gjenerua numri më i madh i përmendjeve rreth kësaj teme.

- Të gjitha koalicionet dhe partitë që morën pjesë në zgjedhje në mënyrë të pavarur u morën me çështjen e **“ekonomisë”**, por në veçanti spikat Lëvizja Evropa tani. Përveç se kjo parti në fushatë ka paraqitur çështje nga ky korpus, këto çështje më së shpeshti i është adresuar si kritikë nga partitë tjera.

Siç është përmendur tashmë, temat që lidhen me barazinë gjinore kishin një përfaqësim mjaft të ulët në nivelin primar të analizës së medias. **Janë regjistruar vetëm 178 postime që trajtojnë njëri nga këto tema si primare (përkatësisht 134 postime për “pjesëmarrjen politike të grave”, 42 për “dhunën ndaj grave - luftë kundër dhunës” dhe 2 kanë lidhje me të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të grave).** Kur marrim numrin total të postimeve të krijuara nga tema e zgjedhjeve parlamentare (9861 postime), temat që lidhen me barazinë gjinore përbëjnë rreth 2%. Ato lidheshin më së shumti me “pjesëmarrjen politike të grave” dhe në thelb ishin të pranishme në pjesën e dytë të fushatës parazgjedhore, d.m.th. pasi OJQ-të, bazuar në prezantimin e rezultateve të monitorimit të përmbajtjes mediatike dhe llojeve të tjera të hulumtimit, vunë re pjesëmarrjen e ulët dhe të pamjaftueshme të informacionit për barazinë gjinore në narrativën e mëparshme në fushatën parazgjedhore. Pra, megjithëse subjektet politike mund të pretendojnë se barazia gjinore ishte planifikuar në axhendat e tyre në fushatat parazgjedhore, ishte sektori i OJQ-ve ai që ushtroi një lloj presioni pozitiv ndaj aktorëve politikë, d.m.th. provokoi përfaqësimin e përgjithshëm mediatik të temave që lidhen me barazinë gjinore.

## NË NARRATIVIN E PËRGJITHSHËM NË FUSHATËN ZGJEDHORE, BARAZIA GJINORE ËSHTË PREZENTE VETËM NË 2% TË POSTIMEVE SENTIMENTE

LIDHUR ME GRA



343 POZITIVE



9503 NEUTRALE




15 NEGATIVE

Postimeve që flasin për zgjedhjet parlamentare iu caktua një sentiment, në lidhje me imazhin që krijojnë për gratë. Kështu, u regjistruan 343 sentimente pozitive (**d.m.th., vetëm 3% e postimeve krijuan një imazh pozitiv për gratë**), 9503 neutrale dhe 15 negative, nga të cilat 2 u shprehën negativisht.

Në njoftimet mediatike lidhur me temën kryesore të vëzhguar (zgjedhjet parlamentare 2023), u përcaktua edhe qëndrimi në lidhje me seksin, pra gjininë. Domethënë, është bërë kategorizimi në postime të dominuara nga zëri femëror (pikëpamjet e shprehura nga gratë), zëri mashkullor, më pas postime me raport të barabartë të zërave mashkullor dhe femëror dhe postime që nuk mund të karakterizohen nga pikëpamja gjinore, d.m.th. gjinia e pacaktuar – në përgjithësi). **Në narrativën**


**e përgjithshme të krijuar në fushatën zgjedhore dominon zëri i mashkullit me 6313 postime (64%). Zëri femëror si dominues shfaqet në 1065 njoftime mediatike ose 11%.**

Grafikët 6 dhe 7. Përfaqësimi i qëndrimeve në lidhje me seksin/gjininë (numri i postimeve dhe %) - (TEMA – ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2023)




Dominimi i zërit mashkullor në raport me zërin femëror është mesazh i qartë për përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në politikë në Mal të Zi dhe trajtimin e tyre si sekondar në procesin zgjedhor. Numri më i vogël i shpalljeve dominuar nga zëri femëror mund të lidhet edhe me faktin se vetëm një listë zgjedhore drejtohej nga një grua, si dhe me faktin se në krye të listave zgjedhore ka pak gra. Në të njëjtën kohë, u vërejt se temat nga korpusi gjinor/të drejtat e grave trajtoheshin nga gratë, si dhe se, siç pritej në mënyrë stereotipike, gratë më së shpeshti flasin për çështje sociale. Në një numër më të dukshëm postimesh, zëri femëror ishte dominues në postimet me çështje identiteti. Tema - ekonomia, korrupsioni dhe krimi - domethënë ato që ndoshta nga publiku i gjerë perceptohen si tema më të rëndësishme, ishin pothuajse tërësisht të rezervuara për burrat.

Për qëllime të analizës së prezencës mediatike si për temën “Zgjedhjet parlamentare 2023” ashtu edhe për praninë mediatike të listave zgjedhore, njoftimeve iu caktua parametri “rol” në lidhje me përmbajtjen e tyre dhe përfaqësimin e pikëpamjeve politike. Ky parametër analitik tregon shkallën në të cilën janë shfaqur në media bartësit e listave, kandidatët nga listat zgjedhore, si dhe subjektet e tjerë politikë që nuk janë në listat zgjedhore, por janë të përfshirë në fushatën politike (politikanë të tjerë nga partitë politike që marrin pjesë në mënyrë të pavarur në zgjedhje ose brenda koalicione dhe aleanca). Në total, numri më i madh i paraqitjeve të planifikuara në media nga pjesëmarrësit në zgjedhjet parlamentare përbajnë pikëpamjet e kandidatëve/eve, d.m.th. pa praninë specifike të pikëpamjes së bartësit të listës (3770 njoftime në media), ndërsa pozita e bartësve të listës (kryesisht si dominante) është e pranishme në 2543 njoftime mediatike. Subjektet e tjerë politikë (politikanë të partive të tjera, zëdhënës, zyrtarë të tjerë partiakë e shtetërorë apo të vetëqeverisjes lokale etj.) promovuan listat e partive të cilave u përkasin 648 njoftime mediatike. Në rastin e listave të caktuara, vërehet komunikim i dukshëm përmes bartësve të listave zgjedhore, gjë që konfirmon narrativat e mëparshme se partitë politike në Mal të Zi janë kryesisht të orientuara nga lidhshipi. Më saktësisht, kjo vërehet më së shumti tek lista bartës i së cilës ishte Ervin Ibrahimoviq (PB), dhe tek Vlladimir Llepasviiq me koalicionin e tij.



Grafiku 8. Rolet e aktorëve të fushatës (paraqitjet e planifikuara në media) (TEMA – ZGJEDHJET PARLAMENTARE 2023)



Grafiku 9. Rolet e aktorëve të fushatës (paraqitjet e planifikuara në media - LISTA INDIVIDUALE)

## Vlerësimi cilësor – barazia gjinore

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Para këtyre zgjedhjeve si parti serioze kemi bërë një sondazh për të parë se për çka reagojnë qytetarët. Rritja e partisë sonë nuk është e rastësishme, sepse ne 70% e drejtuam fushatën në bazë të atij sondazhi. Në këto zgjedhje fokusi ynë ishte ekonomia, të drejtat e punëtorëve dhe sundimi i ligjit. Natyrisht, e njoh nevojën e afirmimit të temave dhe vlerave të tjera në periudhën e ardhshme, veçanërisht përmes punës së Forumit të Grave dhe Forumit Rinor. E përsëris, ne jemi parti relativisht e re në skenën politike dhe jemi pjekur nga cikli në cikël. Ndoshta mund të kishim punuar shumë më tepër në atë fushë, por në periudhën e ardhshme sigurisht që do ta bëjmë. Unë, si kryetarë, dhe kolegët e mi do të japim një kontribut të fuqishëm kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të grave. Sigurisht, stop dhunës dhe çdo gjëje që është kundër me vlerat elementare njerëzore.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Ai informacion është shqetësues, por mendoj se thjesht mbizotëruan temat që u imponuan edhe para zgjedhjeve. Këto janë ekonomia, lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Përveç kësaj, disa afera të tjera i kanë hedhur totalisht në rend dite këto çështje, që besoj se do të jenë një nga temat shumë të rëndësishme të të gjitha partive në ciklin e ardhshëm zgjedhor, veçanërisht nëse duam të jemi shoqëri progresive. Dhe mendoj se qytetarët na kanë thënë se në cilin drejtim duhet të shkojmë.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Ne u udhëhoqëm nga fakti se zëri i gruas është më i rëndësishëm në atë moment dhe ne donim të fuqizojmë të gjitha gratë përmes solidaritetit të grave. Kjo ishte arsyeja që në vendin tonë e dënoi sulmin gruaja dhe jo një nga meshkujt. Ne donim që ajo të dërgonte mesazh solidariteti për të gjitha gratë.

**QAQ: A është pikërisht kjo ajo që i pengon gratë të merren me politikë?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Mendoj se një pjesë e atyre grave duhet të nisen fort, jo për të sakrifikuar veten, por për të duruar të gjitha këto goditje për hir të disa kohëve të reja, më të mira, për gratë e tjera, për fëmijët tanë. Nuk bëj thirrje për martirizim dhe sakrificë dhe dënoj ashpër sulme të tilla dhe gjithçka që kanë kaluar disa kolege dhe gra në Mal të Zi. Nga ana tjetër, bëj thirrje që të jenë edhe më të forta që të gjitha këto goditje të mpiksen dhe në periudhën e

ardhshme femrat të zënë vendet që realisht u takojnë dhe i takojnë njëlloj të gjithëve në vendin tonë. Jetoj për ditën kur do të mund të ulemi dhe të themi se Mali i Zi ofron mundësi të barabarta për të dyja gjinitë.

**QAQ: Më herët keni folur për rëndësinë e arsimit në këtë fushë. A mendoni se duhet të punojmë më shumë me meshkujt brenda partive dhe deri diku të sensibilizojmë disa prej tyre?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Absolutisht, por kjo varet edhe nga rajone të ndryshme në Mal të Zi. Nuk do të them se patriarkia është në fuqi në disa pjesë të Malit të Zi, sepse jam i kënaqur me atë se si ecë përpara vendi, por ndoshta nuk është e njëjta mënyrë e të menduarit në Rozhajën time apo Nikshiq, ose le të themi në Podgoricë. Ne duhet të arrijmë atë nivel të vetëdijes që ata të mendojnë njësoj kur bëhet fjalë për të drejtat e grave, si në Rozhajën time ashtu edhe në Budva, për shembull. Kemi shumë punë dhe duhet të punojmë në këtë drejtim.

**QAQ: Në momentin e përpilimit të listës zgjedhore, a keni hasur ndonjë lloj sfide apo problem sa i përket numrit të grave, pra përfaqësimit të grave në listë? A tregojnë ato vetë një lloj iniciative për ta gjetur veten në atë listë, apo e gjithë kjo shkon si një proces "artificial"?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Jam i kënaqur me mënyrën se si shkon ai proces, posaçërisht në partinë tonë. Kur e propozuam listën, vizituam të gjitha bordet komunale dhe ndër të tjera biseduam me përfaqësueset e forumit të grave. Jam veçanërisht i kënaqur me dy-tre borde komunale që shprehën gatishmërinë e tyre për të qenë lart në listën tonë. Ndaj ndjej se kjo energji ekziston, por që duhet të drejtohet pak më shumë. Dhe besoj se tek gratë shkon shume me lehte se tek burrat, me duket se gratë janë shume me te pergjegjshme. Pra, nuk kishte probleme me listën, gratë treguan ambiciet e tyre dhe mendoj se ndoshta nuk kanë marrë të gjitha pozitat që dëshironin në listë, por ne u dhamë shansin që ndoshta shumë shpejt të bëhen deputete. Me këtë ne vërtet dërguam një mesazh dhe ky ishte qëllimi im kur vizitova bordet, se partia po piqet dhe se na duhet forca e grave, por edhe ato duhet të shfrytëzojnë rastin. Ndër të tjera thashë se e di që gratë boshnjake nuk kanë vetëm Strujiq si luaneshë, por kanë mijëra gra të tilla, por duhet t'i njohim dhe t'u japim shans. Më duket se kjo është prituri mirë nga borde të caktuara komunale dhe se në periudhën e ardhshme do të tregojmë përmes daljeve publike dhe jetës politike se kemi shumë gra që mund të bëjnë, nëse jo të njëjtën gjë, ndoshta edhe një punë më të mirë se Strujiq.

**QAQ: Nëse nuk gaboj, keni pasur 41% gra në listë, që do të thotë se jeni në listën e dytë me numrin më të madh të grave. Nga ana tjetër, kemi qenë dëshmitarë se në shumicën e rasteve gratë janë të përfaqësuara në listat e tjera zgjedhore për zgjedhjet parlamentare pothuajse në masën minimale të kërkuar me ligj. Pse është kështu? Dhe a mendoni se kuotat, si masë e veprimit afirmativ, janë një lloj zgjidhjeje e përkohshme, apo kanë potencialin për të ndryshuar rrënjësisht situatën?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Unë jam avokat i nivelit të lartë të kulturës politike në skenën tonë politike në Mal të Zi. Më lejoni të mos komentoj partitë e tjera, mund të flas vetëm për partinë tonë. Nuk më pëlqen të përfshihem në punët e partive të tjera dhe do të doja që të mësojmë njëri-tjetrin të i mos hyjmë në oborr të tjetrit. Ne tregojmë me veprimet tona se duam që gratë të marrin pjesë më aktive në të gjitha sferat e jetës socio-politike. Por, duhet të kuptojmë se nuk kemi nevojë që ligji të na detyrojë, por duhet të japim një kontribut në kuptimin e vërtetë, kështu që nëse një burrë meriton një vend më të mirë në listë, ai duhet të jetë aty. Por nëse është një grua, atëherë ajo duhet të marrë atë pozicion. Dhe ne duhet të fillojmë ta jetojmë atë, duke mos u fshehur pas ligjeve dhe normave. Për shembull, në Bijello Pole, ne hapëm shpejt një pozicion për një këshilltare e cila ka treguar me aktivitetet e saj se mund ta përballojë atë. Ne e kërkojmë atë cilësi tek gratë, sepse është një vlerë shtesë për të gjitha partitë, jo vetëm për ne. Ndaj jetojmë jetën në maksimum, që të mos jemi të detyruar nga ligjet dhe kuotat, por nga cilësia e kandidatëve të propozuar, qofshin burra apo gra. Prandaj i bëj thirrje edhe një herë



grave ashtu siç janë, të guximshme, të përfitojnë nga shansi i tyre, të vijnë tek ne, të kontribuojnë në cilësinë më të mirë të punës së Partisë Boshnjake dhe të afirmojnë të gjithë potencialin e tyre që e kanë.

**QAQ: Keni thënë që nga referendumi, shihni një lloj progresi sa i përket përfaqësimit të grave në politikë. Megjithatë, shifrat në këtë moment tregojnë se nuk do të kemi një progres të tillë as në këtë seancë të kuvendit dhe do të shohim se si do të jetë situata me pushtetin ekzekutiv. Cilat janë supozimet e juaja?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Mendoj se nga viti 2020 është një mjedis atipik në skenën politike në Mal të Zi, i cili mund të vlejë si pikë referimi kur bëhet fjalë për barazinë gjinore. Pra, le të themi, kemi një zonjë për kryetare të Kuvendit. Kjo është ndoshta gjëja më e mirë që ka ndodhur në tre vitet e fundit. Nga ana tjetër, skena politike çdo vit është ndoshta më e pakta e cilësisë që do të dëshironim. Prandaj e theksoj, kur kthehemi në bisedën për bordet komunale dhe lokale, gratë duhen të përdorin zërin e tyre dhe të kërkojnë vendin e tyre. Unë mendoj se Qeveria e 44-të do të jetë mirëkuptuese nëse Partia Boshnjake ka një grua në atë Qeveri, por për këtë vendosin autoritetet e partisë, kështu që do të shohim.

**QAQ: Kur flasim për disa pozicione drejtuese në shoqëri, a mendoni se ka pozicione në disa sektorë, si siguria, mbrojtja etj. rezervuar paraprakisht për burra? Pse u jepen më shumë pozita grave, për shembull, në arsim, shëndetësi, etj.? Si mund t'i ndryshojmë këto rregulla të pashkruara dhe a ka vullnet nga partitë dhe vendimmarrësit e ardhshëm për ndryshime të tilla?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Nëse bëjmë ndeshje, në të cilën cilësia përcakton më të mirën, atëherë edhe gratë do të gjejnë vendin e tyre në të. Unë nuk kam asnjë problem me këtë. Dhe njoh disa vende ku gratë udhëheqin punët e brendshme. Ne kemi pasur për ministre të Mbrojtjes në Qeverinë e 42-të një grua. Megjithatë, jam i mendimit se referenca bazë duhet të jetë cilësia. Dhe ndoshta na duket shumë e diskutueshme, dhe ndoshta është e diskutueshme, por ato rregulla do të sjellin ekuilibër kur bëhet fjalë për barazinë gjinore. Për mua, pikë referimi është cilësia dhe ajo që duhet të afirmojmë dhe të avokojmë është që gratë të diplomohen nga shkollat më cilësore. Askush nuk ikën nga cilësia. Kështu që besoj se receta më e mirë janë referencat dhe një ndeshje e mirë, e ndershme. Dhe atëherë nuk do të shikojmë se kush është në cilin vend - nëse është një grua apo një burrë.

**QAQ: Sipas jush, cilët janë mekanizmat për përfshirje më të madhe të grave në politikë, dhe për forcimin e lidërshiptit femëror në politikë, dhe ku e shihni ju pengesën më të madhe? Kush mban përgjegjësinë më të madhe?**

**ERVIN IBRAHIMOVIC:** Duhet të pranojmë se burrat kanë pjesë të madhe të përgjegjësisë. Megjithatë, nga ana tjetër, pres një proaktivitet shumë më të madh nga vetë gratë. Mendoj se ky është çelësi i gjithçkaje. Proaktivitet më i madh nga vendi ku jetojnë, nga vendi i punës etj. Si kryetar i partisë dhe sigurisht të gjithë kolegët e mi në parti të tjera, kur hasin në kualitet, nuk e kanë luksin ti shmangen. Gratë duhet të fillojnë të shtyjnë më të mirën mes tyre dhe nuk ka asnjë president apo parti që më pas do të ishte në gjendje t'i kundërvihej atij mesazhi të fortë të grave, se ato nuk duhet të mbulojnë një pozicion të caktuar. Ftoj të gjitha gratë që të dalin përpara me mençurinë, vendosmërinë, guximin dhe inteligjencën e tyre dhe të përfshihen më mirë në sferat socio-politike të jetës.

**ADRIJAN VUKSANOVIC, bartës i listës NCK – Në anë të drejtë të botës**

**QAQ: A e njeh partia juaj politike rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Si shfaqet ky qëndrim brenda partisë?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Jam i lirë të them se e njeh dhe kemi mjaft argumente për këtë. Në udhëheqjen

aktuale të Nismës Qytetare Kroate kemi një numër të konsiderueshëm grash në Kryesi dhe në Bordin Qendror, si organi më i lartë i partisë ndërmjet dy Kongreseve, si dhe kryetaren e bordit komunal të NCK në Kotorr. Më parë kishim kryetare partie dhe përfaqësuesen në Kuvend. Prandaj, NCK e ka afirmuar gjithmonë gruan në politikë sepse ne e kemi njohur si vlerë. Nga ana tjetër, në këtë mënyrë, ne donim t'i prezantojmë gratë para publikut si dikush që mund të kontribuojë në shoqëri dhe në çdo aspekt tjetër të jetës në Mal të Zi.

**QAQ: Si e vlerësoni pjesëmarrjen e ulët të grave në jetën politike dhe në pozitat vendimmarrëse? Cilat mendoni se janë arsyet për këtë?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Ka shumë arsye. Ne jemi shoqëri që nuk stimulojmë angazhimin social të grave. Fatkeqësisht, kemi dëgjuar edhe në Kuvendin e Malit të Zi që gratë duhet t'i zvogëlojnë vendet e tyre të punës në ato shtëpiake, familjare... Mendoj se bëhet fjalë për faktin se ka nga ata që kanë frikë gratë e forta. Prandaj, ky emërtim social nuk është i përshtatshëm për aktivitetet e grave dhe për kontributin e tyre në politikë. Por besoj gjithashtu se të gjitha ato që arrijnë të depërtojnë dhe të shprehen në skenën politike, pikërisht në një mjedis të tillë, përfaqësojnë gra jashtëzakonisht cilësore dhe të vlefshme për skenën tonë politike dhe shoqërore. Unë kam qenë i bindur shumë herë se mënyra e të menduarit të gruas mund të kontribuojë në arritjen e rezultateve dhe gjithçka që është e rëndësishme për misionin e një partie.

**QAQ: A do të thotë kjo që më shumë gra në vende/pozita vendimmarrëse dhe më shumë gra që do të ishin frymëzim për të tjerët, mund të inkurajojnë ato gra që kanë frikë nga të folurit publik të flasin publikisht dhe të angazhohen politikisht. A është kjo një nga zgjidhjet?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Ju e dini se ne jetojmë në një mjedis tensionesh në të cilat politika shpesh gjeneron këto tensione. Diku jam i mendimit se qasja e grave do të kontribuonte pozitivisht në qetësimin e këtyre tensioneve, por duhet të krijohen kushte që gratë të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin vendime. Unë nuk jam nga ato që mendoj se gratë *apriori* marrin vendimet e duhura, por mendoj se në shumë mënyra veprojnë më kreativitet, me më pak tension, gjë që është e mirë për shoqërinë në tërësi. Prandaj, duhet t'u sigurohen të gjitha kushtet për shprehje politike dhe të inkurajohen që të luftojnë vetë për një status të tillë.

**QAQ: Në situatën aktuale socio-politike, gratë janë të demotivuara apo kanë frikë të flasin publikisht dhe të jenë objektiv i akuzave, komenteve negative dhe fushatave negative? Çfarë keni bërë, brenda partisë dhe tani si bartës i listës, për të motivuar/frymëzuar/inkurajuar gratë që të përfshihen më shumë dhe të flasin publikisht?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Në përgjithësi, nuk është e lehtë të jesh grua në politikën malazeze. Ndërsa Ju po ma bëni këtë pyetje, mendoj për shumë gra që në fushën politike dhe në atë lloj ekspozimi të plotë, përjetuan edhe disa sulme seksiste, përmbajtje primitive që u desh ti duronin... Dhe kjo gjë është në përgjithësi e keqe. E keqja tjetër është se nuk ka dënim adekuat publik për të, dhe pastaj një fjalim i tillë mosrespektues ndaj grave nga disa aktorë perceptohet si afirmativ. Kjo gjë flet edhe për gjendjen e shoqërisë sonë dhe gjendjen e politikës. Jam i kënaqur që NCK në tregun politik në Mal të Zi ka kulturën e dialogut dhe kështu dëshiron t'u imponohet votuesve. Dhe se jemi si kjo që po flas tani, e dëshmon edhe lista jonë për zgjedhjet parlamentare. Në listën e NCK-së ishin 40.9% gra. Përballë nesh është vetëm grupi i votuesve NE MUNDEMI, dhe ne jemi të dytët në radhë, gjë për të cilën jam shumë i lumtur. Po të marrim parasysh edhe faktin që jemi parti e pakicës dhe që deri diku me atë logjikë do të kishim problem me anëtarët që duan të aktivizohen në politikë, kemi arritur të zëmë një vend të dytë të jashtëzakonshëm. Për mendimin tim, ky është një fakt që duhet respektuar dhe ne do të vazhdojmë të afirmojmë politikën e NCK-së në këtë drejtim.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**ADRIJAN VUKSANOVIQ:** Është keq që në pyllin e të gjitha llojeve të ngjarjeve në Mal të Zi ndonjëherë humbasim, poashtu dhe publiku ynë, i cili mbulohet përditë me konglomerate të ndryshme të përmbajtjeve mediatike, humb nga sytë atë që është e rëndësishme, pra nuk ka rezonancë sociale. Por, nëse nuk ka rezonancë sociale, duhet të ketë një përgjigje të qartë institucionale ndaj fenomeneve të tilla. Më duhet të them se NCK është ngritur shpesh në mbrojtje të grave. Tani më kujtohet kur ish-ministria e Shëndetësisë, zonja Jelena Boroviniq Bojoviq u ekspozua ndaj sulmeve të tilla, ne, edhe pse i përkasim strukturave të ndryshme politike dhe jemi në qëndrime të kundërta ideologjike, qartazi dolëm dhe e dënuam një gjë të tillë. Dhe kështu do të sillemi edhe në të ardhmen, sepse duam të jemi konsekuent dhe pa dallim në fenomene të tilla që prishin atë që quhet shoqëri e shëndoshë.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu? A janë ato çështje të parëndësishme, apo disa të tjera janë më të rëndësishme dhe sjellin më shumë pikë politike, apo ka ndonjë arsye tjetër?**

**ADRIJAN VUKSANOVIQ:** Ne jemi shoqëri që rëndohemi me të ashtuquajturat tema të mëdha dhe është e qartë se jemi të ndarë thellë. Në atë përplasje idesh dhe pikëpamjesh të ndryshme se cila duhet të jetë perspektiva e Malit të Zi, ai zë femëror diku humbet. Por, nga këndvështrimi i grave, do ta shihja edhe si shans. Vetë mjedisi për të cilin po flisja - mospëlqimi për gratë - mund të jetë një shans për ato që të dallohen. Si në jetë, ashtu edhe në politikë. Çdo situatë krize është gjithashtu një mundësi për të dalë nga ajo më mirë dhe më e fortë. Është konstruktive. Nuk rritesh në rehati, rritesh në sfida, kështu që unë do t'i inkurajoja gratë që ta pranojnë atë si sfidë. Nga ana tjetër, mund të shohim qartë se disa politikane janë gjithashtu shumë të njohura. Prandaj nuk do të isha pesimist, përkundrazi. Jemi të vetëdijshëm për të gjitha problemet që na rëndojnë, por me punë këmbëngulëse, me besnikëri ndaj këtyre parimeve, do të kontribuojmë që gjërat të përmirësohen.

**QAQ: A janë këto çështje (çështje të përgjithshme të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave, por edhe të drejtat e tyre kulturore, sociale, seksuale dhe riprodhuese, fuqizimi ekonomik, lufta kundër dhunës ndaj grave, etj.) tani/apo kanë qenë ndonjëherë axhenda zyrtare e partisë suaj politike? Dhe a ka bërë ndonjëherë partia, veçanërisht për këto zgjedhje parlamentare, një fushatë për këtë çështje, a ka pasur përpjekje brenda partisë ta avokoj më fortë publikisht këtë çështje?**

**ADRIJAN VUKSANOVIQ:** Ne nuk i kemi theksuar këto çështje në fushatë, por përsëri unë si bartës i listës dhe si përfaqësues i partisë jam shumë i kënaqur me numrin e madh të aktiviteteve të gjeneruara nga gratë, pra nga pjesa e grave në partinë tonë, dhe lirisht mund të them se ato e bërë fushatën. Tani po hyjmë në fazën finale, por më vjen mirë që në këtë kohë të disa krizave u shfaqën gra të reja që me aktivitetet e tyre kontribuan në afirmimin e NCK-së dhe lirisht mund të them se në disa situata krize dhe të ndjeshme qëndruan në vijat e para. Tani nuk do ta rëndoj publikun, por nga media dihet se në këtë fushatë kemi pasur disa incidente që shqetësojnë publikun tonë dhe gratë kanë qenë ato që janë të parat në mbrojtje të politikave të NCK-së.

**QAQ: A do të thotë kjo se ju besoni se mjedisi për pjesëmarrjen politike të grave brenda partisë suaj**

**është inkurajues dhe se grave brenda NCK u jepet hapësirë e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e tyre?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Mendoj se po. Kurrë nuk i kemi trajtuar politikat e grave të NCK-së me përbuzje. Përkundrazi, ne shohim në to, si në të gjitha strukturat apo segmentet e tjera të NCK-së, një potencial të madh që duam të afirmojmë.

**QAQ: Çfarë forca ka Forumi i Grave të NCK-së, në çfarë mase është faktor aktiv?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Forumi i Grave është aktiv dhe udhëhiqet nga profesoresha Dijana Millosheviq, një person i gjithanshëm, një profesoreshë e matematikës, e cila gjithashtu udhëheq një grup teatrore brenda komunitetit tonë kombëtar dhe që njihet politikisht. Ajo është një nga shembujt e vërtetë të veprimtarisë së grave brenda partisë sonë.

**QAQ: A organizon partia juaj trajnime, seminare për lidhshirë apo në ndonjë mënyrë tjetër edukon anëtarët/et e saj për barazinë gjinore dhe çështjet e lidhura me to?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Fatkeqësisht, nuk patëm mundësi t'i kryejmë këto aktivitete sepse kemi gati tre vjet që jemi jashtë Kuvendit, që do të thotë se jemi në një situatë të vështirë. Ne jemi të fokusuar në këto zgjedhje për të rifituar statusin parlamentar dhe për të hyrë në atë që quhet jeta e rregullt politike, por ky është sigurisht synimi ynë. Si qëllim që synojmë, më lejoni të bëj digresion, t'i kushtojmë një vëmendje edukimit të rinjve tanë. Të njëjtën gjë do ta bëjmë edhe me Forumin e Gruave. Ata kishin aktivitete në kuptimin e vizitimit të pjesëve të caktuara, qyteteve, vendosjes së marrëdhënieve me organizata të ngjashme brenda partive të tjera etj. Por ajo që është e rëndësishme për mua si kryetar i partisë është që NCK, nëse shikojmë në përqindje, ka një numër të lakmueshëm grash që mund t'i përgjigjen sfidave të caktuara në çdo kohë. Kemi gra të njohura në shoqëri, si p.sh., profesoresha Dijana Millosheviq, pastaj Bllanka Radosheviq Maroviq, e cila ishte drejtoreshë e Drejtorisë në Ministrinë për të Drejtat e Njeriut dhe të Pakicave, etj. Ato marrin pjesë aktive në fushatë, dalin në shfaqje televizive, ekspozohen në media dhe kjo është diçka që ne e vlerësojmë. Në fund të fundit, nëse nuk do të ishte kështu, nuk do të kishte një përqindje të tillë të grave në listë.

**QAQ: Si mund të kontribuojnë burrat brenda partive në fuqizimin politik të grave dhe çfarë veprimesh duhet të ndërmerren për të rritur nivelin e pjesëmarrjes politike të kësaj pjese të popullsisë?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Burrat e dobët kanë frikë nga gratë e forta. Por burrat e dobët kanë frikë edhe nga burrat e fortë. Sidoqoftë, një goditje e veçantë për egon është një grua e fortë për një burrë të dobët. Unë besoj se duhet të krijohet një mjedis që do të jetë stimulues për rritje dhe krijimtari, dhe mjedisi i tillë përbëhet nga njerëz që janë vetë, krijues, stimulues, që nuk e masin veten me të tjerët, por me veten dhe e krahasojnë veten me atë që kanë qenë dikur dhe çfarë janë tani. Në fakt, hyjmë në fushën shpirtërore dhe përgjigjeje që të gjithë duhet ta japim për veten tonë. Është e njëjtë si kur vrapon. Është gjithmonë më mirë ta bësh me dikë që është në gjendje më të mirë se ti, sepse kështu do të arrish edhe më shumë dhe më mirë sesa të kënaqësh egon tënde me dikë që është më i dobët se ti dhe që është shumë prapa teje. Kjo është mënyra e vetme që ne mund të rritemi. Vetëm në atë mjedis, që quhet konkurrencë e shëndoshë, dhe është formë e rivalitetit të shëndoshë.

**QAQ: Kur flasim për jetën politike të Malit të Zi në përgjithësi dhe për pozicionet vendimmarrëse, a mendoni se ka pozicione në disa sektorë, si siguria, mbrojtja etj. rezervuar paraprakisht për burra? A ishin ato dominante punët e burrave deri tani? Nëse po, si mund të ndryshojë?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Epo, padyshim që po. Shkaktohet nga vetëdija jonë, ato funksione që ndonjëherë perceptohen si burrërore dhe i përkasin përsëri burrave. Nuk mendoj se kjo është gjë e mirë *a priori*, ashtu siç nuk mendoj se është mirë që të jetë grua *a priori*. Nuk e favorizoj asnjërën. Dua vetëm që të kemi një mjedis barazie dhe pozicioni fillestar të jetë i barabartë për të gjithë. I kuptoj edhe disa rrethana të tjera sociale, familjare etj. Pra, dikush e fillon garën 10 metra përpara, dhe dikush 20 metra prapa. Ajo që ne duhet të përqijemi është pozicioni fillestar i barabartë për të gjithë.

Ministritë që kanë diçka militante, si ushtria apo policia, perceptohen si funksione për burra. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se burrat do ta bëjnë më mirë se një zonjë e cila është profesioniste, e arsimuar dhe ka habitusin e duhur për të kryer funksionet për të cilat po flasim në mënyrën më të mirë. Unë mendoj se një grua ka një mundësi të jashtëzakonshme nëse tregon potencialin, intelektualitetin, guximin e saj - do të jetë në avantazh, para ndonjë rivali mashkullor me të cilin lufton për pozicion të caktuar ose konkurrin në garë zgjedhore.

**QAQ: Sipas jush, cilët janë mekanizmat për përfshirje më të madhe të grave në politikë, dhe për forcimin e lidershit femëror në politikë? Dhe ku e shihni ju pengesën më të madhe?**

**ADRIJAN VUKSANOVIC:** Edhe në mandatin aktual në Kuvend e keni Klubin e Grave. Unë nuk kam qenë në Kuvend gjatë këtij mandati, por kam parë nga mediat dhe nga bisedat me deputete se ka funksionuar shumë mirë, se solidariteti i grave është zhvilluar në atë mënyrë. Kjo është mirë, sepse të gjitha i përkasin subjekteve, ideologjive, këndvështrimeve të ndryshme, e megjithatë u mblodhën rreth emëruesit të përbashkët – aktivizmi i grave në politikë. Është formë e mirë, përmes së cilës mund të shprehësh gjithçka që është e rëndësishme për afirmimin e grave në politikë.

VLLADIMIR LLEPOSAVIQ, bartës i listës „Drejtësi për të gjithë!“

**QAQ: Lista juaj zgjedhore a e njej rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Nëse po, si manifestohet?**

**VLLADIMIR LLEPOSAVIQ:** Nuk folëm konkretisht për të drejtat e grave dhe kjo mund të jetë një gabim, sepse e konsiderojmë normale, të natyrshme dhe të detyrueshme që barazia të mos vihet në pikëpyetje, veçanërisht barazia e dy identiteteve më të vjetra të llojit njerëzor - mashkullore dhe femërore. Ne u përpoqëm të japim kontributin tonë duke i angazhuar gratë në politikë, në lëvizjen tonë, duke filluar me shkrimin e programit në të cilin gratë morën pjesë aktive. Në një ekip të ngushtë, gratë ishin të barabarta me burrat numerikisht, edhe pse në listën tonë janë rreth 30% gra. Përveç kësaj, ne kishim një grua jo në vendin e katërt, por në vendin e tretë. Dhe kjo sepse ne menduam se një person me përvojën e saj personale, rëndësinë, sakrificën, peshën politike, ishte më e denjë të jetë aty sesa disa burra. Pra, ne kishim një grua para burrave që mund të jenë më të rritur, me arsim më të lartë, por jo sepse donim që gruaja të fitonte një avantazh artificial, por sepse ajo është një grua punëtore. Parimi ynë është se gratë kanë nevojë për mbrojtje, jo sepse janë gjinia më e dobët, por sepse janë po aq të vlefshme sa burrat, dhe të dyja janë qenie njerëzore. Ne nuk duam një qasje paternaliste ku grave u jepet çka do, sepse askush nuk duhet t'u japë grave asgjë, ato janë qenie njerëzore me vlerë të barabartë. Si dikush që është tradicional, mendoj se në disa aspekte të jetës dhe punës, gratë janë edhe më të vlefshme edhe më të forta, ashtu si në aspektet e tjera të punës apo jetës gjinia më e fortë janë burrat, për sa i përket forcës fizike, ndërsa për gratë flasim për mëmësinë, për talentet etj.

Ne jemi të vetmit në pozicionin e qendrës politike, të gjitha partitë e tjera janë ekstrem majtas dhe djathtas dhe herë pas here shkapërcejnë. Balancimi i qasjes sonë politikisht dhe juridikisht vetëm tregon barazi. Drejtësi

për të gjithë. Çfarë do të thotë barazia dhe çfarë do të thotë drejtësia? Do të thotë që të barabartët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, dhe të pabarabartët ndryshe. Sepse është padrejtësi kur trajton personat e pabarabartë në të njëjtën mënyrë. Prandaj, personat me aftësi të kufizuara dhe personat pa aftësi të kufizuara nuk mund të kenë të njëjtën akses dhe nuk mund të kenë të njëjtat pritshmëri prej tyre. Një burrë dhe një grua nuk mund të kenë të drejta plotësisht identike, nuk mund t'i mohojmë gruas të drejtat që ajo ka nga natyra e identitetit të saj, para së gjithash biologjike, e pastaj edhe identiteti gjinor sociologjik. Madje është e panevojshme të theksohet se ne jemi për barazinë e burrave dhe grave, gjë që nuk do të thotë se nuk duhet të luftojmë për të dhe se nuk duhet ta përmendim atë, veçanërisht në kontekstin e dhunës që vuajnë gratë për shkak të disa traditave dhe stereotipeve të këqija.

Tradita fillon nga “*tradere*”, që do të thotë të transferosh. Tradita është e mira që transmetohet, ndërsa e keqja nuk duhet të transmetohet, nuk është traditë. Prandaj, një shoqëri ekstreme patriarkale në të cilën gratë nuk kanë të drejtën e votës nuk është traditë për mua, sepse nuk e plotëson atë kriterin e transferueshmërisë. Në të kaluarën kemi një rol të vështirë por edhe të rëndësishëm për gruan, por pozita historike e gruas ka ndryshuar ligjërisht dhe politikisht.

Kur i kemi zgjidhur personat për listën dhe kur kemi diskutuar pozicionet, nuk i kemi kushtuar rëndësi nëse është burrë apo grua dhe asnjëherë nuk zgjedhëm gratë për shkak të numrit. Më vjen mirë që ka detyrim ligjor që një numër i caktuar kandidatësh për deputetë të jenë gra.

Mendoj se është mirë që kohët e fundit gratë thjesht janë në përputhje me të drejtat e tyre, gjithnjë e më pak kanë frikë nga dënimi publik apo ndonjë gjë tjetër, të paktën ajo që shoh unë, është se ato marrin pjesë në mënyrë të barabartë në politikë dhe angazhohen në jetën publike. Sigurisht që disa gjëra duhet të korrigojohen, për ne më e rëndësishmja është lufta kundër dhunës ndaj grave, për barazinë e grave dhe burrave në të ardhurat. Është e papranueshme që gratë të paguhen më pak se burrat për punë me të njëjtin kualifikim profesional. Ky është krim dhe hipokrizi dhe injorancë dhe mëkat si në kuptimin juridik ashtu edhe në atë shpirtëror. Këto gjëra janë shumë të rëndësishme - lufta kundër dhunës, të drejtat e barabarta të grave në aspektin e aftësisë së tyre për të marrë pjesë në jetën politike dhe të drejtën për të fituar njësoj si burrat. Natyrisht, nëse tashmë ka dallime biologjike dhe disa predispozita midis burrave dhe grave, ato do të zëvendësohen nga punët e ndryshme, por në ato punë ku mund të jenë njësoj të suksesshme dhe punë të tilla sot janë 90%, është e papranueshme të ekzistojnë dallime të tilla.

Për më tepër, të drejtat e grave duhet të mbrohen veçanërisht në ato zona ku gratë janë të ekspozuara ndaj abuzimit për shkak të rolit të tyre dhe, mbi të gjitha, të amësisë. Ne jemi shumë të interesuar dhe kemi folur për këtë të drejtë në programin tonë, pushimin e lehonisë, mbrojtjen e gruas nga largimi nga puna dhe nga kushtëzimi nga lidhja e një kontrate pune me afat të caktuar në lidhje me shtatzëninë. Një grua nuk duhet pyetur nëse ka në plan të mbesë shtatzënë. Si pjesë e së drejtës së saj, e drejta për të lindur dhe për të mos lindur. Çdo e drejtë që nënkupton të bësh diçka nënkupton edhe mosbërjen e saj. E drejta e punës nënkupton edhe të drejtën për të ndejtur në shtëpi dhe për të mos punuar, sepse ndryshe do të kishim skllavëri. Ne, si specie njerëzore, ia detyrojmë ekzistencën tonë grave, të paktën në nivel biologjik. Duhet të jemi ligjërisht shumë të ndjeshëm ndaj këtij roli të mëmësisë. Dhe sipas gjithë atyre abuzimeve që kanë të bëjnë me të. Mendoj se është e rëndësishme të fillojmë nga kjo - që mbrojtja nuk u jepet atyre, por se ata meritojnë mbrojtje dhe se të drejtat natyrore të njerëzve - si të grave ashtu edhe të burrave - janë të drejta themelore të njeriut që u përkasin atyre që nga lindja, me faktin se janë qenie njerëzore. Pra jo si gjinia e dobet, une personalisht nuk e perdor në fjalorin tim, me duket se nuk e kam përodur kurrë, që jo vetëm është jo inteligjente, por edhe fyese. Nga ana tjetër, mendoj se sistemi ynë ligjor duhet të rregullohet vazhdimisht dhe organizatat e grave duhet të luajnë një rol në këtë.

**QAQ: E keni fjalën për OJQ-të e grave dhe ato që merren me këto dhe çështje të ngjashme apo forumet e grave brenda partive?**

**VLLADIMIR LLEPOSAVIQ:** Dua të them të dyja. Kur ka një forum të grave në parti, kjo do të thotë se gratë nuk janë tashmë të barabarta në atë parti, ndaj duhet të kenë një forum. Si pakicë. Për të qenë pakicë, duhet të jesh numerikisht, prandaj dhe i rrezikuar, pra merr të drejta të veçanta. Unë e mbështes që me forumet e grave në përgjithësi, e kuptoj poentën, por ne nuk kemi nevojë të kemi një forum të grave, sepse gjysma e anëtarëve tanë në takime janë gra. Ose ndoshta një e treta, në varësi nga momenti. Ato janë gjithashtu anëtare të barabartë dhe ne flasim si njerëz, si qytetarë që ndajmë të njëjtat bindje politike dhe morale, dhe jo si burra e gra, ai dallim është krejtësisht inekzistent. Përveç nëse ky ndryshim duhet të kodifikohet për diçka pozitive, për ndonjë status. Forumet e grave në parti janë produkt i neglizhencës së grave dhe të drejtave të tyre, kështu që forumi i grave e kompenson atë. Por nese jane te barabarte ne ate parti, atehere nuk duhet te kete, se atehere mund te kishim nje forum per flokëkuqe, te rinj deri ne 21 vjeç, nje forum per ata qe kane gjatesi deri diku... Ne nuk kemi forum të grave sepse mendojmë se nuk është e drejtë, kujton ato institute për minoritetet që kërcënohen numerikisht, ndoshta nën presion për të braktisur identitetin e tyre, ndaj u jepen të drejta të veçanta për ta ruajtur atë.

**QAQ: Ndoshta gratë nuk janë pakicë në shoqëri, por gratë në Kuvend janë ende pakicë dhe ky numër nuk është as afër përmbushjes së kuotës minimale prej 30%?**

**VLLADIMIR LLEPOSAVIQ:** Numri i grave në politikë ndryshon. Megjithatë, liria e zgjedhjes është shumë e rëndësishme. Për mua si njeri, edhe si avokat dhe së fundmi edhe politikan, është e rëndësishme që gratë të kenë të njëjtat mundësi dhe të drejta si burrat, për të marrë pjesë. Ne jemi parti e qendrës dhe unë personalisht jam liberal politik, apo edhe liritar, për mua është e rëndësishme liria e përcaktimit personal, e konsideroj një kategori qendrore të jetës personale dhe politike. Kështu, liria e përcaktimit personal dhe liria personale, kufijtë e së cilës janë vetëm të barabartë me lirinë e të tjerëve. Ajo u përcaktua nga romakët e lashtë. Mirëpo, nëse nisesh nga ato aspekte negative të politikës – që politika është një biznes i ndyrë, ku grushta jepen e merren në nivel të ulët, ku veprimet e pandershme janë normale – atëherë gratë zgjedhin të mos marrin pjesë në politikë, ndoshta pikërisht për shkak të pikëpamjeve të tyre estetike, morale e të tjera. Pikëpamja ime për botën e burrave dhe grave nis nga arsyeja se janë në *in favorem* të grave. Por keni edhe aktivitete të tjera në të cilat nuk keni barazi. Politika mbart atë tregues të pushtetit. Sigurisht, organet qeveritare, institucionet, biznesi privat, korporatat janë të rëndësishme. Nis nga fakti që politika apo Kuvendi është vendi ku krijohet pushteti politik, ndaj pyetja legjitime është se pse nuk ka mjaftueshëm gra atje. Por, ju e dini që pushteti nuk krijohet hapur në Kuvend, por në media, mes sponsorëve, korporatave që qëndrojnë pas tyre. Është legjitime që gratë dhe organizatat e grave të shqyrtojnë vazhdimisht pse numri i grave nuk është më i madh, por në mënyrë që të respektohet vendimi i grave të tjera dhe për të lërë hapësirë për mundësinë që në një numër të caktuar rastesh prania e ulët e grave është pjesërisht pasojë e vullnetit dhe vendimit të tyre. Njoh shumë burra dhe gra që nuk duan të merren me politikë. Ata zgjedhin një jetë më të këndshme, një punë që është më pak stresuese. Nuk mendoj se kam takuar një person të tillë në mjedisin tim dhe as kam dëgjuar ndonjëherë argumentin se një person nuk duhet të merret me politikë sepse është grua.

**QAQ: Ju keni prekur më parë frikën e dënimit publik që ekziston tek gratë dhe ekspozimit ndaj “pisllëkut” të politikës, siç e deklaruat, por cilat do të ishin tjetër arsyet e përfaqësimit të ulët të grave në jetën politike dhe pozitat vendimmarrëse?**

**VLLADIMIR LLEPOSAVIQ:** Ndoshta e gjitha ka të bëjë me mëmësinë. Unë prirem të besoj në qasje socio-biologjike, e cila është disiplinë që përpiqet të shpjegojë të gjitha fenomenet shoqërore në bazë të ligjeve natyrore. Dhe pastaj, duke folur socio-biologjikisht, shumë sjellje tona sociale janë zgjedhje që kushtëzohen

nga karakteristikat tona biologjike. Qofshin të lindura apo të fituara, predispozitat, karakteristikat biologjike, ekspozimi ndaj erës, verës, dimrit, vapës etj. Edhe të fituarat, sëmundje, paaftësi etj. Në këtë rast, dallimi biologjik midis burrit dhe gruas është i dukshëm, kryesisht për shkak të funksionit të lindjes, amësisë. Nuk është e panjohur në shkencë se gratë kanë një ndjeshmëri më të madhe për sigurinë e tyre dhe të trupit të tyre. Dhe kur them trupat, kam parasysh edhe gjendjen mendore edhe atë fizike, dhe ka mundësi që kjo ndjeshmëri për të mos u ekspozuar ndaj diçkaje vjen nga aty. Sigurisht, kjo është vetëm një pjesë e arsyes.

Mendoj se është gjithmonë më e mira për gratë dhe përfaqësueset e tyre si në organizatat joqeveritare ashtu edhe në parti, të veprojnë në çdo nivel, sepse çdo grua përfaqëson të gjitha gratë kur punon dhe jeton dhe lufton për bindjet e saj. Nuk është e nevojshme të jesh anëtare e një organizate për të mbrojtur të drejtat e grave. Nëse protestoni në dyqan për shkak të trajtimit, për shkak të diskriminimit ose kudo si grua, me siguri keni mbrojtur bashkëqytetaret tuaja në raste të panumërta të ardhshme. Kushdo që fiton një gjyq, që raporton dhunën, i mëson autoritetit shtetëror se ajo ka nisur të ndodh. Të drejtat i takojnë atij që i përdor, përndryshe janë një shkronjë e vdekur në letër.

Pra, mendoj se burrat duhet t'ua lënë grave vendimet e tyre, t'i mbështesin, por pa një qasje paternaliste ku burrat bashkohen dhe ia lejojnë grave të drejta të veçanta. Iniciativa duhet të vijë nga organizatat e grave, nga vetë gratë, dhe atëherë është më e natyrshme dhe më e mirë. Unë jam për pjesëmarrje më të madhe të grave, por nuk mund ta organizojmë shoqërinë matematikisht – në mënyrë që në çdo organ, në çdo moment të kemi numrin e saktë të përfaqësuesve të pakicave kombëtare, apo të të gjithë anëtarëve të përfaqësuesve politikë. Është e pamundur, jeta është më e shpejtë se ligji. Ligji është gjithmonë i përjetshëm, për të rregulluar disa gjëra, dhe përderisa këto ligje nuk e kufizojnë lirinë e grave dhe burrave, atëherë janë zgjidhje të duhura. Për të përmirësuar pozitën e gruas, është e nevojshme të eliminohen të gjitha ato barriera sociale që zgjedhin stereotipet. Le të themi, dhënia e famshme e alimentacionit ku sugjerohet që dikujt t'i jepet diçka si dhuratë. Kjo nuk është fare dhuratë, por detyrim, për shkak të detyrimit të përbashkët të kujdestarisë dhe mosdhënia e ushqimit është vepër penale dhe devijim i rëndë shoqëror. Dhe kur bëhet fjalë për barazinë gjinore në rrafshin gjuhësor, kudo që mund të ndryshohet ai legjislacion dhe barazia gjinore si në atë gjuhësor ashtu edhe në atë thelbësor në të gjitha fushat e jetës të jetë më e madhe, ne si lëvizje e mbështesim këtë. Ne nuk kemi asnjë rezervë për këtë dhe jemi të mendimit se gratë, individualisht dhe të organizuara, japin impulsin dhe sinjalin më të mirë se cilat të drejta kërcënohen dhe cilat të drejta duhet të përmirësohen.

**QAQ: Keni thënë që këto ndryshime duhet të vijnë nga vetë gratë, organizatat e grave, etj. Por a mendoni se një pjesë e atyre sinjaleve duhet të vijnë edhe nga burrat? A duhet të përfshihen më shumë, të forcohen, të arsimohen, të sensibilizohen që të jenë bashkëluftëtarë të grave në luftën e tyre?**

**VLADIMIR LEPOSAVIQ:** Në bazë të vullnetit dhe vendosmërisë së lirë, mendoj se burrat duhet të përfshihen. Duhet dy për tango, kështu është stabiliteti politik kërkon një koalicion bashkëpunues. Sportet kërkojnë që skuadra të tëra të bashkohen dhe të kryqëzohen e të punojnë së bashku. Ne kemi atë thënien e famshme që "burri nuk është ishull", pra ne kemi nevojë për njëri-tjetrin, njeriu është qenie e komunitetit – burra edhe gra. Do të ishte iluzore të mendohej se gratë do ta drejtonin luftën e tyre vetëm ose të izoluar. Kjo quhet kulturë nën xham, si dukuri negative kur komunitete të caktuara ushtrojnë të drejtat e tyre, apo identitetin e tyre, por jetojnë të ndarë për vete. Poenta është se nëpërmjet ndërveprimit me të tjerët realizohet identiteti i tyre. Dhe vetëm kur mbrohen të drejtat, në këtë rast të drejtat e grave, atëherë ato lirisht mund të vendosin në çfarë cilësie dhe në çfarë numri, në jetën e tyre, të angazhohen në çdo gjë.

Thelbi i të drejtave të njeriut qëndron në faktin se është e nevojshme që të kuptojmë se njerëzit që janë të ndryshëm nga ne janë njësoj të vlefshëm, domethënë se diversiteti kuptohet, se nuk ka frikë nga *homo nous*,



një person që është i ri në komunitet në çfarëdo mënyre, qoftë ajo grua në një shoqëri mashkullore. Vendosja e të drejtave të njeriut në shoqëri ekziston kur askush nuk ka problem me tjetrin dhe të ndryshëmin.

Pra, thelbi është në lirinë e zgjedhjes për diversitet, mendoj se në Mal të Zi po merr jetë, mjaft seriozisht dhe në kuptimin pozitiv, por duhet të forcohet më shumë. Duhet të përfshihen patjetër burrat, të gjithë ata që duan, që kanë dëshirë, mendoj se shumica janë të interesuar, por iniciativa duhet të vijë nga gratë, pra nga ato që duan ndryshim. Në këtë rast, burrat duhet të jenë mbështetës, kanë detyrimin si autoritete shtetërore, si zyrtarë, por edhe në planin privat, burrat duhet të mbështesin bashkëqytetarët e tyre në luftën për të drejtat e tyre. Megjithatë, është e rëndësishme që iniciativa të vijë nga gratë, sepse nëse do të vinte nga burrat, atëherë do të ishte një konfirmim i asaj qasjeje paternaliste ku burrat i çlirojnë gratë nga ato kufizime. Nuk ka nevojë. Gratë lirojnë vetë vetën, nëse kanë diçka për të liruar, pra ushtrojnë të drejtat që nuk i kanë arritur akoma, arrijnë të reja sepse u takojnë, dhe burrat duhet të kenë bashkpunëtorë, keshtu gjërat shkojnë natyrshëm dhe këtë e kanë treguar lëvizjet shoqërore dhe sociale të të gjitha llojeve.

Kur është fjala për luftën kundër diskriminimit, grupi që ndjeu diskriminim ishte iniciator dhe anëtarët e atij grupi morën mbështetje. Dhe sa më e madhe të ishte ajo mbështetje, do të thoshte se aksioni ishte i suksesshëm dhe se shoqëria po ndryshon. Aparteidi ndryshoi kur mbështetja për afrikano-amerikanët erdhi nga të ashtuquajturit evropianët e bardhë. Të drejtat e punëtorëve u inicuan nga punëtorët, dhe të drejtat e borgjezisë dhe qytetarëve nga anëtarët e klasës së tretë. E njëjta gjë vlen edhe për pakicat seksuale. Kjo është mënyra më e mirë. Pra, kjo është arsyeja pse është e rëndësishme të afirmohet vullneti dhe akses i lirë i të gjithëve, e drejta për të zgjedhur, dhe kur burrat përfshihen në këtë mënyrë, mendoj se është më e efektshme, me, natyrisht, një dialog të vazhdueshëm midis burrave dhe grave ku së bashku kërkojnë zgjidhje ligjore.

Sot keni raste që përmenden edhe të drejtat e burrave, për shkak të zhvillimit të vullshëm juridik të shoqërisë. Kishte pothuajse një çështje ligjore interesante, gjykimi i një padie kundër dhe nga Johnny Depp. Kemi parë dhunën e grave ndaj burrave dhe abuzimin e versioneve stereotipike sipas të cilave gratë janë gjinia më e dobët etj.

Keni edhe ato rastet e famshme të mikroagresionit, ku përpiqen të mbrojnë të drejtat e grave dhe më pas, për shkak të disa abuzimeve, edhe burrat mund të vuajnë stigmën për disa sjellje të tyre që nuk ishin të gabuara.

Shpesh flitet për abuzimin që ndodh kur dikush akuzohet për ngacim seksual, duke theksuar se çdo ngacim duhet të sanksionohet. Por duhet të sanksionohet edhe shpërdorimi i kësaj të drejte në drejtim të akuzave të rreme. Janë të vërtetuara shkencërisht të ashtuquajturat sjellje të automatizuara, diskriminime që ndodhin në mënyrë të pavetëdijshme, nga pakujdesia, ku grupet diskriminojnë pa e ditur se është e keqe, pra kur ofendon anëtarët e tjerë të grupit. Kjo është arsyeja pse dialogu është i rëndësishëm. Dhe kjo është arsyeja pse është e rëndësishme që në të gjitha seminarët, në të gjitha shkollat, në të gjitha debatet të kemi edhe burra edhe gra. Ka shumë probleme, shumë raste të diskriminimit edhe në politikë, dhe ju zgjidhni fillimisht prioritetet, ato djetëse dhe më pas kur i zgjidhni, vazhdoni.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuar ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**VLADIMIR LEPOSAVIQ:** Mendoj se është një minus i madh dhe pjesërisht do ta pranoj mbi veten time. Veçanërisht, ai portal është përfaqësues i qeverisë së mëparshme - regjimit të PDS-së, mbrojtës i atyre vlerave, i cili prej vitesh u paraqit si pikë referimi i modernitetit. Të gjithë në Mal të Zi e dinë se PDS-ja dhe të gjitha mediat e saj i kanë bashkangjitur vetes modernitetin e integritimit evropian dhe euroatlantik për një kohë të gjatë. Tani kemi rastin që kur regjimi mbetet pa pushtet, mediat dhe redaktorët e tij sillen kështu. Shumë keq, shumë keq. Më vjen keq që nuk arrita ta regjistroj më herët, që të reagojmë në atë moment. Natyrisht, i bashkangjitem dënimeve, sidomos në atë mënyrë të shënjestrojë gratë... Nëse do të ishin dy burra dhe tri gra dhe për to flitej si grup politik, atëherë do të ishte disi e kuptueshme, edhe pse është gjuhë urrejtjeje, por nuk është i orientuar nga gjinia, por i motivuar politikisht. Kështu artikulli është i motivuar politikisht dhe tregon papjekuri kulturore. Për shembull, nuk kam pse të pajtohem politikisht, le të themi, me zonzën Jellushiq, por nuk mendoj se gjinia luan ndonjë rol në këtë. Ajo është e angazhuar edhe në aktivizmin e grave në Kuvend. E di që ishte e nevojshme që Ministria e Drejtësisë që kur isha ministër të delegonte gra që duhej të merrnin pjesë në forumet e grave në Kuvend, në disa thirrje të veçanta. Mendoj se aty, për arsye të motivuara politikisht, doli në sipërfaqe një prapambetje dhe papranueshmëri kulturore, ligjërish dhe juridikisht, jo vetëm moralisht. Stigmatizimi i grave vetëm sepse janë gra.

Kur hyn në fushatë, në politikë, sheh më pak gjëra sesa kur je jashtë, sepse fokusohesh në aktivitete, keni *press clipping* dhe ndjekni sulmet ndaj partisë dhe fokusohesh në mbrojtjen e qëndrimeve. Ndërkohë që unë e shikoja politikën nga anash, kur kisha shumë më tepër kohë, lexoja shkrime dhe tekste gazetash dhe kur fillon të merresh me të në mënyrë profesionale, fokusohesh në paraqitjen sa më të mirë të ofertës tënde dhe nuk ke fuqi për të parë nga anash, të shohësh pyllin nga pemët. Për këtë arsye nuk e pashë atë tekst dhe atë rast në atë kohë. Më vjen mirë që nuk u bë aq i madh, skandaloz, por sigurisht që është për dënim.

Komenti i fshehur është hapësirë e urrejtjes individuale, jo të gjithë në shoqëri janë njësoj të zgjuar apo të shëndetshëm. Për mua është çështje e shëndetit mendor, një shkallë e tillë keqkuptimi dhe qëllimit të keq. Sepse nuk po flasim për barazinë e burrave dhe grave si diçka për të cilën mund të ketë mendim. Pra, ka një mijë debate dhe probleme, por pothuajse askund nuk mund të dëgjosh që dikush kërkon të stigmatizohet. Edhe nëse do, nuk guxon ta thotë këtë, sepse i është pjekur vetëdija. Dhe atëherë kur ke dikë që sillet dhe stigmatizon atë grup, sepse nuk i përket atij grupi, atëherë ai tregon jo vetëm qëllime të këqija, por edhe se nuk është i aftë mendërisht të angazhohet aktivisht në komunitetin e tij. Ndoshta kjo tingëllon pak ashpër, por po flas sinqerisht. Ashtu si në shkencat natyrore ekziston penicilina dhe ligjet që përdoren për të llogaritur se si të ndërtohen ura, ashtu edhe në shkencat shoqërore është kuptuar se të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe duhet të jenë të tillë.

Këta persona, përveç nevojës për t'u sanksionuar për një sjellje të tillë, kanë nevojë për mësim të vazhdueshëm. Mendoj se e kemi kaluar atë vijë të kuqe dhe çështjet e të drejtave dhe lirive të njeriut nuk mund të kthehen më në skenën ku grupet janë të persekutuar sepse janë të një ngjyre lëkure, përkatësie apo gjinie të ndryshme. Pyetja e vetme është se me çfarë shpejtësie do të ecim përpara, por këto tashmë janë incidente individuale, të cilat duhet të dënohen, por mendoj se shoqëria nuk duhet të shqetësohet për to. Ata priten me dënim moral dhe mbase qytetarët e injoruan aq sa nuk u dëgjua më, sepse e konsiderojnë mbase e tepërt të komentohet.

Kemi ardhur në situatë ku barazia dhe barazia e njerëzve janë një gjë normale. Kjo është premisa e jetës njerëzore - të gjithë jemi të barabartë ose duhet të jemi të barabartë në të drejtat tona, të barabartë para ligjit, të vlerësuar njësoj si qenie njerëzore, dhe pastaj kjo do të thotë një sërë gjërash të ndryshme. Dhe në mënyrë të barabartë të paguar për të njëjtat punë dhe të emërtuar në mënyrë të barabartë për të njëjtat tituj, të trajtuar në mënyrë të barabartë për pozitë në shoqëri, dhe pjesëmarrja e barabartë në organet administrative e kështu me radhë, gjithçka me të cilën merret organizata juaj. Por premisa është se njerëzit janë të barabartë dhe nuk

mund të stigmatizohen për shkak të përkatësisë së tyre dhe se ata janë të barabartë si qenie njerëzore. Ai revolucion filloi me Thomas Hobbes, John Locke, pas Luftës së Dytë Botërore dhe u kodifikua nga konventat për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj, nëse dikush nuk e kupton këtë, atherë ai dikush është me qindra vjet prapa, por kjo nuk e justifikon, dhuna ndaj grave, gjuha e urrejtjes duhet të parandalohet, sepse ajo gjeneron dhunë, e justifikon atë.

Gjithashtu përpiqem të mbroj idenë idenë se dënimet dhe sanksionet nuk duhet të përdoren për hakmarrje si të tilla, por për të parandaluar raste të tjera përmes parandalimit të përgjithshëm të dënimit dhe për të kompensuar dëmin, domethënë për të përcjellë mesazhin si shoqëri që disa gjëra nuk lejohen duke vendosur përgjegjësi se ato bëhen sepse dëmtojnë njerëzit dhe janë të rrezikshme për shoqërinë. Gjuha e urrejtjes është e rrezikshme dhe shpresoj të mos ndodhë më. Më vjen keq që partia jonë, e cila ka më së shumti avokatë në listë, nuk arriti ta dënojë personalisht. Megjithatë, shpresoj që të mos ketë më mundësi për këtë, dhe nëse ka, mendoj se duhet dënuar njëherë e përgjithmonë dhe redaktorët të sanksionohen penalisht. Policia duhet të bëjë punën e saj dhe nëse janë të ngarkuar, gjithmonë ka prioritete, vrasje, siguri në komunikacion dhe shpesh këto gjëra neglizhohen.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu? Kemi edhe lëvizjen tuaj, e cila është e re dhe për të cilën ju thoni se për ju këto janë çështje të nënkuptuara që nuk duhen theksuar. Nga ana tjetër, subjektet më të mëdha se ju dhe me përvojë dhe aktivitet politik dukshëm më të gjatë, nuk i komunikojnë këto çështje. Pse?**

**VLADIMIR LEPOSAVIQ:** Unë e klasifikoj veten në grupin e atyre që e konsiderojnë të vetëkuptueshme dhe ne veprojmë në përputhje me atë që besojmë, ndaj nuk flasim për të në veçanti. Ashtu siç ecën njerëzit në rrugë dhe nuk veshin këmbësorë "unë jam burrë" apo "jam serb/malazez", edhe pse ka raste të tilla, por kanë identitetin e vet bashkë me të gjithë të tjerët dhe e shprehin kur duhet. Për mua personalisht kjo është arsyeja, për të tjerët ndoshta ekziston edhe ajo patriarkale, pra stereotipike, e ashtuquajtura maço qasje ndaj politikës, jetës, ku konsiderohet e justifikuar të mos flitet për gratë dhe të drejtat e saj në veçanti, apo të mos trajtohet gruaja si e tillë.

Ndoshta ka arsye që në shoqëri, me gjithë vlerësimin dhe legjitimitetin e problemit, ka tema të tjera më të mëdha që janë pjesërisht artificiale, por kur krijohen struktura komplekse psikologjike, stresa dhe frustrime, edhe nëse shkaktohen nga diçka artificiale, ato duhet të të trajtohen. Të tilla si marrëdhëniet tona ndëretnike.

PDS-ja ka bllokuar këtë shoqëri, për shumë vite imponoi temën e shpëtimit të shtetit dhe pastaj të gjithë u morëm me shpëtimin e shtetit, dhe shteti është shëmbur në shumë nivele, sepse shoqëria po rrënohej nga dhuna dhe diskriminimi ndaj grave, minoriteteve, qoftë seksual apo kombëtar, ekonomi e keqe etj.

Ne si shoqëri, në përgjithësi, ende jemi duke u pjekur politikisht dhe për këtë po vuajnë gratë dhe të drejtat e grave. Dua të besoj se pjesa më e madhe e arsyes është se, megjithatë, nga të gjitha diskriminimet që ekzistojnë sistematikisht, diskriminimi ndaj grave është ndoshta, nëse jo më i vogli, atëherë më pak i rrezikshmi. Ose gratë, për shkak të prezencës dhe forcës së tyre numerike, si popullatë, janë ndoshta më të fortat nga të gjitha grupet e tjera të diskriminuara, prandaj janë edhe më efektive në luftimin dhe trajtimin e atyre rasteve individuale. Dua të besoj se është kështu, sepse do të doja që të paktën një nga problemet që po flasim, problemi i diskriminimit, të jetë afër zgjidhjes.

**QAQ: Lista juaj zgjedhore a e njej rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Nëse po, si manifestohet?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** PPS është prej kohësh parti që e njej këtë më së shumti në Mal të Zi dhe e cila në dokumentet e saj, në kongrese dhe në Statutin e saj ka dispozita për përfaqësimin e grave, kemi edhe Shoqatën e Grave. PPS është e vetmja parti në Mal të Zi, statuti i së cilës përcakton se të paktën çdo e treta grua mund të jetë deputete. Jo siç është në ligj - që gruaja duhet të zërë çdo të katërtin vend, sepse ne e kemi përmirësuar atë. Dhe në mbledhjen e tanishme të Kuvendit, nga pesë deputetë tanë, dy ishin e gjinisë më të bukur dhe këtë e afirmoi më së shumti PPS, si asnjë parti tjetër. Kemi edhe Shoqatën e Grave edhe Shoqatën e Rinisë dhe sigurisht çdo e treta grua në Shoqatën e Rinisë duhet të jetë në strukturë. Në Statutin tonë kemi edhe dispozitën që çdo i treti anëtar i gjeneratës së re, pra më i ri se 35 vjeç, duhet të jetë në listën e deputetëve. Kështu që PPS kujdeset për këtë dhe përgjithësisht çdo vend i tretë është i garantuar për gjininë më të bukur.

**QAQ: Si e vlerësoni përfaqësimin e ulët të grave në jetën politike dhe në pozitat vendimmarrëse?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Sinqerisht, mendoj se problemi më i madh është tek vetë anëtarët e gjinisë femërore, të cilat nuk janë aq aktive ose nuk kanë aq dëshirë të jenë pjesë e disa strukturave politike, partive apo elementëve të tjerë të pushtetit shtetëror. Është më shumë problem mungesa e grave që duan të përfshihen, sesa që disa parti detyrojnë anëtarët e gjinisë mashkullore. Gratë duhet të jenë më aktive. Në Mal të Zi ekziston një trashëgimi tradicionale. Vajzat dhe gratë rriten në mjedis të tillë dhe më pas nuk krijohet mendimi se janë ato që do të ishin të suksesshme dhe të afta, madje më mirë në kryerjen e funksioneve shtetërore apo pjesëmarrjen në Kuvend, madje pakrahasueshëm më të mira se burrat. Nëse do të më pyesnit mua, për shkak të maturisë dhe qëndrimit ndaj familjes, shtetit dhe përgjegjësisë, do të thosha se gratë duhet të jenë shumicë në të gjitha institucionet shtetërore. Kur merr përqindjen e grave që janë në pushtetin ekzekutiv dhe në Kuvend dhe kur shikon aferat që po ndodhin, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me krimin dhe korrupsionin, gratë janë absolutisht të përjashtuara. Dhe kjo është një arsye tjetër domethënëse që tregon se ne në PPS duhet të inkurajojmë gjithmonë anëtarët dhe simpatizantët tanë të rinj të partisë që të përfshihen më aktivisht dhe të jenë pjesë e asaj historie. Është mirë për ta, është mirë për partinë dhe është mirë për shtetin.

**QAQ: Hulumtimet tregojnë se gratë janë më të besueshme kur bëhet fjalë për fusha të tilla si arsimi, shëndetësia, edukimi, politikat sociale, ndërsa burrave u “rezervuohen” vendet në fusha si siguria kombëtare, mbrojtja, policia etj. Mendoni se duhet bërë diçka edhe në atë drejtim dhe të hapet hapësira për gratë profesionale dhe të kualifikuara për ato pozita për të tejkaluar stereotipe të tilla?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Sigurisht, kjo është diçka që është barazuar në Europë. Në demokracitë e zhvilluara dhe të qytetëruara, ka ardhur deri tek barazimi i plotë. Në tridhjetë vitet e fundit, ne kemi pasur dy lidere të jashtëzakonshëm, dy shtete të fuqishme, Margaret Thatcher, në Britaninë e Madhe dhe Angela Merkel, në Gjermani, e cila ishte kryesorja dhe në një moment e vetmja lidere e vërtetë që e shtyri të gjithë BE-në përpara.

Ka sërë shembujsh të tjerë, nga vende të tjera, dhe sinqerisht mendoj se grave duhet t’u jepet një shans më i madh dhe këtu shfrytëzoj rastin t’i ftoj që të përfshihen më aktivisht. E përsëris, për shkak të trashëgimisë sonë patriarkale, historike, kam ndjesinë se gratë nuk hyjnë në politikë me aq zell dhe dëshirë si burrat. Megjithatë, besoj se së shpejti do të ketë ndryshime dhe ndoshta me prezantimin e disa zgjidhjeve të reja ligjore, megjithëse ka edhe zgjidhje të mira aktuale. Prandaj, nëse një grua largohet nga Kuvendi, dhe ajo ishte p.sh. në vendin e shtatë, ajo nuk mund të zëvendësohet nga një burrë që është në vendin e tetë, por nga gruaja

e parë pasuese. Dhe nëse një burrë largohet nga Kuvendi dhe zëvendësohet nga një grua, pas kësaj ai nuk mund të zëvendësohet me një burrë, por me një grua. Pra, përgjegjësia tregohet diku këtu, por çelësi është që ta zbërthejmë në mendjen e një qytetari mesatar – se është punë dhe profesion apo angazhim i barabartë mes njëres dhe tjetres gjini. Kur ta kuptojmë këtë, atëherë nuk ka rëndësi kush është në listë, kush do të jetë kryetar i partisë, i shtetit, i Kuvendit, i Qeverisë etj.

Deri më tani, në historinë e Malit të Zi, nuk kemi pasur një grua presidente të shtetit, as nuk kemi pasur një grua presidente të Qeverisë. Kemi pasur një kryetare Kuvendi, saktësisht dy kryetare të Kuvendit, dhe njëra është nga PPS-ja. Ky është kontributi ynë për të kuptuar se si duhet të funksionojë pushteti shtetëror kur bëhet fjalë për barazinë gjinore.

**QAQ: Kur flasim për mungesën e entuziazmit dhe dëshirës që përmendët, si dhe për disa modele kulturore që i shihni si shkaktarë, a egziston ndonjë arsye tjetër për demotivimin e grave të flasin publikisht, të jenë në poste drejtuese? A inkurajohen mjaftueshëm nga liderët, partitë, shoqëria?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Kjo është një pyetje më shumë për zonjat, për pjesëtarët e gjinisë më të bukur, ato do përgjigjeshin më së miri. Që kur jam në krye të PPS-së, gjithmonë i kam inkurajuar pjesëtarët e gjinisë më të bukur që të përfshihen më aktivisht, të japin kontributin e tyre dhe besoj se një parti që do të kishte një grua si presidente, sigurisht që do të kishte një pjesë të madhe të votave të popullatës femërore. Megjithatë, diku me të vërtetë ndjej se ndoshta mungon mjaftueshëm dëshira apo guximi. Dhe kemi shembuj të grave jashtëzakonisht të guximshme. Këtë e di mirë që në kohën e protestave të PPS-së, rebelimin që bëmë kundër regjimit tashmë të dikurshëm në Mal të Zi. Dhe ku gratë u treguan më të forta dhe më besnike ndaj partisë. Por kur funksionet e caktuara duhen zënë, ata janë shumë të gatshme t'ia lënë dikujt tjetër. Më duket se disa gra, shumë të afta, të arsimuara, me talent të jashtëzakonshëm për të bërë një karrierë serioze politike, shpesh dinë të thonë: “Epo, kjo është për dikë tjetër, unë do të jem këtu, jam mirë këtu.” Jam i bindur se duhet të ketë barazi të plotë dhe se nuk duhet bërë asnjë dallim.

**QAQ: A egziston korrelacioni midis mungesës së dëshirës apo ambicjes së tyre, nga njëra anë, dhe faktit që në periudhën e fundit, në një masë të madhe, janë ekspozuara ndaj gjuhës së urrejtjes dhe mizogjinisë, veçanërisht kur flasin publikisht, dhe shpeshherë jemi dëshmitarë të fushatave negative dhe të pista nga media dhe aktorë të ndryshëm. A shihni një lidhje aty?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Politika është punë publike. Kushdo që ishte i përfshirë në politikë në Mal të Zi, të paktën bëri më të mirën që mundej, pa u ekspozuar publikisht ndaj boteve shpesh të paguar nga organizatat konkurrencte vetëm për të njollosur individë. Disa nuk mund ta kuptojnë se konkurrenca është diçka e shëndetshme, që dikush mund të jetë konkurrues pa pasur nevojë të shprehë dëshirat e tija më të ulëta përmes profileve të fshehura, fytyrave apo boteve, për të njollosur atë që bën dhe shpesh më me sukses, me nder dhe ndershmëri se ai që e shpif. Ai që shpif, në këtë mënyrë, tregon gjithë dobësinë dhe pisllekun e tij në shpirt, dhe nuk është aq i guximshëm, ndaj fshihet pas dikujt. Kudo në botë, ftesa publike e mbart këtë me vete. Ai që vendosi për një thirrje të tillë, duhet të kuptojë se është diçka e pranishme, sidomos në shoqëritë jo aq transparente që janë edhe tradicionale, siç është Mali i Zi, që nuk e ka kujtuar sa duhet demokracinë. Për sa kohë që ka ekzistuar Mali i Zi, ne kemi pasur vërtet katër sundimtarë. Është thjeshtë e pabesueshme se sa larg është Mali i Zi dhe se si njerëzit që fitojnë pushtetin mund të qëndrojnë në ato pozita. Në Mal të Zi ka opsion të madhe me politikë, ngjarje politike, përçarje dhe u bëj thirrje të gjithëve që të ushqejmë kulturën e dialogut, të cilën e kemi dhe e ruajmë në PPS dhe se fjalët e ashpra dhe fjalët e papërshtatshme flasin më shumë për atë që i foli sesa për ai për të cilin flitet.

**QAQ: Është e pamohueshme që zyrtarët publikë janë më të ekspozuar ndaj komenteve, por edhe se duhen të tregojnë një shkallë më të madhe tolerance ndaj kritikave publike. Megjithatë, gratë duket se janë më shumë të ekspozuara këtu përmes ofendimeve dhe sulmeve në bazë personale. Konkretisht, edhe deputetja e partisë suaj, si dhe disa kolege të saj nga partitë e tjera, thuhet se ishin në shënjestër të sulmeve të tilla mediatike, ndaj në mbrojtje të tyre dolën përfaqësueset e partive të tjera dhe koleget nga Kuvendi. A mendoni se ka solidaritet edhe te burrat për këtë çështje?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Sinqerisht mendoj se ka, por edhe kur sulmohet një pjesëtare e gjinisë më të bukur, besoj që nuk është në bazë personale, por se është sulm ndaj konkurrencës politike. Në mungesën e ideve politike dhe ofertave politike, ata vendosën të diskreditojnë kundërshtarin politik. Kur nuk e bëjnë dot me nder, kur nuk e bëjnë dot në bazë të argumenteve apo fakteve, atëherë sulmi në çfarëdo mënyre shihet si poen politik. Mirëpo, më duket se ata që e bënë më së shumti po largohen dhe dalëngadalë po humbin vlerën në skenën politike të Malit të Zi, pra po e humbin mbështetjen. Nëse dikush mendon se gratë në Mal të Zi nuk duhet t'i kenë të gjitha të drejtat, nëse dikush mendon se të drejtat politike u rezervohen vetëm burrave, atëherë gabon... Ne në PPS, veçanërisht në Kuvend, por edhe jashtë Kuvendit, kemi pasur gjithmonë ndjeshmëri ndaj pjesëtareve të gjinisë më të bukur, kështu që nëse ata i thoshin diçka njëri-tjetrit, ne kishim një linjë nën të cilën nuk donim dhe as nuk do ta kalojmë.

**QAQ: Si është ambijenti për pjesëmarrjen politike të grave brenda partisë suaj dhe a u jepet grave hapësirë të mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e tyre? A u jepet hapësirë e mjaftueshme mediatike?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Sigurisht, këtu gratë shfaqin talent të jashtëzakonshëm dhe disi, kur një zonjë elokuede dhe e bukur komunikon diçka, duket më mbresëlënëse dhe më e bukur me atë diksion, ngjyrë të zërit, bukurinë që ka, mbetet më fortë në kujtesën e atij që e dëgjon sesa kur flasin burrat.

Dhe jo vetëm kaq, do të biem dakord gjithashtu që gratë kanë performanca më të mira, sikur të çliroheshin dhe të merrnin përgjegjësi. Këtu, për herë të parë në Mal të Zi kemi një zonjë për kryetare të Kryeqytetit.

Kur bëhet fjalë për këto ndryshime dhe maturimin tonë demokratik, duhet ende shumë kohë, por duhet nisur nga kjo dhe që prindërit në shtëpi të kenë trajtim të barabartë për fëmijët e tyre. Të gjithë e dimë se në Mal të Zi nuk u lihej trashëgimia vajzave, por, si rregull, djemtë ndanin pronën e babait, ndërsa vajzat nuk merrnin asgjë dhe nëse merrnin, merrnin pak. Sikur të detyrohej dhe të vihej në dukje barazia nga familja, nga qeliza bazë e shoqërisë dhe nëpër kopshte e shkolla, ajo valë do të arrinte shpejt majat dhe më pas nuk mund të ndalohej. Kur bëhet fjalë për gjininë më të bukur, mendoj se pushtimi i lirive të plota është i pandalshëm në Mal të Zi.

Kemi edhe një dimension tjetër, jo vetëm politik, duke qenë se disa hulumtime tregojnë se gratë paguhën më pak se burrat për të njëjtën punë në Mal të Zi. Të gjithë duhet të luftojmë për këtë liri të plotë, si dhe për trajtim të barabartë gjatë punësimit. Një person nuk mund të jetë plotësisht i lirë nëse nuk ka liri ekonomike. Dhe këtu duhet të ketë një preferencë të caktuar, për shembull, nëse anëtarët/et e të dy gjinive kanë të njëjtin numër pikësh në një konkurs, të ketë gjithmonë një avantazh të punësimit të anëtareve të gjinisë më të bukur. Patjetër, disa kompani mendojnë në mënyrë të pandërgjegjshme dhe vetëm për zgjidhjen e meshkujve, ndërsa unë jam i bindur se gratë mund ta kryejnë punën pakrahasueshëm më mirë dhe me më shumë përgjegjësi, dhe më kujdesshëm se meshkujt.

**QAQ: A bie ndesh gjithçka që sapo thatë me disa vlera tradicionale që ju mbroni në parti, a janë këto dy koncepte reciprokisht ekskluzive?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Është sikur të pyesësh qytetarët e Malit të Zi dhe ata që trashëgojnë disa vlera tradicionale, nëse i trashëgojnë vlerat e Malit të Zi kur bëhet fjalë për nderin dhe ndershmërinë, përgjegjësinë për fjalën e thënë, përmbushjen e premtimeve të bëra... Nuk mund të marrësh atë që i përshtatet dikujt dhe të mos e respektosh atë që nuk i përshtatet. Këtu mendoj se kyt mendim duhet ta eliminojmë, në Mal të Zi ishte shumë e theksuar në periudhën e kaluar dhe, për kënaqësinë time, gjeneratat e reja po ndërgjegjësohen dhe mendoj se e kanë tejkualuar.

Si baba i dy vajzave dhe një djali, jam gjithmonë në krah të vajzave të mia dhe i inkurajoj shumë që të ecin përpara, të mësojnë mirë, të marrin pozicion të përshtatshëm në shoqëri dhe në familje nesër dhe të jenë të barabartë me burrat.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Është një fakt zgjënjes nëse vetëm 2% e hapësirës i dedikohet grave dhe është diçka që duhet theksuar. Mali i Zi duhet ta marrë shumë seriozisht, sepse është e papranueshme për të gjithë ata që janë pjesëmarrës në të gjithë procesin. Unë besoj dhe jam i bindur se Mali i Zi ka forcën për ta tejkualuar atë. Por, kur i thua njerit që është i besimit të caktuar tradicional se gratë nuk duhet të jenë të barabarta, ndoshta dikush edhe do të pajtohej. Por nëse do t'i thoshin këtë për nënën, motrën, vajzën, domethënë se nuk duhet të jenë të barabartë, mendoj se do të kenë reagim të ashpër. Ndoshta kjo gjë në mënyrë të pavetëdijshme hjek zanafillën nga e kaluara jonë tradicionale, të cilën ne duhet ta thyejmë.

Megjithatë, gjithashtu është fakt që kemi bërë përparim të jashtëzakonshëm në krahasim me atë që ishte.

**QAQ: Kur flasim për atë progres, për herë të parë ndodhi që në Mal të Zi, ka më pak burra se gra në një listë. Bëhet fjalë për listën me 60% gra dhe 40% burra, kështu që KSHZ-ja ua ktheu listën për rishikim sepse nuk kishte mjaftueshëm persona të gjinisë më pak të përfaqësuar, meshkuj në këtë rast. Si e shihni atë?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Le të ndodhë edhe kjo në Mal të Zi. Është mirë dhe kështu duhet të jetë barazia gjinore edhe le të jetë më e përhapur. Të gjithë të marrin pjesë dhe të japin kontributin e tyre për demokratizimin dhe barazinë e të dy gjinive. Barazia gjinore është diçka që Mali i Zi, të gjitha institucionet dhe çdo individ, veçanërisht individët që janë në poste të rëndësishme shtetërore, duhet ta afirmojnë dhe për të cilën duhet të japin kontributin e tyre të plotë.

**QAQ: A janë këto çështje (çështje të përgjithshme të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave, por edhe të drejtat e tyre kulturore, sociale, seksuale dhe riprodhuese, fuqizimi ekonomik, lufta kundër dhunës ndaj grave, etj.) tani/apo kanë qenë ndonjëherë axhenda zyrtare e partisë suaj politike? Dhe a ka bërë ndonjëherë partia, veçanërisht për këto zgjedhje parlamentare, një fushatë për këtë çështje, a ka pasur përpjekje brenda partisë ta avokoj më fortë publikisht këtë çështje?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Këto çështje janë në axhendë dhe shpesh përmendim barazinë gjinore. Natyrisht, ne në PPS, në Shoqatën e Rinisë dhe Shoqatën e Grave e respektojmë këtë çështje dhe krenohemi me faktin që kemi një situatë të përmirësuar në krahasim me atë që është legjislacioni shtetëror. Situata është e përmirësuar kur bëhet fjalë për barazinë gjinore dhe shumë mirë e ushqejmë atë. Dhe në të ardhmen, PPS-ja do të kontribuojë në këtë çështje, ashtu siç ka dhënë kontribut të pamatshëm në skenën e përgjithshme politike. Nuk ka asnjë parti politike në Mal të Zi që ka nxjerrë më shumë liderë dhe parti që kanë dalë nga PPS-ja.

**QAQ: Si është forca e Shoqatës tuaj të Grave dhe deri ku dëgjohet zëri i tyre?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Në përgjithësi, mendoj se kur bëhet fjalë për përpikmërinë, përgjegjësinë dhe përkushtimin në punë, gratë janë më të mira se burrat dhe kjo nuk mund të krahasohet. Dhe këtë e ka treguar fakti në kompaninë ku punoj prej 25 vitesh – kur gruas i beson diçka, bëhet më me përpikëri dhe më mirë se kur e bëjnë burrat. Për këtë arsye, mund të jetë një ide e mirë të propozohet që kryesuesit e të gjitha grupeve parlamentare të jenë gra. Besoj se kjo do të çonte në më pak antagonizëm, edhe pse gratë ndonjëherë dinë të jenë anëtare të pasionuara të një opsioni politik, por ato janë më të kuptueshme në atë komunikim, punojnë më shumë në kulturën e dialogut sesa burrat.

Është një iniciativë që më pëlqeu shumë. Në këtë tranzicion të pushtetit dhe rënien e Qeverisë së 42-të të Zdravko Krivokapiqit dhe votimit të mosbesimit ndaj kësaj qeverie të 43-të, lindi ideja për formimin e një qeverie tërësisht femërore, në mënyrë që të gjitha ministret të jenë pjesëtarët e gjinisë më të bukur. Dhe ky do të ishte një hap i madh përpara. Fatkeqësisht nuk ndodhi, ndoshta do të ndodhë në të ardhmen. Unë do ta votoja, por nga ana tjetër mund të nënkuptojë se ne detyrojmë diçka që nuk është produkt i harmonisë së plotë në shoqëri, barazi, demokraci.

Megjithatë, ndoshta përgjegjësia e gruas ndaj familjes justifikon pjesëmarrjen e tyre më të dobët në politikë. Siç thotë proverbi ynë i vjetër – “Nuk qëndron shtëpia në tokë, por në gruan”. Pra, ndoshta burrat kontribuojnë më shumë për familjen në njëfarë kuptimi material, por kur bëhet fjalë për rritjen e fëmijëve, vëmendjen, drejtimin e fëmijëve drejt së ardhmes, ka, me gjithë respektin për baballarët dhe vetë si baba, nëna të patejkalueshme që vullentarisht pranojnë, përmes traditës sonë, të sakrifikojnë shumë herë karrierën e tyre për të rritur pasardhësit e tyre.

**QAQ: A mendoni se një përqindje më e lartë e grave në poste drejtuese do të “shqetësonte” vetë burrat dhe cili është roli i burrave në fuqizimin politik të grave?**

**VLADIMIR JOKOVIQ:** Nuk do të më interesonte nëse do ta kishin problem. Sepse nëse burrave gjatë historisë së Malit të Zi nuk i'u pengonte që të ishin gjithmonë ata që vendosnin, pse do t'i shqetësonin ata tani nëse situata është e kundërt. Nga eksperiencia ime, atje ku ishin gratë, ato gjithmonë jepnin maksimumin e vet. E përmenda çështjen e korrupsionit, krimin dhe të ngjashme – gratë nuk kanë kontribuar në ato sfera këtu. Ata janë më të përkushtuar ndaj gjërave të tjera, vlerave dhe nuk do të kisha absolutisht asgjë kundër kësaj, përkundrazi – do të doja që të zinin sa më shumë vende në Kuvend, në pushtetin ekzekutiv dhe në të gjitha institucionet shtetërore, diplomaci, etj. Jam bindur se, aty ku u jepet një rol i rëndësishëm grave, ato e bëjnë më me përkushtim pakrahasueshëm më të madh se burrat.

DEJAN VUKSHIQ, bartës i listës „KOALICIONI POPULLOR – „BASHKË DHE PIKË“ (Dejan Vukshiq – Levizja Demokratike e Krishterë; Marko Millaçiq – Mali i Zi i Vërtetë; Vlladislav Dajkoviç – Mali i Zi i Lirë; Dragica Peroviç – Partia Demokratike Serbe; dr Novica Staniç – Levizja për Plevlën)

**QAQ: A e nje partia juaj politike dhe koalicioni me të cilin keni hyrë në këtë proces zgjedhor rëndësinë e çështjes së barazisë gjinore, pjesëmarrjen politike dhe fuqizimin e grave? Dhe nëse po, si manifestohet në parti/koalicion?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Si politikan jam relativisht i ri në skenën politike dhe sigurisht që nuk mund t'i dalloja disa gjëra deri më tani. Sigurisht që eksperiencia ime nuk është e tillë që të mund të flas më shumë për atë temë sesa ndonjë politikan që merret prej kohësh me të.



Disa gjëra i kam vënë re vërtet, dhe për çfarë do të flasim sot, disa gjëra do t'ju pëlqejnë, disa jo. Unë jam i sigurt se 90% e politikanëve do të thonë diçka që nuk e mendojnë, sepse nuk duan të etiketohen, kjo do të ishte keq për fushatat e tyre, për partitë e tyre. Ndryshe nga ata, unë do të jem plotësisht i hapur për atë që mendoj, pavarësisht se si kjo gjë mund të ndikojë.

Ajo që kam vënë re deri tani, kur bëhet fjalë për partinë politike të cilës i përkas, lëvizjen dhe koalicionin tonë Demokristian, është se gratë bëjnë pjesën më të madhe të punës. Më vjen keq që nuk ka më shumë gra, dhe nuk do të doja ta ulë rëndësinë e burrave, sepse nuk do të doja të nisesha nga fakti se disa punë bëhen më mirë nga burrat sesa gratë. Megjithatë, kam vënë re se gratë i bëjnë më mirë punët organizative, janë më të fokusuar dhe thjesht janë më të përkushtuara ndaj kësaj pune.

Më vjen keq që nuk ka më shumë gra, jo në listën për të plotësuar formularin, por në thelb që nuk ka më shumë gra që besojnë vërtet në atë që bëjnë. Ne kemi një numër të caktuar të grave në partinë tonë politike. Për shembull, njëra prej tyre që është edhe në listë, që të mos ofendohen burrat e tjerë, bën më shumë se 50% të punës, ajo është alfa dhe omega e gjithë punës sonë. Është për të ardhur keq që më shumë gra nuk përfshihen në jetën politike, por jo për t'u përfshirë formalisht, por për t'u përkushtuar, për të besuar në të. Mendimi im është se kur krahasojmë progresivitetin, intensitetin e punës së grave dhe burrave në lëvizjen tonë, sigurisht që ka një çekuilibër në favor të grave që investojnë shumë më tepër energji.

**QAQ: A ishte e lehtë të bieni dakord brenda partisë, por edhe vetë koalicionit, për numrin e grave, për emrat e kandidateve individualisht, etj.?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Fakti është se ne kemi nevojë për më shumë gra, jo vetëm në kuptimin formal-juridik që duhet përmbushur, por edhe në thelb. Pra, problemi kryesor për ne nuk është a kemi mjaft gra, por a kemi gra cilësore, gra në kuptimin e plotë të fjalës, ato që mund të kontribuojnë dhe jo thjesht të jenë shtesa në listë, por të përfshihen në kuptimin e vërtetë të fjalës. Nuk patëm asnjë keqkuptim, por ishte një sfidë – nuk kishim mjaft gra që ishin të interesuara të përfshiheshin.

**QAQ: Çka mendoni se është arsyeja e angazhimit të pamjaftueshëm të grave në politikë?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Ja një histori ilustruese dhe ka të bëjë me traditën e popullit malazez... Ishte një emision para disa vitesh, bëhej fjalë për intervistë me një nga malazezet më të vjetra dhe ajo foli për jetën e saj. Bëhet fjalë për grua që ka mbi 100 vjeç. Së fundi, gazetari e pyeti se si e parashikon të ardhmen, për të cilën ajo qesh dhe thotë “fatkeqësi!”. Ai e pyeti: “Pse?”. Për këtë ajo thotë: “Kam dëgjuar që gratë kanë filluar të gjykojnë në Mal të Zi”. Pra, kështu ka thënë një grua mbi 100 vjeç, e cila flet për atë traditë, e vëzhgon popullsinë femërore në atë mënyrë. Nuk e keni dëgjuar këte nga malaziu më i vjetër, që ta kualifikohesh në këtë mënyrë apo tjetër, por këtë e tha nje grua, dhe këto janë recidivet e të shkuara që me siguri ndikojnë në arsim dhe çdo gjë tjetër.

Për mendimin tim, shkak kryesor është tradita ku një grua ka një ndjenjë më pak vlerë, duke filluar nga mentaliteti i saj e kështu me radhë. Ky është një problem, zgjidhja e të cilit kërkon kohë për të arritur nivelin e zhvillimit si në vendet moderne.

**QAQ: A i dekurajon apo demotivon kjo gratë dhe a ka një lloj frike për të zënë pozicione dhe për t'u bërë më aktive?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Sigurisht që është kështu. E kam parë këtë tek disa gra që nxjerrin në pah disa gjëra me kapacitetet e tyre, psiko-fizike. Si bartës i listës, në komunikimin e drejtpërdrejtë, ndonjëherë turpërohem kur

shoh mënyrën se si disa gra shprehin përfundimet e tyre dhe mënyrën e tyre të komunikimit me mua. Le të themi, unë them - dil dhe thuaj këtë e atë, dhe ajo thotë "jo, jo, më mirë bëje ti". Këtu vë re njëfarë frike se si do të reagojë publiku malazez dhe mendoj se duhet kohë që kjo të ndryshojë.

**QAQ: A shihni lidhje midis kësaj dhe faktit që gratë janë vazhdimisht të ekspozuara ndaj gjuhës së urrejtjes dhe fushatave negative dhe komenteve fyese, mizogjene në hapësirën publike?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Tani do t'ju them një gjë që do t'ju pëlqejë më pak, domethënë pyetja që është edhe për mua e paqartë. A duan gratë të jenë të barabarta në kuptimin e plotë të fjalës? Apo duan të jenë të barabartë deri në një pikë dhe në sfera të caktuara të jenë të privileguara? Për mendimin tim, kjo është pyetja e të gjitha pyetjeve, nëse gratë me të vërtetë, kur thonë *barazi*, nënkuptojnë barazi në kuptimin e plotë, pa asnjë privilegj apo barazi por me privilegje.

Gjuha e urrejtjes sigurisht që është e pranishme, por kur është e pranishme në mesin e grave, për të flitet me ditë të tëra dhe kur është e pranishme te burrat, atëherë nënkuptohet. Jam i sigurt, në përqindje, që gjuha e urrejtjes e drejtuar nga burrat për burra është shumë më e lartë se tek gratë, por për këtë të dytën shkruhet dhe merret parasysh më shumë, ashtu siç duhet, sepse bëhet fjalë për gra. Por pastaj vijmë te kjo pyetje - duam të jemi të barabartë në kuptimin e plotë të fjalës apo jo.

Po ju jap një shembull tjetër, nga bota e sportit. Ka pasur një pyetje në sport nëse gratë duhet të fitojnë njësoj si burrat - në mënyrë të barabartë, dhe gratë luajnë dy sete dhe burrat të luajnë tre. Gratë luajnë dy sete dhe kjo nuk diskutohet, sepse nuk durojnë dot më, por më pas lind pyetja nëse do të jemi të barabartë apo jo.

Nuk po kritikoj, por duhet ta demarkojmë atë pjesë. Nuk diskutohet, nëse kemi rënë dakord të jemi të barabartë, por që gratë të kenë privilegje, por ta dimë se janë me privilegje apo pa privilegje...

Po i kthehem pyetjes për fyerjet, sigurisht që prek më shumë gratë, por sigurisht më pak në përqindje krahasuar me burrat.

**QAQ: Hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare ka pasur një ndryshim të caktuar në pjesën e gjuhës së urrejtjes. Megjithatë, disa media vazhduan të zhvillojnë fushata të pista kundër disa grave nga parti të ndryshme, fytyra të njohura nga skena politike. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse? A nuk shohin burrat problem në këtë, a ka solidaritet mes burrave?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Ato komente nga ajo kuazi media janë katastrofike. Nuk më pëlqen as kur disa nga ato media më lavdërojnë, sepse nëse më lavdërojnë, atëherë është diçka negative për mua. Kur u zgjodha drejtor i Agjencisë së Sigurisë Kombëtare, për 64 ditë ato media shkruanin të gjitha të këqijat për mua. Unë jam në partinë time, nuk jam as përkrahës i partisë së cilës i përket Bozhena Jelushiq dhe për liderin e së cilës ai portal ka shkruar gjërat më të shëmtuara. Askush nuk e përmendi këtë, por u përmend Bozhena Jelushiq. Kjo që kanë shkruar është e neveritshme dhe e di çfarë komentesh janë dhe gratë ofendohen dhe preken më shumë. Kështu që unë jam pro barazisë me privilegje të caktuara për gratë, ato duhet të jenë privilegje, janë të natyrshme, janë të tilla dhe duhet të bëhen dhe pastaj gratë do të japin kontributin e tyre të plotë. Një grua nuk ka nevojë të thotë - nuk kam nevojë për privilegje, është thjesht biologjike, fizikisht është ashtu, një mashkull mund të ngrëjë 200 kg dhe ajo jo. Unë jam për barazi me privilegje të caktuara për gratë dhe që gratë të mos zemërohen që them kështu.

**QAQ: A ishin këto çështje (çështje të përgjithshme të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave, por edhe të drejtat e tyre kulturore, sociale, seksuale dhe riprodhuese, fuqizimi ekonomik, lufta kundër dhunës ndaj grave, etj.) pjesë e fushatës së koalicionit tuaj?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Nuk kishte theks në ato çështje. Unë me të vërtetë mendoj se duhet të ketë theks, por në mënyrën e duhur. Mendoj që të mos shkojmë në ekstrem kur bëhet fjalë për gratë, edhe pse askush nuk do ta thotë këtë publikisht për arsye politike, por thjesht, nuk ka nevojë të shkohet në atë drejtim. Barazia e grave duhet të ekzistojë, sepse gratë, çdo punë e bëjnë shumë më tepër entuziazëm se ne burrat. Sigurisht që duhet kushtuar më shumë vëmendje kur bëhet fjalë për fushatën, por jam i mendimit se duhet t'i motivojmë këto gra, nuk mjafton të shkojmë në fushatë dhe pastaj të marrim disa pikë politike, por me një qëndrim konkret ndaj grave që të motivohen, të shkëputen dhe të japin kontributin e tyre të plotë. Po e përsëris, por do të isha i lumtur nëse do të kishim më shumë gra në politikë. Edhe tani në këtë fushatë, çfarëdo që të organizojmë, gratë kryesisht e bëjnë këtë, po të na binte neve burrave, asgjë nuk do të ishte e kryer, asgjë nga fushata nuk do të ishte pa prezencën e grave.

**QAQ: A keni ndërmarrë ndonjë aktivitet në kuadër të kolacionit për të motivuar gratë, a kishte gra që nuk ishin të sigurta të dilnin publikisht, të ishte në listë, etj.?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Po, ka pasur raste të tilla, sidomos kur bëhet fjalë për shfaqjen publike. Ne, për shembull, me të vërtetë shtyjmë që gratë të flasin më shumë publikisht. Për të mos përmendur emra, por ka gra që dalin në publik dhe dëgjoj se nuk janë të kënaqura, por në fakt ishin të mrekullueshme. Kjo pasiguri është tepër e dukshme, dhe është pasojë e gjithçkaje që përmendëm më parë. A punojmë personalisht? Unë personalisht punoj dhe përpiqem t'i bëj sa më të dukshme dhe kjo i jep fushatës dimension krejtësisht tjetër.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Politikanët përgjithësisht mendojnë se nuk është diçka që sjell pikë politike, nuk u intereson, thjesht u intereson ajo që thonë, duke përmirësuar rejtingun e tyre. Këta janë politikanë profesionistë, politika është gjithçka për ta, dhe unë jam i ri në politikë dhe nuk jam fare i ngarkuar. Është e imja të them se çfarë mendoj dhe si do ta pranojnë qytetarët, ndoshta do të gëzohen apo do t'u vijë keq, por kështu është...

**QAQ: Hulumtimet tregojnë se gratë janë më të besueshme kur bëhet fjalë për fusha të tilla si arsimi, shëndetësia, edukimi, politikat sociale, ndërsa burrave u rezervohen vendet në fusha si siguria kombëtare, mbrojtja, policia etj. Mendoni se duhet bërë diçka edhe në atë drejtim dhe të hapet hapësira për gratë profesionale dhe të kualifikuara për ato pozita për të tejkaluar stereotipe të tilla?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Për të mos fajësuar gratë, por është e rëndësishme në jetë të dini se çfarë doni dhe të investoni të gjithë energjinë tuaj në atë drejtim, për të afirmuar veten. Ju përmendët sektorin e sigurisë, përveç kualifikimeve të nevojshme për të punuar me sukses në sektorin e sigurisë, për mendimin tim, duhet të plotësohen tre kushte: 1) të jeni ekspert dhe profesionist, 2) të ndershëm dhe 3) të jeni të guximshëm.

Ky guxim nënkupton që ju duhet të imponoheni. Unë nuk mendoj se gratë e imponojnë veten në mënyrë të duhur për t'u njohur. Tani kemi listën e re ku gratë janë imponuar dhe kanë tërhequr vëmendjen te vetja. Nëse prisni që dikush tjetër të ju shtyjë, atëherë kjo tregon mungesën e guximit të atyre grave për të punuar nesër në sektorin e sigurisë, mua më ka intriguar konkretisht ajo listë. Cilat janë gratë që dolën me guxim? Le të themi, kur ishim me Presidentin e sapozgjedhur për intervistë, mënyra se si foli ajo grua më tërhoqi vëmendjen dhe

mendoj se ky është hapi i parë - nuk mund të bëhet me forcë, nuk është e lehtë, asgjë nuk mundet një njeri bëj vetëm dhe gjithmonë ka nevojë për mbështetje, por kjo varet nga gratë.

**QAQ: Atëherë çfarë duhet të bëjmë tjetër dhe cilët janë sipas jush mekanizmat më të mirë për përfshirjen e grave në jetën politike?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Mendoj se të gjithë duhet të bëjnë pikërisht atë që bëni ju - në aspektin arsimor, të ketë OJQ, institucione, të synohen grupe të caktuara dhe institucione të caktuara ku kemi gra, potenciali i të cilave nuk është përdorur në kuptimin e plotë.

Duhet ta detyrojmë këtë bisedë, të organizohen sa më shpesh tubime, ku, para së gjithash, gratë do të mund të shprehin sinqerisht se cilat janë pengesat e tyre psikologjike, të përpiqen të afirmohen në botën e politikës. Duhet të bëhet prioritet privilegjia. Kur futesh në politikë egziston axhenda e veprimit politik, ku merren parasysht vetëm përqindjet dhe më pas këto gjëra harrohen fare.

Nuk jam i sigurt se partitë, edhe kur kanë forumet e tyre të grave, punojnë me të vërtetë në atë drejtim, ndaj mendoj se kjo që bëni ju duhet të bëhet dhe unë fillova të mendoj për këtë gjatë bisedës.

**QAQ: Në fund, si i shihni kuotat - si një mekanizëm kalimtar apo si një zgjidhje thelbësore që do të çonte në pjesëmarrje më të madhe politike të grave?**

**DEJAN VUKSHIQ:** Si legalist, më duket e pakuptimtë. Ajo që do t'ju them nuk është e njohur - ju tani keni situatë ku i impononi diçka psikologjikisht dikujt përmes një kombinimi rrethanash. Mund të ndodhë që në një parti të caktuar politike të ketë një grup rrethanash që të kesh një numër të caktuar grash ose burrash, cilësia e të cilëve meriton të jetë në ato 5,6,7 vendet e para në listë dhe tani duhet të eliminosh dikë që nuk e meriton. Ju pastaj arrini artificialisht në proporcionin që është imponuar. Të njëjtën gjë thonë edhe për gjyqtarët, le të themi, se mes 7 gjyqtarëve duhet të ketë një përfaqësues, dy përfaqësues të pakicave kombëtare, dhe nëse janë 10 kandidatë, kemi 8 nga kandidatët më të mirë dhe 2 që janë pakicë kombëtare që nuk dinë asgjë për këtë, unë duhet të eliminohem sepse dikush është nga një pakicë kombëtare. Mendoj se është e gabuar, jam mbështetës i tezës se është më mirë të dështojë çështja sesa sistemi.

Nuk më pëlqen kjo qasje dhe nuk mendoj se do të arrihet diçka në këtë mënyrë, që të kesh (30%) gra me dhunë. Nuk i kam në qef këto pro forma, por në thelb asgjë nuk do të ndodhë. Në thelb, duhet të punojmë, tubime, seminare, para së gjithash, për t'i motivuar gratë të jenë më aktive dhe të tërheqin vëmendjen te vetja dhe askush nuk do t'ju dëgjojë derisa të tërhiqni vëmendjen tek vetja.

## GENCI NIMANBEGU, bartës i listës Aleanca Shqiptare

**QAQ: A e njeherë partia juaj politike rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike dhe fuqizimit të grave? Nëse po, si manifestohet në parti/koalicion?**

**GENCI NIMANBEGU:** Personalisht jam i kënaqur me mënyrën se si kemi arritur të animojmë dhe përfshijmë gratë në procesin zgjedhor. Nuk kam parasysht vetëm pjesëmarrjen në lista, por edhe afirmimin e kapacitetit të tyre në raport me nevojat e shoqërisë, jo vetëm për barazinë gjinore, por edhe për zhvillimin, ruajtjen e familjes, jetës kulturore etj. Për fat të keq, politika ose të paktën maja e politikës, në një farë mënyre, i është lënë ende gjinisë mashkullore. Në lidhje me këtë, ne gjithmonë kemi ndërmarrë hapa që do të çonin në pjesëmarrje më të

madhe të grave në jetën politike. Lista jonë e kalon minimumin ligjor, por si listë minoritare aspirojmë një mandat dhe si kryetar i partisë jam edhe bartës i listës.

Kemi Forumin e Grave të formuar brenda partisë, që ka 12 vite që është shumë aktiv dhe që ka kontribuar në rritjen e partisë sonë në periudhën e kaluar. Gjithashtu, para dy vitesh kemi pasur Kongresin, përmes të cilit kemi rritur ndjeshëm numrin e grave në Bordin Kryesor. Kryesia jonë, për fat të keq, ka vetëm një përfaqësuese të Forumit të Grave, por këto janë gjëra të trashëguara dhe shpresoj se kjo fushatë zgjedhore do të ndihmojë në forcimin dhe përmirësimin e rolit të grave.

**QAQ: Si e vlerësoni përfaqësimin e ulët të grave në jetën politike të Malit të Zi dhe në përgjithësi në pozita udhëheqëse, në pozita vendimmarrëse?**

**GENCI NIMANBEGU:** Nuk do të jap një vlerësim, thashë që nuk jam i kënaqur me atë që është bërë deri më tani. Por, mund të mburrem me disa nga vendimet tona. Për shembull, partia jonë menaxhon dy kompani në Ulqin dhe një nga drejtorët është e gjinisë femërore. Pra, nëse do ta shikonit, jo vetëm në përqindje, i dhamë shans dhe besim jo vetëm atij personi, por edhe të menaxhoj një kompani të rëndësishme. Për më tepër, sa i përket disa sekretariateve apo pozitave drejtuese, në krahasim me periudhën e mëparshme kur nuk kishim asnjë, tani kemi dy sekretare të sekretariateve, që është hap i rëndësishëm përpara dhe jemi shumë të kënaqur me punën e tyre.

Shpresoj se do të motivojë edhe njerëzit e tjerë që të pranojnë poste drejtuese. Deri tani nuk ka qenë se nuk kemi dashur t'i përfshijmë, por ka pasur një shmangie edhe te vetë gratë apo anëtarët e partisë dhe mund t'ju them se ka edhe vetëdije të pamjaftueshme që gratë duhet të përfshihen në jetën politike, jo vetëm përmes Forumit të Grave, por edhe përmes procesit të vendimmarrjes në poste të larta.

**QAQ: Cila është arsyeja e kësaj shmangie tek gratë, dekurajimi dhe demotivimi i tyre për të hyrë në jetën publike politike dhe për të luftuar për të drejtat e tyre, por edhe për të drejtat e grupeve të tjera dhe progresin e përgjithshëm të shoqërisë?**

**GENCI NIMANBEGU:** Arsyet sigurisht janë të shumta. Mendoj se ato bazike vijnë nga një traditë apo mënyrë e të menduarit, por mund t'ju them se gratë janë më të përgjegjshme. Jeta jonë politike është demokraci e papjekur, ndaj, ndër të tjera, është e projektuar në atë mënyrë që angazhimi në politikë të merret si punë gjysmë e nderuar ose e çnderuar. Përveç kësaj, proceset që ndodhën në Mal të Zi, ku kishte shumë klientelizëm dhe ndikim partiak në të gjitha institucionet, ndoshta kanë ndikuar shtesë që ato të demotivohen. Natyrisht, gjëja kryesore është ndërgjegjësimi i pazhvilluar i shoqërisë se me pjesëmarrjen e grave në jetën politike, ne sigurojmë zbatimin jo vetëm të parimeve tona programore, të cilat i kemi të gjithë në statute, programe, në Kushtetutë, në ligje, por që shoqërinë do ta bëjmë më të mirë dhe më demokratike. Mendoj gjithashtu se proceset politike në Mal të Zi do të ishin shumë më të lehta dhe më të shpejta nëse kjo vetëdije do të ishte më e zhvilluar.

**QAQ: A janë këto çështje (çështje të përgjithshme të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave, por edhe të drejtat e tyre kulturore, sociale, seksuale dhe riprodhuese, fuqizimi ekonomik, lufta kundër dhunës ndaj grave, etj.) tani/apo kanë qenë ndonjëherë axhenda zyrtare e partisë suaj politike? Dhe a ka bërë ndonjëherë partia, veçanërisht për këto zgjedhje parlamentare, një fushatë për këtë çështje, a ka pasur përpjekje brenda partisë ta avokoj më fortë publikisht këtë çështje?**

**GENCI NIMANBEGU:** Shumë e dobët, sidomos kur bëhet fjalë për të drejtat e grave. Partia jonë është parti kombëtare dhe programi ynë fokusohet në të drejtat e komunitetit tonë minoritare. Vlerësojmë se ka shumë

elementë ku jemi të diskriminuar në Mal të Zi dhe fokusohemi më shumë në atë pjesë në fushatë. Natyrisht, e kaluara politike tregon se ne kemi mbështetur propozime ligjore që çuan në barazi, por sinqerisht duhet të them që fushata, jo vetëm e partisë sonë, por edhe e gjitha partive tjera, nuk është e fokusuar në këtë. E shihni që ajo është e fokusuar në tema ekonomike, në paga, pensione, banesa falas, përfitime më të gjera ekonomike apo progres. Sa i përket të drejtave të njeriut, partitë pakicë sigurisht që flasin për ato çështje, por, të them të drejtën, nuk e di as se si do t'i merrte publiku ato mesazhe nga një parti që do të fliste vetëm për ato tema. Nga ana tjetër, kemi listën të përbërë kryesisht nga gratë dhe rezultatet e tyre do t'i shohim në zgjedhje.

**QAQ: A është partia juaj e vetëdijshme për pengesat me të cilat përballen gratë që janë ose dëshirojnë të jenë pjesë e jetës publike dhe të zënë pozita të caktuara në politikë dhe shoqëri?**

**GENCI NIMANBEGU:** Janë, por nuk janë mjaftueshëm të inkurajuar apo të fokusuar për të ndërmarrë hapa konkretë. Unë personalisht angazhohem dhe e kam dëshmuar si kryetar partie duke ndryshuar ndërgjegjësimin tonë për gratë në poste drejtuese. Në mandatet e kaluara ishin më pak dhe tani seriozisht ecim drejt një pune të madhe. Nuk bëhet fjalë vetëm për vullnetin, por edhe për motivimin apo inkurajimin e pamjaftueshëm të grave për të shprehur qartë ambiciet e tyre në këtë drejtim. Do të inkurajoj çdo politikë, jo vetëm të anëtareve të Bordit Kryesor, por edhe të anëtareve të partive tjera, për të promovuar këtë qasje. Problem i madh është pjesëmarrja e pamjaftueshme e grave në bordet drejtuese të kompanive. Dhe kjo nuk ndodh vetëm në partinë tonë, por edhe në parti të tjera dhe ky është një tregues real, pavarësisht dispozitave ligjore, statute, deklaratave, ndërgjegjësimi të pamjaftueshëm apo dëshirës së pamjaftueshme për të zbatuar atë që thuhet dhe shkruhet publikisht.

**QAQ: A ka pasur në periudhën e kaluar disa iniciativa, propozime nga vetë gratë për t'u dhënë atyre më shumë hapësirë brenda partisë, brenda fushatës, brenda mediave? A është ajo klimë përgjithësisht e favorshme për afirmimin dhe fuqizimin e tyre?**

**GENCI NIMANBEGU:** Ne kemi pasur grua kryetare të njërit prej tre bordeve komunale të atëhershme. Pra, ka iniciativa të tilla dhe me kalimin e kohës do të jenë pjesë përbërëse e programit dhe aktiviteteve tona. Përvoja ime politike tregon se ndonjëherë edhe përcaktimi i përqindjes së pjesëmarrjes është i domosdoshëm për disa shoqëri, me faktin se atëherë vjen deri në paradoks. Për shembull, vendet perëndimore thonë se kemi përqindjen e caktuar të pjesëmarrjes së grave në listat zgjedhore dhe kjo nuk pasqyrohet në shtëpitë ku ato përfaqësohen, qofshin ato kuvende komunale, kuvende shtetërore etj. dhe ata vetë kanë sistemin që nuk e inkurajon atë. Për shembull, sistemet zgjedhore në Britaninë e Madhe apo në SHBA nuk e kanë atë përqindje, por këto janë shoqëri të përparuara, apo vende skandinave që kanë përqindje shumë më të lartë jo vetëm të grave në parlament, por edhe janë presidente të shteteve, qeverive. Kjo dëshmon se me zhvillimin e shoqërisë vjen kjo barazi.

**QAQ: Jemi dëshmitarë se në numrin më të madh të rasteve, në të 15 listat zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, gratë janë të përfaqësuara pothuajse në masën minimale të kërkuar me ligj. Cila është arsyeja për këtë? Dhe lista juaj kishte rreth 31% gra, që do të thotë se ishte respektuar minimumi ligjor, por pse nuk kishte më shumë gra në të dhe a bëtë ndonjë gjë për t'i inkurajuar ato që të jenë më shumë në listën zgjedhore?**

**GENCI NIMANBEGU:** Ne jemi listë paksa specifike, pra një koalicion i përbërë nga katër subjekte. Kryetarët e të katër subjekteve janë burra, dhe kjo përcaktoi një pjesë të dinamikës së formimit të atyre listave, si dhe uli përqindjen e pjesëmarrjes së grave. Në këtë periudhë nuk jemi fokusuar tek rritja e numrit, thjesht kemi vlerësuar se përpilimi i çdo liste përfshin më shumë elementë për të tërhequr votuesit – qoftë me emra, qoftë nga rajonet nga të cilat ata përfaqësohen, qoftë sipas partisë. Këto janë vendime individuale të të gjitha partive. Kështu bëmë ne, por ndoshta janë anëtare të koalicionit tjetër në shkallë më të vogël, kështu që kjo ka ndikuar atë numër prej vetëm 31%.

**QAQ: Cilat do të ishin mekanizmat që ju si parti apo koalicion mund të përdorni për të rritur përfaqësimin e grave dhe për të forcuar lidhshimin femëror në politikë? Cila është pengesa më e madhe dhe si ta trajtojmë atë?**

**GENCI NIMANBEGU:** Është çështje shumë komplekse e cila lidhet me arsimin dhe institucionet tjera, universitetet, ekonominë etj. Ju kujtoj se pjesa më e madhe e pronave në Mal të Zi është në duart e burrave. Kjo tregon qartë se ka shumë gjëra për të cilat duhet të punohet dhe mendoj se programet ekonomike që ne ofrojmë do të mundësojnë fuqizimin e grave dhe në këtë mënyrë të forcojnë ato gra që kanë predispozita të jenë lidere. Kështu do të respektojmë cilësinë dhe meritokracinë dhe shpresoj se kjo të jetë një nga mënyrat se si do të rrisim pjesëmarrjen e grave. Sigurisht, aty është edhe Forumi i Grave, pastaj bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, sepse ne punojmë për të rritur ndërgjegjësimin. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me sektorin joqeveritar, dhe në sektorin joqeveritar ka kadër cilësor që janë gra, me faktin se në periudhën e kaluar kanë kaluar shumë njerëz nga sektori joqeveritar në politikë. Nuk e shoh si diçka pozitive sepse nga ana tjetër përveç kapacitetit të tyre, që dëshmohet në politikë, sektori joqeveritar është dobësuar.

**QAQ: Keni përmendur votuesit dhe ngritjen e ndërgjegjësimin të publikut për këto çështje. A ka mesazhe të ashtuquajturin seksizëm votues, pra vendosmëria e votuesve për të votuar për një burrë dhe jo për një grua, sepse ata i perceptojnë si më të aftë, më të guximshëm, më të vendosur etj. Nëse po, si ndryshohet kjo vetëdije?**

**GENCI NIMANBEGU:** Nuk kam asnjë mendim konkret për këtë çështje. Në fund të fundit, ne jemi shoqëri patriarkale, e cila ende po modernizohet, ndryshon në drejtime të mira por edhe të këqija. Si parti realisht nisemi nga fakti që familja e shëndetshme është baza e shoqërisë të shëndetshme dhe me siguri kjo mund të ndikojë tek votuesit dhe rolet tradicionale në shtëpi, shoqëri, shtet... Këto janë gjëra që nuk janë të këqija apo negative, sepse një mikpritës i mirë ndiqet gjithmonë. Komuniteti shqiptar në Mal të Zi është i vetëdijshëm se rolin udhëheqës në familje apo shoqëri e merr gjithmonë më i përshtatshmi dhe jo ai që është i një gjinie të caktuar. Pra, kemi shumë raste ku gratë janë mikpritëse të mira.

**QAQ: A reflektohet kjo edhe në nivelin politik, dhe a janë sektorët e “fuqisë” në Mal të Zi, si siguria dhe mbrojtja, të rezervuara kryesisht për burrat, ndërsa gratë drejtohen më shumë drejt departamenteve “më të buta”, si arsimit, shëndetësia, politika sociale, etj? A po ndryshon kjo gjë?**

**GENCI NIMANBEGU:** Gratë janë të mbipërfaqësuar në arsim, shëndetësi apo gjyqë dhe të gjithë ata sektorë etiketohen si të këqij dhe ku gjithçka duhet korrigjuar. Dhe jo vetëm nga shoqëria jonë, por edhe nga komuniteti ndërkombëtar. Nëse nuk gaboj, kur flasim për strukturën e gjyqtarëve në Mal të Zi, mbi 60% e gjyqtarëve janë gra. Por gjithsesi, besoj se zhvillimi i shoqërisë do të çojë gratë në pozitë më të mirë në Mal të Zi. Është e shprehur aktualisht dhuna në familje ndaj grave, si dhe mizogjia. Kjo është një lloj ballafaqimi me progres, me shoqërinë e informacionit, ku për fat të keq më shumë shpërndahen lajme të këqija sesa lajme të mira. Atëherë shoqëria bëhet më nervoze, e mbyllur, më agresive, që është një problem që prek politikën, shoqërinë, familjen dhe këto janë gjëra që duhet t'i zgjidhim. Jo individualisht, por bashkë, dhe jo vetëm ne si politikanë, por e gjithë shoqëria.

**QAQ: Ligji në Mal të Zi parashikon kuotën minimale prej 30% dhe se çdo grua, pra një pjesëtarë i gjinisë më pak të përfaqësuar, është çdo e katërta kandidatë në listën zgjedhore. A e shihni këtë si masë afirmative dhe zgjidhje të mirë? A respektohet vetëm formalisht apo besoni se ekziston një kuptim themelor i sfondit të këtij problemi?**

**GENCI NIMANBEGU:** Shqipëria ka pasur disa herë grua për kryetare të Kuvendit. Dhe nuk jam i sigurt se e kanë bërë këtë për shkak të përfaqësimit gjinor, apo kuotave në sistemin e tyre, por për shkak të masës së cilësisë apo vendimit që u pranua. Për të qenë kryetar i Kuvendit dikush duhet të ketë së paku 51% të votave. Në Kosovë dy presidente ishin gra. Në Mal të Zi për një periudhë të shkurtër kishim kryetaren e Kuvendit dhe tani zonjën Gjuroviq, do të thosha si produkt i situatës politike, jo si një lloj kompromisi. Theksoj gjithashtu se, për shembull, në Shqipëri ministrja e Mbrojtjes ishte grua. Nuk mendoj se respektohet për hir të rendit, por bëhet fjalë për ndikimin e disa faktorëve - marrëdhëniet në parti politike dhe koalicione, por edhe afinitetin apo dëshirën e atyre që vendosin për at gjë. Le të themi, këtu tek ne mendoj që kryeministri që propozon Qeverinë nuk duhet vetëm të plotësojë kuoten si një lloj dekor, që gratë të marrin vetëm ministri me pak rëndësi se të tjerat, por të jetë edhe vendim i tyre personal dhe shpresoj se këto aktivitete do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**GENCI NIMANBEGU:** Epo, nuk jam i sigurt që vetëm gratë mbrojnë, mbrojnë edhe njerëzit që janë të guximshëm ose mjaftueshëm të informuar për ta bërë këtë. Në fund të fundit, unë si politikan isha në shënjestër shumë herë me disa deklaratat që janë të pavërteta, revanshiste ose shkaktojnë intolerancë kombëtare. Është një proces që është edhe rezultat i ndikimit të rrjeteve sociale në të drejtën e të shprehurit. Sigurisht që edhe kjo është diçka që duhet ta rregullojmë me ligj, sepse për fat të keq e shoh që kjo vetëm më tej kontribuon në përçarjen e shoqërisë. Personalisht besoj se njerëzit jetojnë gjithnjë e më shumë në disa flluska informacioni dhe se në bazë të interesave të tyre, programet që menaxhojnë rrjetet sociale, po u japin vazhdimisht të njëjtin informacion të njëjtëve njerëz bazuar në atë që ishte interesimi i tyre më parë. Ata i synojnë për shkak të interesave komerciale, ku disa nga konsumatorët potencialë të shërbimeve do të përfitojnë për shkak të numrit më të madh të klipeve. Në këtë shoqëri në të cilën ne angazhohemi me politikë, ajo është bërë realisht e papërballueshme. Kjo është arsyeja pse ne nuk jemi më në gjendje të reagojmë vazhdimisht, sepse kjo do të thotë t'u jepet më shumë rëndësi deklaratave të tilla të pavlera, të çmendura, mizogjene që vetëm helmojnë njerëzit. Dhe as vetë shoqëria nuk reagon mjaftueshëm ndaj gjërave të tilla...

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**GENCI NIMANBEGU:** Siç e përmenda më parë, kjo është për shkak se ne kemi fokus tjetër. Fokusin në të drejtën kombëtare ose ekonomike. Është e qartë se një shoqëri kaq e ndarë në Mal të Zi nuk i jep hapësirë të mjaftueshme temave për të cilat Ju po flisni. Përsëri i kthehem tezës se me zhvillimin ekonomik, social, kulturor këto tema do të dalin gjithnjë e më shumë në plan të parë dhe se këto janë gjëra që ndodhin. Kjo nuk shtyhet nën tapet, problemet rreshtohen dhe përmes ndërveprimit të anëtarëve të shoqërisë vijnë edhe zgjidhjet. Po shkojmë në drejtimin e duhur dhe fillimi ynë nuk ishte i keq. Thjesht, si një shoqëri e zhvilluar perëndimore, do të përvetësojmë vlerat më të mira të atyre shoqërive, dhe shpresoj jo ato negative. Sepse, politikisht, nuk jam dakord që ka gjini të mesme në shoqëri. Unë jam pak më tradicional, por respektoj të drejtën e dikujt që të mos deklarohet për këtë. Do ta mbroja atë person nga diskriminimi, por nuk do t'i jepja shumë hapësirë publike, sepse mendoj se këto tema ngarkojnë një pjesë të vogël të shoqërisë dhe ne duhet të fokusohemi që shumica e asaj shoqërie të ecë përpara.



## SRGJAN PERIQ, bartës i listës Kthesë për një Mal të Zi të sigurt

**QAQ: Cili është qëndrimi i përgjithshëm e lëvizjes suaj për çështjet e barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të tyre? Si shfaqet ky qëndrim brenda partisë??**

**SRGJAN PERIQ:** Ne nuk jemi parti politike, por grup qytetarësh. Ka mundësi që në një moment të shkojmë drejt formalizimit të strukturës, sepse dëshira është të hapemi më shumë, ndër të tjera, për shkak të këtij segmenti dhe nëse krijoni strukturën para kohe, modifikimet pas do të jenë shumë më të vështira. Dëshirojmë të kemi shtrirje sa më të gjerë në mënyrë që cilësia të jetë më e lartë. Për sa i përket pozitës së grave, apo siç e njeh ligji – gjinia më pak e përfaqësuar, ka domethënie që i referohet pjesës ligjore të kuotës, por nuk është zgjidhje thelbësore, por vetëm një instrument që së pari duhet të na paralajmërojë të gjithëve sa larg kemi shkuar kur diçka duhet rregulluar me ligj. Pozicionin e grave në Kthesë ilustron nga fakti se në listë është një grua në tre personat kyç dhe kjo është përafërsisht tendencë që përcillet, me faktin se ne jemi strukturë informale, kështu që këta janë më shumë role koordinatorë sesa role formale ekzekutive. Në deklaratat dhe njoftimet mediatike ne në Kthesë kemi shkuar drejt asaj që kjo ndarje të jetë 40:60, me dëshirën që në të ardhmen të ishte plotësisht e balancuar. Dua të shtoj se ne jemi lëvizje e re dhe se ka ende punë për të bërë në këtë fushë. Është e nevojshme, pavarësisht nga gjinia, që njerëzit të fitojnë rutina mediatike. Ekziston edhe një faktor tjetër që e ndërlikon më tej situatën – mbyllja e mediave ndaj subjekteve civile që, në një farë mënyre nuk janë të themeluara. Kjo i dekurajon më tej të gjithë, veçanërisht ato që tashmë janë të dekurajuar në jetën politike, dhe media ka përgjegjësi të madhe në këtë. Normal që, në nivel deklarativ, ata do të thonë gjithçka që është afirmative kur ka diskriminim pozitiv, por në situatë konkrete kur duhet t'i mundësohet personit të thotë diçka, atëherë parimet fillojnë të tërhiqen dhe interesat politik të mega-strukturave dalin në plan të parë, dhe në plan të parë që dalin janë burrat. Rezultati, pra, është dekurajim i dyfishtë. Nuk ka dorëzim, por ka barrë shtesë – si në aspektin kulturor, ekonomik, politik dhe sociologjik. Krahas gjithë kësaj, kur mban barrë në çdo fushë dhe dikush të rëndon, jo vetëm politikisht por edhe në mënyrë mediatike, atëherë keni dekurajim që është shumë shqetësuese.

**QAQ: Pra, mendoni se në përgjithësi si lëvizje ju mungon hapësira në media, sidomos kur bëhet fjalë për shfaqjet e grave?**

**SRGJAN PERIQ:** Ashtu është. Ne, për shembull, kishim një situatë ku ishim të gatshëm të diskutonim disa çështje, dhe konkretisht kur dy gra donin të flisnin për këtë, por nuk u dha mundësia të shfaqen. Në të njëjtën kohë, jam i bindur se nuk ishte problemi sepse janë gra, por se vijnë nga subjekti civil që nuk ka askënd pas vetes, dhe ato, po e përsëris, dekurajohen. Ky është një mesazh i keq që duhet ndryshuar në disa nivele.

**QAQ: Si e vlerësoni përfaqësimin e ulët të grave në jetën politike dhe në pozitat vendimmarrëse?**

**SRGJAN PERIQ:** Dështuese, por nuk është situatë e djeshme. Duket se hapi më i madh përpara është bërë në periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore. Dhe në vend që të vazhdonim atë prirje në vitet '90 dhe të jemi shoqëri që do të arrinte barazinë e plotë, ne kemi përjetuar një lloj regresioni. Gratë nuk kanë paga të njëjta për të njëjtat punë dhe kanë ecëshmëri më të vështirë në një shumicë të konsiderueshme të çdo hierarkie. Stereotipet se cili është roli i gruas, cili është roli i burrit, çfarë mund të bëjë dhe çfarë nuk mund të bëjë një grua, tani po hiqen, por ne ende i dëgjojmë këto gjëra në vitin 2023. Kjo është veçanërisht e theksuar kur gratë janë mjaft të vetëdijshme dhe kur ato janë në një sferë të hapësirës publike dhe kur i rishikojnë problemet më të thella sociale ato kalojnë rrjedhat më të këqija dhe primitive në të cilin pothuajse gjithmonë ka një moment mizogjen. Fushatat më të ndyra në Mal të Zi janë bërë posaçërisht kundër grave dhe ky është shkak shqetësues. Ne nuk arritëm të sanksionim në mënyrë adekuate ata që frymëzuan ato fushata në procedurat gjyqësore. Ka

pasur vendime të caktuara për fyerje të nderit dhe reputacionit, por kjo nuk e riparoi dëmin e bërë. Është diçka që jep kënaqësi etike, por në përgjithësi nuk është as afër një zëvendësimi adekuat.

**QAQ: Edhe në fillim të kësaj fushate për zgjedhjet parlamentare, nga një portal mediatik dëshmuam një fushatë jashtëzakonisht negative kundër disa fytyrave të grave të njohura nga skena politike e Malit të Zi. Si e vlerësoni këtë?**

**SRGJAN PERIQ:** Nuk mund t'i mbuloj të gjitha njoftimet mediatike, por diçka që ka arritur tek unë është absolutisht e papranueshme, në kuptimin që ju në thelb po i bëni gratë në politikë objekte për çdo lloj ngarkese, nga konotacionet mizogjene deri në, në nivel njerëzor, degradimin e personalitetit. Kjo, mjaft shpesh, ka edhe kuptime që lidhen me gjininë.

Ndodh në luftë politike që të kem një bashkëbiseduese grua me të cilën nuk jam dakord, por ajo polemika reduktohet në rang argumentesh. Por, në momentin që ju, nëse jeni të vetëdijshëm apo jo, dhe nuk e di se cila është më e keqja, përdorni përkatësinë gjinore për të treguar një epërsi imagjinare tuajën, atëherë kemi një problem të madh që vetëm thëllon stereotipet jashtëzakonisht negative.

**QAQ: A ishin këto çështje të pranishme në një moment në fushatën tuaj për zgjedhjet parlamentare?**

**SRGJAN PERIQ:** Disa herë anëtarët e Kthesës në debate publike e kanë vënë në dukje këtë çështje, por edhe në rrjete sociale, sepse kemi problem me aksesin në media. Folëm për këtë çështje, diskutuam në miniforume me qytetarët dhe qytetarët dhe kudo që kishim hapësirë.

Në zgjedhjet lokale pothuajse nuk kemi trajtuar ndonjë temë përveç asaj komunale, me disa reagime që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut.

Krahas kësaj, dua të theksoj se publikisht kemi prezantuar vetëm parimet themelore, sepse jemi përballur me faktin se njerëzit nga subjektet e tjera politike pothuajse përsërisin atë që ne publikojmë. Kjo është deri diku një njohje, por na ngadalëson politikisht dhe na detyron t'i shpjegojmë gradualisht idetë tona. E përsëris, nuk diskutohet që dikush të marrë përsipër një ide, por nëse e kompromenton dhe deformon në interpretim, atëherë një ide fillimisht e mirë mund të bëhet e pakuptimtë. Kjo është arsyeja pse duhet të shpjegohen me durim se cilat janë idetë themelore, dhe për këtë duhet gradualizëm.

**QAQ: A është lëvizja juaj e vetëdijshme për pengesat me të cilat përballen gratë që do të donin të ishin ose janë tashmë pjesë e jetës publike?**

**SRGJAN PERIQ:** Besoj se janë. Në njëzet personat e para të listës, katër gra hoqën dorë pak para dorëzimit të listës, duke vlerësuar se ishte shumë për to. Njëra prej tyre (ndërmarrëse) tha – „edhe kështu kam probleme, nuk më duhen më shumë”. Sado që ne flasim, ato rrinë aty, kontribuojnë, por ky është sinjal se çfarë do të thotë dekurajimi, por edhe sa e vështirë është kur përballësh me disa situata operacionale që janë kërkuese për një subjekt që po ndërtohet. Në përgjithësi, në skenën politike ka një strukturë dominuese mashkullore që vendos kufizime për gratë. Nëse një grua performon në subjekt ku do të ketë autonomi më të madhe, ku do të jetë më e fortë, ajo ka përparim më të vështirë, por nëse shkon në një megastrukturë, si rregull, do të vendoset në një vend të “plotësojës kuotën”, “vendoset në vitrinë”, dhe thelbi nuk ndryshon. Ajo politikë e fasadave mbetet, është problem i vazhdueshëm dhe ne nuk po bëjmë asnjë përparim - të gjithë kemi mbetur të bllokuar në atë përqindje prej 30% të grave, çdo e katërta grua në listë. Mendoj se më afër të thuash 45:55% do të ishte mirë. Ose, rendi në listë duhet të jetë i alternuar. Paragjykimi është se politika është “punë për burra”, edhe pse burrat janë më të interesuar për të.

**QAQ: Si është ambienti për pjesëmarrjen politike të grave në Kthesë dhe a u jepet hapësirë e mjaftueshme brenda lëvizjes?**

**SRGJAN PERIQ:** Mendoj se jam subjektiv këtu. Më duket se nuk bëjmë ndonjë krahasim, por kjo është ndjenja ime subjektive. Ju duhet të pyesni një nga koleget, por në përgjithësi, në komunikimin informal, në hartimin e programit, gjërat shkojnë shumë më lehtë. Kur arrin në pjesën publike, kur hyn në hapësirën publike, ka më shumë rezistencë ndaj atij lloj ekspozimi. Është çështje që nuk lidhet ekskluzivisht me barazinë gjinore, shpesh është çështje trajnimi dhe rutinë mediatike që kërkon kohë.

**QAQ: Çfarë keni bërë personalisht, brenda partisë dhe si bartës i listës, për të motivuar apo frymëzuar gratë që të hyjnë në garën zgjedhore dhe të aktivizohen brenda lëvizjes?**

**SRGJAN PERIQ:** I vetmi mjet që mund të kem është biseda dhe bindja. E bëj këtë në masën që di dhe që mundem. Nuk kam instrumente të tjera dhe as nuk dua ti kem. Mundet më shumë, mundet më mirë - nuk kam dilemë këtu, duhet bërë më shumë përpjekje. Nga ana tjetër, shpesh ndihem si dikush që ka hapur shumë fronte, sepse ende duhet të kesh parasysh se çfarë mund të arrish në cilin front. Por, e përsëris mundet më shumë, mundet më mirë jam i vetëdijshëm se duhet bërë më shumë përpjekje në atë drejtim.

**QAQ: Jemi dëshmitarë se në numrin më të madh të rasteve, në të 15 listat zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, gratë janë të përfaqësuara pothuajse në masën minimale të kërkuar me ligj, pra 30%. Cila është arsyeja për këtë?**

**SRGJAN PERIQ:** Mund të jetë një ide e mirë të rrisim kuotat, nëse kjo është e vetmja gjë që funksionon. Sigurisht, do të ishte më mirë ta shtynim vetë. Ka edhe një gjë, të jem plotësisht i sinqertë, mendoj se është edhe përgjegjësi e grave që të përfshihen më shumë. Besoj se ka shumë gra të vetëdijshme që nuk janë të gatshme të marrin pjesë në politikë. Njëjtë është edhe me burrat, por këtu problemi është më i dukshëm dhe më i theksuar. Prandaj, pushteti është absolutisht i përqendruar në duart e burrave, por gjithashtu u takon grave që ta kërkojnë mbrapa.

**QAQ: Përveç atij dekurajimi, a mendoni se ka ndonjë keqkuptim në parti apo një qëllim të vetëdijshëm për të diskredituar gratë? Ju kujtoj se më parë komisionet komunale zgjedhore shpallnin lista haptazi dhe kundër ligjit me numër të pamjaftueshëm të grave, të cilat gjithmonë kalonin të pasankionuara.**

**SRGJAN PERIQ:** Mund të jenë të dyja. Njerëzit nuk janë të vetëdijshëm se sa arbitrarisht sillen partitë dhe liderët e tyre, sepse e kanë pushtetin në dorë. Ka mjaft sipërfaqësi sepse partitë mendojnë se kush u jep më shumë vota të sigurta. Si në të kaluarën, ashtu është edhe qeveria aktuale. Duket se burrat mund të kenë vota më të sigurta dhe më pas janë më depërtues. Pra, lufta për barazi është luftë që vazhdon, dhe çdo luftë ju kushton kohë dhe burime të çdo lloji - nga nervat tek paratë. Kjo luftë është e vlefshme, por duhet të përfshijë një kritikë të pamëshirshme ndaj gjithçkaje dhe kujtdo që ngadalëson proceset emancipuese në thelb. Stereotipi është se votuesit u besojnë më shumë burrave. Unë kam qenë i pranishëm, kur vizitohet tereni, ku njerëzit duan të dëgjojnë një grua të njohur nga media.

**QAQ: Le të lëmë mënjanë votuesit dhe qëndrimin e tyre ndaj kësaj çështjeje, por jemi të vetëdijshëm se në skenën politike malazeze sektorët si siguria, mbrojtja etj. është i ashtuquajturi sektori "burrëror". A kanë partitë qëllim të ndërgjegjshëm për të vendosur vetëm burra në pozita të tilla pushteti dhe për të diskredituar gratë?**

**SRGJAN PERIQ:** Thonë se në jetë ke miq, armiq dhe shokë partie. Fatkeqësisht, në parti ka njerëz me ambicie të mëdha. Në çdo rast, nëse ata kanë diçka që mund ta përdorin si avantazh në politikë, njerëzit shumë shpesh e përdorin - nëse keni stereotip gjinor "në anën tuaj" edhe aj do të përdoret. Kjo është arsyeja pse ju mund të dëgjoni thashetheme: "ajo është e mirë, por..." dhe më pas jepen disa nga stereotipet gjinore.

**QAQ: Pse nuk kishte më shumë gra në listën tuaj?**

**SRGJAN PERIQ:** Kritika qëndron, e pranoj dhe pajtohem, do të punojmë për këtë çështje. Një pjesë të arsyes e kam cekur tashmë.

**QAQ: Sipas jush, cilët janë mekanizmat për përfshirje më të madhe të grave në politikë?**

**SRGJAN PERIQ:** Para së gjithash - ligjërisht, gjë që unë personalisht mendoj se nuk do të ishte keq të përmirësohej. Nga ana tjetër, këmbëngulja. Do të ishte mirë që edhe burrat të tregonin më shumë përgjegjësi për të, por gratë duhet të kërkojnë më shumë për të marrë më shumë. Si çdo grup me më pak të drejta, merr më shumë kur kërkon më shumë. Ja një shembull interesant - kur njerëzit protestonin kundër ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël, ku banorët ishin tërësisht me ju, mund të bënit shumë, ku nuk ishin, ishit shumë të kufizuar. Pra, kur ata që janë të prekur përfshihen në luftë - është më e lehtë.

**QAQ: Si mund t'i inkurajojmë vetë burrat në parti që të përfshihen më shumë në atë pjesë dhe të fuqizojnë koleget e tyre?**

**SRGJAN PERIQ:** Shpesh egziston procesi i ndërgjegjësimit, por kam frikë se nuk ka shumë efekt. Është një proces shumë i gjatë që duhet të ketë shumë hapa reciproke, duhet të ketë një strategji të qartë që përfshinë zgjidhje ligjore, një lloj plan veprimi që duhet të tregojë se ecim në drejtimin e dëshiruar. Duhet kujtuar vazhdimisht se çka është qëllimi. Nuk është e mundur të arrihet shumë në periudhë afatshkurtër, por në vazhdimësi gjatë disa viteve, mendoj se mund të bëhet përparim i dukshëm. Ne kemi nevojë për atë kthesë.

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ, bartëse e listës „Po. Ne mundemi për Malin e Zi qytetarë“**

**QAQ: Është interesante që ka një numër veçanërisht të madh të grave në listën tuaj. Çfarë ju ka motivuar të mblidheni në këtë mënyrë para zgjedhjeve parlamentare dhe cila është struktura e lëvizjes suaj?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Ne jemi bashkuar joformalisht shumë kohë më parë, diku në 2003. Të gjitha ishim gra, dhe qëllimi ynë ishte që të kryenim disa aksione humanitare për kategoritë e rrezikuara dhe të cenueshme shoqërore - të moshuarit, fëmijët dhe gratë. Asnjëherë nuk jemi marrë me media, sepse nuk u përkasim atyre që besojnë se çdo vepër duhet të prezantohet para publikut. Diku nga viti 2021 ne ekzistojmë si lëvizje civile - OJQ Ne mundemi. Kur kemi vënë emrin *Ne mundemi*, nuk kemi menduar si *NE* në lëvizje, por të gjithë së bashku - si shoqëri. Kështu e nisëm këtë lojë politike, sepse nuk na pëlqen ky Mali i Zi. Nuk e kemi menduar kurrë të futemi në politikë, nuk jemi marrë kurrë me politikë, por kur e kemi parë se dikush po merret me jetën tonë, se dikush merrte vendime në emrin tonë dhe se dikush ishte dukshëm më pak i aftë dhe më pak i arsimuar dhe më pak profesionist, dhe ka shumë qëllime të këqija dhe më së shumti shikon interesin e tij personal dhe interesin e partisë së tij politike, vendosëm të përfshihemi në garën politike. Pastaj u bëmë lëvizje civile që u përfshi në jetën politike. Te ne erdhën edhe kolegët tanë, aty tashmë janë rreth 30-40 burra dhe ne po shkojmë në zgjedhje në koalicion me partinë Mali i Zi Qytetar. Të gjithë që iu bashkuam lëvizjes ishim të

arritur në profesionet tona dhe në jetën tonë, por ndjemë nevojën dhe detyrimin për të dhënë kontribut dhe për ta bërë më të bukur këtë shoqëri dhe vendin e Malit të Zi, për të cilin vlerësojmë se është në rrugë të keqe, të jetë vend më i bukur për të jetuar për të gjithë ne që jetojmë këtu.

**QAQ: Pozicioni i gruas në shoqërinë malazeze është një nga shtyllat kurrizore e programit tuaj?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Po, kjo është një nga temat kryesore me të cilën jemi marrë me dekada - pozita e grave në shoqërinë malazeze dhe ndihma e grave në Mal të Zi që të marrin jetën e tyre në duart e tyre dhe të kontribuojnë më shumë për veten, familjen e tyre dhe gjithë shoqërinë. Kjo është një nga pikat dhe tani është prioriteti ynë i parë, kur vendosëm të shkojmë në zgjedhjet parlamentare, të luftojmë për depolitizimin dhe departizimin e plotë të shoqërisë malazeze. Është parakusht për çdo të mirë që duhet të ndodhë, kur të bëhet në të gjitha sferat e jetës në Mal të Zi, në të gjitha institucionet, vetëm atëherë mund të zgjidhen gjëra të tjera. Kur gjyqi të mos jetë i përçarë politikisht, kur të mos dëgjojmë më në Kuvend se cilët gjyqtarë janë tanët e cilët janë të tutë, si të presim që ata gjyqtarë të gjykojnë sipas drejtësisë dhe ligjit – ato do gjykojnë sipas cilës parti politike i përkasin. Kjo krijon jo vetëm pasiguri, por edhe frikë tek qytetarët, dhe ne do të luftojmë për meritokraci - që njerëzit që janë të arsimuar, profesionistë dhe dinë të punojnë, kanë përvojë, e kanë dëshmuar veten, pavarësisht se cilit grup i përkasin. Shoqëria malazeze do të mund të ecë përpara vetëm kur të arrihet kjo. Ne do të luftojmë për këtë, do të jetë pika e parë dhe vetëm pas kësaj do të zgjidhen të gjitha çështjet e tjera, dmth, ne do të punojmë për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, dhe kjo përfshin kujdesin shëndetësor, arsimin dhe kulturën, dhe këto janë shtyllat e shoqërisë që të gjithë i kanë lënë pas dore.

**QAQ: Cila është pozita e grave në politikën malazeze, në pozitat vendimmarrëse, por edhe në shoqëri në përgjithësi? Si e komentoni përfaqësimin e pamjaftueshëm të grave në këto pozita?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Është e qartë se ato janë shumë pak të përfaqësuara në politikë dhe se disa parti duhet të bëjnë diçka për këtë me forcën e ligjit. Ekziston një dispozitë ligjore që çdo vend të katërt duhet ta zë një person që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, por kjo u kuptua nga partitë e tjera se bëhej fjalë për një grua dhe i vendosën në çdo të katërtin vend sepse u detyroheshin. Në politikën malazeze ka gra shumë të mira, ka pasur gjatë gjithë kësaj kohe. Fatkeqësisht, ato ishin të pakta dhe ajo që tregon se duhet të ketë më shumë gra është se Klubi i Grave ka funksionuar më i miri në Kuvend, pavarësisht se ka pasur gra nga të gjitha partitë. Pse nuk ka më shumë? Unë mendoj se ka pak të bëjë me vetë gratë, sepse shoqëria malazeze është vend ku është e vështirë për gratë të inkurajohen për të hyrë në sferën e jetës publike, veçanërisht atë të jetës politike, ku shoqëria priret ta shikojë atë nën mikroskop dhe t'i gjejë të meta që ajo nuk i ka dhe ta kritikoi atë për gjëra për të cilat nuk duhet të kritikohet. Gratë pastaj hezitojnë të shkojnë në atë sferë. Në listën tonë ka më shumë gra dhe prandaj mendoj se është edhe deri tek gratë. Jo, sigurisht, vetëm për gratë, sepse në partitë që tashmë ekzistojnë, burrat duhet të përfshijnë koleget e tyre femra, anëtarët e familjes që ata e dinë se janë të aftë dhe mund t'i kryejnë këto funksione.

Ne në lëvizjen tonë nuk i kemi pasur këto probleme dhe as kur kemi hyrë në koalicion me parti tashmë ekzistuese, përkatësisht Mali i Zi Qytetar, ato nuk kishin shumicën gra, por nuk kanë pasur asnjë problem, përkundrazi e kanë përkrahur planin tonë dhe kanë përfshirë më shumë gra që i përkasin partisë së tyre. Kështu u bëmë një njësi dhe ata pranuan që në postet kyçe të kishte gra nga partia e tyre si me ta ashtu edhe përballë burrave. Dhe jo vetëm që pranuan, por e mbështetën vërtet me gjithë zemër.

**QAQ: Ju përmendët Klubin e Grave në Kuvend. A mendoni se ka solidaritet thelbësor brenda atij organi? Sa është e vështirë t'i tejkalosh pikëpamjet e ngushta partiake dhe të biesh dakord të paktën për ato çështje që janë të rëndësishme për vetë gratë?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Ndoshta nuk është as reale të pritët që të ketë solidaritet, ato i përkasin

partive të caktuara dhe nëse do të ishte kështu, atëherë do të formonin partinë e tyre. Realisht as që pritet që ata të votojnë njësoj, këtë e shoh edhe nga ne - jemi lëvizje që jemi në koalicion me një parti, por i harmonizojmë pikëpamjet tona për disa çështje kyçe. Deri më tani, nuk kemi pasur absolutisht asnjë mosmarrëveshje dhe të gjithë mendojmë saktësisht njësoj për çdo çështje kyçe për Malin e Zi. Mirëpo, është mirë që të gjitha kanë reaguar kur njëra prej grave është ekspozuar ndaj përbuzjeve, ofendimeve dhe sulmeve. Është stimulim për të zhvilluar këtë solidaritet femëror në Mal të Zi dhe për të ndihmuar gratë e tjera që janë ende në telashe, të cilat ende nuk mund të inkurajohen të marrin jetën e tyre në duart e tyre, të fuqizohen për ta bërë këtë.

**QAQ: *Cilat janë pengesat me të cilat përballen gratë që janë ose duan të jenë pjesë e jetës publike dhe të zënë pozita të caktuara në politikë dhe shoqëri?***

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Asnjë grua nga lëvizja jonë apo partia me të cilën jemi në koalicion nuk është ndoshta bashkëbiseduese e mirë, sepse asnjëra prej nesh nuk ka hasur në pengesa dhe nënçmime të tilla sepse është grua dhe ndoshta nuk zë vendin e duhur për shkak të kësaj. Kjo buron nga familja, pra qeliza bazë e shoqërisë, dhe kur një grua ka sigurinë atje, nëse ndihet e mbrojtur në familjen e saj, dhe ka mbështetje për të investuar në veten e saj, për t'u arsimuar, për të marrë jetën në duart e veta, të jetë ekonomiksht i pavarur, që është pikënisja e gjithçkaje, atëherë do të jetë shumë më e lehtë të përfshihesh në të gjitha sferat e jetës.

Ne punojmë për këtë fuqizim të grave, kemi pasur shumë aksione kur bëhet fjalë për nënat beqare. Ne i ndihmojmë të punësohen, të shohin se cilat janë aftësitë e tyre, cilat janë kualifikimet e tyre... I inkurajojmë të gjithë të fillojnë një lloj ndërmarrje, sepse ka kushte dhe programe të mira për gratë në biznes ashtu edhe për fillestarët në biznes, vetëm njerëzit që janë nga ato struktura sociale të cënueshme nuk dinë ta përdorin atë. Ne jemi këtu për t'i ndihmuar ata të fillojnë biznesin e tyre të vogël që do t'u sjellë të ardhura. Patëm rezultate të shkëlqyera dhe mund të shihni ndryshime drastike tek këto gra. Pra, është e rëndësishme që gruaja të fuqizohet në familje, të sjellë nga familja që është plotësisht e barabartë me vëllezërit e saj, të shkollohet, të fillojë të punojë dhe të jetë e pavarur ekonomiksht. Gjithçka më pas shkon shumë më lehtë, sepse realisht asnjëra prej nesh nuk ka hasur ndonjëherë në ndonjë pengesë, por ndoshta sepse e bartim nga familja.

**QAQ: *A mendoni se një nga zgjidhjet për fuqizimin e grave do të jetë një numër më i madh i grave në pozita vendimmarrëse, në pozita udhëheqëse, të cilat do të dërgonin mesazhe inkurajuese në atë mënyrë?***

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Vetë paraqitja jonë, edhe pse ende nuk kemi hyrë në strukturat qeveritare, dërgoi mesazh të shkëlqyer. Na kontaktojnë një numër i madh grash që janë entuziaste dhe na bashkohen dhe na gëzon shumë fakti që na bashkohen një numër i madh të grave të reja, studente, të cilat kanë mbështetjen e familjeve të tyre. Kemi pasur raste në terren kur shkojmë në qytet prej nga vijnë anëtarët tona që janë studente ku na afrohen prindërit e tyre të cilët na falënderojnë që vajzat e tyre janë përfshirë në këtë. Pra, situata tashmë po ndryshon - baballarët duan t'i shohin vajzat e tyre në atë jetë publike, që ato të ekspozohen, të tregojnë aftësitë dhe njohuritë e tyre, duke dashur që një ditë, kur të mbarojnë studimet, të fillojnë të punojnë dhe të jenë publikisht të ekspozuara, të marrin funksione. Pra, pamja jonë bëri shumë edhe për femrat. Patjetër që do të ishte më mirë nëse do të rritej numri i grave edhe në Parlamentit edhe në ekzekutivë, atëherë do të bëhej diçka normale, siç është në vendet evropiane. Ne përfaqësojmë një tezë që mendojmë se është realitet - duhet të ketë më shumë gra, sepse gratë janë më të vendosura, më të guximshme, më të mira në trajtimin e problemeve në përgjithësi, janë më racionale dhe marrin vendime shumë më të mençura, pa përfshirë shumë emocione, veçanërisht kur bëhet fjalë për vendime të rëndësishme si për familjen, ashtu edhe për shtetin dhe për të gjithë shoqërinë. Deri më tani, politikanët e kanë pasur këtë mundësi, ndaj kemi parë që nuk shkon ashtu siç duhet. Tani është mundësia që gratë të provojnë veten në katër vitet e ardhshme.

**QAQ: Në skenën politike malazeze, deri tani fusha si siguria kombëtare, lufta kundër krimit, mbrojtja etj. ishin pothuajse ekskluzivisht punë “burrërore”. A mendoni se në këtë drejtim duhet të mendojmë ndryshe dhe të emërojmë gra profesionale dhe të kualifikuara për të menaxhuar këto departamente dhe për ti tejkaluar stereotipet ekzistuese se për gratë nuk janë këto pozita?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Besojmë se gratë do të ishin më të mira në menaxhimin e të gjithë sektorëve. Kur thonë mbrojtje dhe siguri, njeriu mendon menjëherë se dikush tani do të luftojë, të shkojë në luftë etj. Sigurisht që aktualisht ka edhe gra në vende drejtuese, por kur flasim për drejtuesen e një sektori, padyshim mendoj se gratë do të merrnin vendime më racionale, më të guximshme, më të mira se burrat. Sigurisht, me bashkëpunëtorët dhe me një hierarki ku sigurisht do të kishte më shumë burra në atë sektor të sigurisë, gjë që është mirë, por gratë ta drejtojnë ata sektorë do të ishte zgjidhje më e mirë. Gjithashtu, jemi të sigurt se në sferën e ekonomisë dhe financave një grua do të ishte më e mirë. Patjetër, sado që burrat në Mal të Zi të mburren se janë zoti i shtëpisë, të gjithë e dinë që gruaja është shtylla e shtëpisë, gruaja merret me financat e shtëpisë dhe tashmë gjithnjë e më shumë burra e pranojnë këtë. Dhe është vërtetuar që një grua kujdeset shumë më mirë për buxhetin e familjes dhe e bën atë në mënyrë shumë më racionale, dhe këtë do ta bënte edhe në nivel shtetëror, kështu që sektori i ekonomisë do të kishte nevojë patjetër për gratë.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Të gjitha partitë, kur shkojnë në zgjedhje, shikojnë se si do të kenë më shumë votues. Fatkeqësisht, çështja e barazisë gjinore ende nuk është ngritur, sepse besojnë se nuk do të fitojë aq vota sa mund të fitojnë me disa çështje identiteti apo ekonomike. Gjithmonë thuhet se këto janë zgjedhjet vendimtare, gjithmonë kanë të bëjnë me gjendjen e shtetit dhe të ekonomisë dhe pastaj çështjet e barazisë gjinore nuk janë asnjëherë në rend dite. Edhe, po të pyesësh burrat, ata do të thoshin se gratë janë të barabarta. Por është e qartë se nuk ka mjaft gra jo vetëm në politikë, por nuk ka gra në poste, nuk ka gra në postet e drejtoreshës së kompanive etj. Ka disa në gjyqje, mjekësi etj., por vetëm se janë më të fokusuar në ato profesione.

**QAQ: A egziston nevoja për të punuar më shumë me burrat brenda lëvizjes apo janë mjaft të arsimuar dhe të sensibilizuar për barazinë gjinore?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Jo, vërtetë jo. Përkundrazi, vendin e tyre ia lanë grave, duke konsideruar se gratë janë më të afta, por mesiguri është kështu për shkak se bëhet fjalë për burra që kanë arritur sukses në jetën dhe profesionin e tyre. Një burrë që është i përbushur në jetën e tij dhe i cili është i vetëdijshëm për cilësitë dhe forcën e tij nuk do të shqetësohet nga një grua e fortë, një grua e tillë do të shqetësojë vetëm atë që nuk është i përbushur dhe që ka komplekse, dhe për këtë arsye ai do të shqetësohet nga një grua që është më e fortë dhe më e aftë se ai.

Madje tek ne ka ndodhur një gjë interesante. Ne duhej për të paraqitur listën zgjedhore të kërkonim më shumë burra për të plotësuar kuotën. Gratë disi na u afruan, spontanisht, duan ndryshime, duan të dalin përpara, tregojnë më shumë guxim... Qytetarët duhet të kuptojnë se zëri i tyre është shumë i rëndësishëm, se zëri i tyre mund të ndikojë, ndoshta të jetë vendimtar kush do ta marrë atë pjesë të qeverisë dhe pastaj çfarë lloj vendimesh do të marrin.

**QAQ: Në çfarë mase kuotat janë zgjidhje thelbësore dhe në çfarë mase ato janë thjesht një lloj mekanizmi kalimtar?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Nuk mendoj se është keq që dikush mendoi ta fusë në ligj. Është tragjike që dikush duhet të përfshijë atë përqindje të grave në ligj, por është mirë, sepse kështu është ngritur çështja, ndaj mendoj se tashmë po shkon drejt rritjes spontane.

**QAQ: Si mund të kontribuojnë vetë burrat brenda partive dhe çfarë veprimesh duhet të ndër marrin për të rritur nivelin e pjesëmarrjes politike të grave?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Ne psh, burrat që janë pjesë jo vetëm të lëvizjes sonë, por edhe të partisë me të cilën kemi hyrë në koalicion, para zgjedhjeve, nuk kemi nevojë t'i edukojmë, ata e pranojnë plotësisht këtë pjesë dhe unë nuk mendoj se ndokush ka nevojë për inkurajim, përveç ta pranojnë që gratë dhe burrat janë plotësisht të barabartë, në çdo kuptim. Sigurisht, burrat ndryshojnë në njëfarë kuptimi dhe gjërash, por përse i përket funksionimit, punës, biznesit, unë mendoj vërtet pozitivisht. Një burrë duhet të jetë i kompletuar, i vetëdijshëm për cilësitë e tij dhe pastaj nuk do të ketë asnjë problem me faktin që një grua është pranë tij në një pozicion.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**DRAGICA PEROVIQ IVANOVIQ:** Ky është padyshim problem, ata duhej ta bënin. Së pari duhej ata duhej të reagonin, për mendimin tim burrat duhet të mbrojnë koleget e tyre. Gratë reagues sepse mund ta vendosin veten në pozicion ku dikush i nënçmon, por është më mirë kur burrat fillojnë të reagojnë. Fatkeqësisht, kjo është e qartë se ende nuk është kështu dhe shpresoj se do të ndryshojë, sepse çështja është se ata duhet të sulmojnë atë që e tha dhe të mbrojnë gratë, vetëm atëherë do të jetë mbështetje e sigurtë e burrave që gratë të jenë në jetën publike. Kur një grua mbron një grua, ajo mbron sepse i pengon ajo gjë, ajo e sheh veten në atë pozicion dhe praktikisht mbrohet, por e vërteta do të jetë kur burrat të fillojnë të veprojnë në atë mënyrë.

DANIJELL ZHIVKOVIQ, bartës i listës BASHKË! Për të ardhmen që të takon (PDS, SD, UDSH, PL)

**QAQ: Cili është qëndrimi i përgjithshëm i partisë për çështjet e barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Si shfaqet ky qëndrim brenda partisë?**

**DANIJELL ZHIVKOVIQ:** Sa herë që flasim për pjesëmarrjen e grave në politikë, flasim për përfaqësimin që është i përcaktuar me ligj, pra për kuota të caktuara. Të them të drejtën, kuotat u futën kur shoqëria nuk e njihje domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së grave në politikë, por ishte nevoja të përcaktohej me ligj.

Në partinë tonë ka një konsideratë të madhe për pjesëmarrjen aktive të grave në jetën politike. Në fund të fundit, këtë e kemi dëshmuar me faktin se kemi formën organizative siç është Aleanca e Grave, e cila, për mendimin tim, vepron në mënyrë shumë proaktive në skenën shoqërore dhe politike. Statuti, d.m.th., dokumentet programore, parashikojnë atë që bën Aleanca e Grave, dhe është e përbërë nga gratë e Malit të Zi, nga të gjitha bordet komunale, dhe puna e saj është e dukshme edhe në media. Theksi duhet të vihet gjithmonë te komunikimi i Aleancës së Grave, si me median ashtu edhe me sektorin civil, sepse ky është komponent i ri që kjo mbledhje e Aleancës ka



futur në punën e saj dhe tashmë ka pasur të suksesshëm modelin e bashkëpunimit, si me faktorin ndërkombëtar, ashtu edhe me sektorin civil. Aleanca e Grave është shtylla e politikës sonë dhe këtë e vërteton ndër të tjera lista jonë zgjedhore me mbi 40% gra. Nuk deshëm të flasim vetëm për kuotat, por për faktin se gratë janë realisht të përfaqësuara në jetën politike me synim të ofrojnë kualitet të ri të dinamikës së ndryshimeve politike në Mal të Zi, pra hapjes së proceseve demokratike. Kjo tregohet përmes pjesëmarrjes së grave në politikë, ato japin kontribut të veçantë në ndërtimin e këtyre proceseve. Kjo u pa edhe në periudhën e kaluar, kur në Kuvendin e Malit të Zi funksiononte Klubi i Grave, në të cilin kishim për kryetare - Vesnën Paviqeviq, si dhe gratë nga klubi ynë ishin të përfaqësuara në Klub të Grave. Kam pasur rastin të vërej se atje është arritur më lehtë një konsensus në disa çështje se sa ç'kemi arritur në përgjithësi në Kuvend me dialog për zgjidhjen e çështjeve të rëndësishme që ngarkojnë shoqërinë malazeze. Qëllimi i këtij klubi ishte që përmes bashkëpunimit të çonte në iniciativa ligjore të cilat do të mundësonin aksesin dhe zgjidhjen e sfidave të caktuara që e ngarkuan shoqërinë malazeze në mënyrë të rëndë. Kjo u vërtetua edhe përmes një sërë iniciativash ligjore që ndoshta kanë nevojë për disa përmirësime, por është ofruar një model i mirë dhe unë e shoh këtë si një mundësi dhe shans për pjesëmarrjen e grave.

Për sa i përket Partisë Demokratike Socialiste (PDS) konkretisht, gjithmonë veprojmë bazuar në cilësinë shtesë, pa krahasuar cilësinë midis gjinive, larg kësaj. Mendoj se gratë në PDS, në çdo pozicion, në Kuvend ose jashtë tij, në të gjitha tubimet kanë treguar nivel të lartë përgjegjësie ndaj interesave kombëtare dhe kanë treguar se munden, dinë si të drejtojnë proceset e caktuara. Prandaj, nëse bëhet fjalë për PDS-në, në periudhën e ardhshme do të ketë mbështetje të plotë për afirmimin në aspektin e përfaqësimit të grave në listat e zgjedhura, por edhe për fuqizimin ekonomik të grave në Mal të Zi.

**QAQ: Çfarë ka treguar përvoja e deritanishme, a arrijnë gratë të kalojnë kornizat e përcaktuara ideologjike dhe partiake kur duhet votuar një ligj që ka rëndësi për të gjitha njësoj? A bashkohen atëherë dhe a gjejnë një kompromis?**

**DANIJEL ZHIVKOVIQ:** Më duket se ia dalin. Dhe në dy seancat e mëparshme, e pamë se gratë mund të bashkohen rreth disa çështjeve të rëndësishme. Për shembull, për Fondin e Alimentimit ose për Kodin Penal, etj. E gjithë kjo është organizuar me qëllim të arritjes së një zgjidhjeje ligjore që do të parandalojë sfidat me të cilat përballet shoqëria malazeze, por edhe për të vepruar ndaj pasojave që kanë lindur ndërkohë. A mund të ishin përcaktuar më mirë disa nga ato zgjidhje ligjore me komunikim më të mirë me përfaqësuesit e pushtetit ekzekutiv? Sigurisht që po. Në një moment u tregua se zbatimi i disa zgjidhjeve ligjore ishte i vështirë, por nuk ka dyshim se është qëllim i mirë dhe praktikë e mirë e shoqërimit të grave brenda Kuvendit për hir të ndonjë aktiviteti normativ që adreson disa çështjet sfiduese.

**QAQ: Si është mjedisi për pjesëmarrjen politike të grave brenda partisë/koalicionit tuaj dhe a u jepet grave brenda partisë/koalicionit tuaj hapësirë e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e tyre? A tregojnë gratë më shumë iniciativë të përfshihen?**

**DANIJEL ZHIVKOVIQ:** Iniciativa ekziston. Tani në këtë mbledhje kryetare e Aleancës së Grave është Drita Lllolla me prejardhje nga Ulqini dhe ka pasur përvojë edhe në sektorin civil, me njohuri shumë të respektueshme që ka marrë në Mal të Zi dhe jashtë Malit të Zi dhe tregon një qasje serioze sa i përket çështjeve të pozitës së grave në shoqërinë malazeze. Së dyti, për sa i përket iniciativës së grave në PDS, ajo nuk ka munguar asnjëherë, ka pasur gjithmonë një nivel të lartë të iniciativës dhe është në rritje të vazhdueshme. Madje është në rritje për sa i përket hapësirës që Aleanca e Grave e PDS-së zë në hapësirën mediatike, si dhe gamës së çështjeve që trajton. Sa i përket përfaqësimit të grave, patëm rastin të shohim se gratë ishin pjesë përbërëse e komisioneve të caktuara në pozita udhëheqëse, ndërsa në mbledhjen e kaluar ishte Daliborka Pejoviq, e cila drejtonte Komisionin për Korrupsion. Çështjet e barazisë gjinore janë në fokus të Komisionit për Barazi Gjinore, por për këtë mund të thuhet më

shumë në disa seminare, sesione, në kuadër të asaj që OJQ-ja ofron për skenën shoqërore dhe publike duke organizuar ngjarje të ndryshme, dhe gratë nga PDS-ja gjithmonë marrin pjesë aktive, sidomos në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare në Mal të Zi me të cilat kanë bashkëpunim të shkëlqyer.

**QAQ: A ka bërë ndonjëherë partia, veçanërisht për këto zgjedhje parlamentare, ndonjë fushatë për këtë çështje, a ka pasur ndonjë përpjekje brenda partisë që publikisht ta problematizojë dhe avokojë më fort këtë çështje?**

**DANIJELL ZHIVKOVIC:** Gjatë kësaj fushate, fokusi ishte në çështjet ekonomike në shumicën e subjekteve politike. Mirëpo, një pjesë e atyre çështjeve ekonomike lidheshin edhe me ndërmarrjen së grave, pra fuqizimi ekonomik të grave, dhe kjo ishte një pjesë e veçantë e programit tonë. Më duket se ne, ku menaxhoni vetëqeverisjet lokale dhamë një inkurajim të veçantë ndërmarrjes së grave. Kam një pasqyrë se si funksionojnë gjërat në disa qeveri lokale dhe si mund të krijohet një histori e suksesshme nga ai nivel. Një histori e suksesshme për sa i përket krijimit të atij programi, ndarjes së fondeve, mbështetjes së ideve të biznesit dhe e kam parë se gratë kanë një numër të madh idesh cilësore që ato i vënë në veprim. Ndonjëherë mund të kesh ide të mirë që nuk mund ta zbatosh, por ajo që kam pasur rastin të shoh në nivelin e vetëqeverisjes lokale, edhe pse janë fonde modeste është se është e mundur të arrihet një qëllim konkret me ato fonde modeste. Pra, ne ishim të përkushtuar edhe për fuqizimin ekonomik të grave. Nga ana tjetër, komunikimi për barazinë gjinore është sigurisht gjithmonë në fokus. Kemi pasur një sërë ngjarjesh në periudhën e kaluar, për të cilat publiku ishte në dijeni, dhe që i shqetësoi të gjithë. Nuk është çështje politike, por çështje më e gjerë sociale që duhet zgjidhur sistematikisht, dhe ndoshta kësaj fushate i mungonte pasqyrimi adekuat mediatik i asaj pjese të programit tonë, si dhe pjesëve për dhunën ndaj grave dhe dhunën e bashkëmoshatarëve. E kemi në program, por ka mundësi që nuk e kemi komunikuar sa duhet në dallim me temat që dominonin.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse është kështu?**

**DANIJELL ZHIVKOVIC:** Çështjet ekonomike janë në qendër të vëmendjes së publikut dhe kjo nuk është çudi, sepse të gjithë pyesin në ditët e sotme se si do të jetë standardi i jetesës dhe cilësia e tyre e jetës. Megjithatë, nuk janë vetëm të ardhurat, pensionet dhe përfitimet sociale ato që përbëjnë cilësinë e jetës. Aty janë edhe çështjet se si do të jetë arsimi, shëndetësia, mjedisi kulturor dhe në të gjitha këto është edhe çështja e barazisë gjinore dhe pjesëmarrja e grave në politikë, pastaj dhuna ndaj grave etj. Nuk bëhej fjalë vetëm për fitimin e pikëve politike, por ndoshta shumica e partive janë fokusuar në atë pjesë të programit që ishte kryesisht interesimi i publikut, me indikacion se ndoshta mund të ishte folur më shumë në këtë fushatë. Dëgjova vërejtje dhe kritika lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut, por edhe për këto çështje, domethënë se gjatë fushatës u fol pak për të. Mund të kishim imponuar një ritëm tjetër, por biseda për atë temë nuk mungoi. Ka mundësi që nuk e kemi paraqitur mirë në media. Mund të konfirmoj patjetër se si bartës i kësaj liste të koalicionit, është dëgjuar nga kolegët e mi që janë marrë me ato çështje dhe i kanë dërguar ato mesazhe. Interesi i mediave ishte padyshim i drejtuar drejt çështjeve ekonomike dhe për këtë segment mund t'i kishim kushtuar më shumë vëmendje, por në periudhën e ardhshme kemi mundësi të korrigjojmë veten.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**DANIJELL ZHIVKOVIC:** E ndoqa edhe atë pjesë sepse i referohej edhe llojeve të ndryshme të skualifikimeve ndaj kolegeve që vijnë nga partia të cilës i përkas. Kemi pasur një sërë reagimesh mediatike për atë temë, si dhe për koleget të partive të tjera që kanë qenë në Kuvend, pra në jetën publike. Nuk mund të pajtohem me vlerësimin se nuk ka empati mashkullore apo se nuk ka solidaritet, mendoj se më shumë ka të bëjë me shfaqjen e atij solidariteti që është vendosur definitivisht në nivel të Kuvendit, edhe atë që kam ndjekur në punën e Klubit të Grave, reagimi ka qenë gjithmonë adekuat, i përshtatshëm për momentin dhe shumë efektiv. Sa i përket reagimeve të kolegëve që ishin në Kuvend apo jashtë, më duket se ka pasur mbështetje në kuptimin që si shoqëri nuk do të bëjmë asnjë hap përpara, të paktën kur flasim për procese demokratike, nëse vazhdojmë të përhapim urrejtje, apo ngjitje etiketimesh dhe skualifikimesh në kurriz të grave që merren me politikë.

Është diçka që duhet të largohet nga diskursi publik. Secili duhet të pyesë veten kur shkruan ndonjë koment apo krijon tekste në hapësirën mediatike për integritetin, dignitetin dhe dinjitetin e një individi, aq më tepër që në diskursin publik nuk duhet lënë të folet asnjë fjalë e tepërt në asnjë kuptim. Gjithçka mund të thuhet me vend dhe ashtu siç e dikton edukata shtëpiake e njeriut dhe jo duke ngulur disa etiketa negative apo skualifikime, për shkak të dallimeve politike, me të cilat dikush duhet të merret tani në hapësirën mediatike. Mendoj se ata që krijojnë një përmbajtje të tillë, si dhe ata që transmetojnë përmbajtje të tilla, mbajnë përgjegjësi të barabartë. Përmbajtjeve të tilla nuk duhet t'u lihet hapësirë në skenën mediatike. Kemi rrjete sociale që janë plotësisht të hapura dhe të gjithë mund të shprehin mendimin e tyre, në shoqëri demokratike nuk ka asgjë të diskutueshme, por problemi lind kur bëhet cenim i të drejtave dhe lirive të të tjerëve dhe kur del jashtë zonës së fyerjeve në zonën e kërcënimeve. Këtu vijmë te problemi ku hyn në lojë pjesa e legjislacionit që parashikon përgjegjësinë penale apo kundërvajtëse.

E di që disa kolege të klubit të deputetëve kanë nisur procedime penale ndaj personave që kanë komunikuar jo vetëm fyerje, por edhe kërcënime të rënda, dhe sot organet kompetente shtetërore veprojnë në përputhje me rrethanat. Më duket se e gjitha është reduktuar në përgjegjësi kundërvajtëse, por kjo nuk mjafton. Sanksioni ekziston për të ndaluar dikë nga kryerja e kundërvajtjes ose veprës penale. Por a është thelbi vetëm në sanksionet, në dënimet e parashikuara nga ligjet tona? Mendoj se nuk është. Mendoj se qëllimi është emancipimi i shoqërisë. Kemi hyrë gradualisht në procesin e emancipimit të shoqërisë malazeze dhe kjo do të vazhdojë dhe do të varet edhe nga ne si bartës të fjalëve publike dhe funksioneve publike në kuptimin se si do të sillemi në skenën publike dhe në jetën politike.

Ne, PDS-ja, shpesh kritikohemi se nuk jemi të shpejtë në përgjigjet tona, se nuk jemi të fortë kur komunikojmë argumentet tona. Dhe kjo jo sepse nuk kemi guxim të themi diçka me fjalë të tjera, por që njerëzit të nxjerrin një mësim nga fjalët tona, për të emancipuar publikun malazez sepse ne jemi pasqyra e atyre që na dëgjojnë dhe na votojnë, të cilët na besojnë se do t'i përfaqësojmë, qoftë në pushtetin legjislativ apo ekzekutiv, ne jemi përfaqësuesit e qytetarëve që duhet të kujdesemi para së gjithash se si drejtohem dhe që secili ka një pjesë përgjegjësi në atë pjesë.

Mua më duket se kjo përgjegjësi ka munguar në periudhën e mëparshme dhe besoj se të gjithë duhet të kujdesen që të komunikojnë diçka pa sensacion dhe pa etiketa, dhe se mund të fitoni një pikë politike apo vëmendje më të madhe mediatike duke shpëtuar atë që ndodhet në anën tjetër. Sipas meje, ky është thelbi, jo vetëm në politikë, por në përgjithësi në jetë.

Këtu kemi ardhur në problem ku ka satanizim serioz, demonizim të grave në politikë, ngjitje të këtyre etiketave dhe nuk është e lehtë për gratë të përballen me këtë.

**QAQ: Si ndikon në ato?**

**DANIJELL ZHIVKOVIC:** Epo, ndikon negativisht, sepse komente të tilla nuk janë të rastësishme. Ndoshta nuk jemi ende në një nivel të mjaftueshëm pjekurie demokratike për të pranuar se secili ka mënyrën e vet të të menduarit dhe këndvështrimin e tij për të parë një situatë të caktuar sociale ose politike.

Mendoj se gratë në Mal të Zi që merren me politikë janë të guximshme dhe se këto komente nuk i pengojnë të merren me politikë. Por, ka mundësi që ky lloj satanizimi të jetë edhe dekurajues për disa gra. Prandaj, nëse nuk punojmë së bashku, në vazhdimësi, dhe ky është proces i gjatë, për ta sjellë situatën në skenën politike në atë nivel, se ka dallime dhe se çdo gjë që ekziston si dallim mund të komunikohet në mënyrë të argumentuar, të kulturuar dhe në mënyrë të edukuar dhe të respektohet mendimi, ideologjia dhe parimi programor të tjetrit përballë nesh, nëse nuk e përvetësojmë atë si parim të përgjithshëm të veprimit dhe funksionimit në politikë, atëherë nuk do të jetë mirë.

Forcimi i pjesëmarrjes së grave në politikë nuk nënkupton ofrimin e një hapësire të caktuar për sa i përket kuotave apo vendeve të caktuara në drejtimin apo menaxhimin e disa proceseve, por do të thotë ofrimin e një mjedisi në të cilin të gjithë do të ndihen mjaft komod për të komunikuar atë që mendojnë.

**QAQ: Kur bëhet fjalë për përfaqësimin e grave në listat zgjedhore, lista e koalicionit tuaj ka 41% gra dhe vetëm një listë kishte rreth 60% gra, ndërsa shumica u përpoqën të plotësonin minimumin ligjor prej 30%. A keni pasur ndonjë problem me këtë dhe a kanë shprehur vetë gratë dëshirën për të qenë në këtë numër?**

**DANIJELL ZHIVKOVIC:** Sigurisht. Siç thashë, iniciativa nuk ka munguar asnjëherë, të paktën për sa i përket PDS-së. Kemi dhe kemi pasur edhe më parë klub kualitet të grave nga klubi ynë i deputetëve, bëhet fjalë për gratë e njohura në jetën publike dhe politike. Nga ky këndvështrim, ne kishim problem sa i përket konceptimit të listës, më vjen keq që nuk kishte më shumë hapësirë në listë që do të kishim ndarë për pjesëmarrjen e grave. Kjo është një çështje e rëndësishme, jo për shkak të kuotave, por për përmbajtjen dhe thelbin sepse gratë janë proaktive, duan të përfshihen në politikë, duan të ndryshojnë mjedisin përmes pjesëmarrjes në lista apo pjesëmarrjes në politikë, për të dhënë kontribut personal dhe vullën për ato ndryshime dhe pjekurinë e shoqërisë demokratike malazeze. Prandaj sfida jonë ishte pikërisht e kundërta, ne mund të bënim edhe dy ose tre lista të tjera. Nuk kam asnjë dilemë dhe po flas përsëri për thelbin, jo për kuotat, se pjesëmarrja e tyre e mëtejshme do të varet ekskluzivisht nga iniciativa e grave dhe nga motivet dhe dëshirat e tyre, sepse dyert e PDS-së janë plotësisht të hapura, flasim gjithmonë për këto probleme, tani kemi hapësirë të mjaftueshme në periudhën në vijim, për të rregulluar gjërat dhe për të rritur pjesëmarrjen e grave në politikë dhe në listat zgjedhore.

**QAQ: Numri i grave në Kuvend nuk rritet nga seanca në seancë dhe do të shohim se çfarë do të sjellë përbërja e ardhshme. A ecim përpara si shoqëri në këtë kuptim, a po piqemi?**

**DANIJEL ZHIVKOVIC:** Unë përsëri i shikoj gjërat pak më optimiste. Mendoj se gradualisht po ecim përpara. Gjithçka varet nga qasja dhe nga mënyra sesi partitë e shohin atë. Për PDS-në mund të them që ne jemi parti emancipuese, sido që ta shikojë politikisht dhe sido ta shikojë PDS-në, ne jemi parti emancipuese që nuk kemi marrë kurrë asnjë vendim në politikën shtetërore që publiku ta pëlqejë atë vendim. Ne u përpoqëm të emancipojmë shoqërinë malazeze me vendimet tona, të cilat nuk ishin aspak të lehta në periudhën e kaluar. Nuk më duhet t'ju kujtoj se si dukej shoqëria malazeze mbase 15 vjet më parë, apo më pak, kur u organizua *Pride* i parë, sa sfiduese ishte, ndaj shohim se gradualisht dhe me kalimin e kohës po ndodhin zhvillime pozitive. Nuk e dimë se si do të jenë gjërat në Kuvendin e ardhshëm dhe në pushtetin ekzekutiv, por mund të ketë tendenca që tregojnë se gjërat nuk ecin përpara.

E shikoj, megjithatë, nga një anë më optimiste, megjithëse ka mangësi të tillë, atëherë është detyrim shtesë që ta korrigojmë, për ne si aktorë të skenës politike. Së dyti, është detyrë e grave që të imponojnë ritëm shtesë ndryshimi në skenën politike, i cili do të kontribuojë në pjesëmarrjen e tyre më të madhe në të gjitha subjektet politike, përfshirë në Kuvend dhe në pushtetin ekzekutiv. Në seancën e mëparshme kishim një grua në krye të Kuvendit, që në këtë kuptim ishte përparim i caktuar. Unë mendoj se progresi duhet parë rrënjësisht dhe në mënyrë cilësore dhe jo formalisht në aspektin e kuotave, këtu nuk bëhet fjalë se kush është përpara e kush mbrapa, të gjithë jemi në të njëjtën linjë dhe të gjithë jemi të barabartë, është shoqëri e mundësive të barabarta që do t'u japin mundësi të barabarta burrave dhe grave sipas cilësive të tyre për t'u imponuar në atë shoqëri.

### **QAQ: Çfarë roli luajnë liderët/et e partisë në fuqizimin e grave?**

**DANIJELL ZHIVKOVIQ:** Liderët kanë padyshim rol të rëndësishëm në të gjithë procesin, nëse flasim për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë. Ne duhet të fillojmë nga mjedisi, së bashku, si drejtues të subjekteve, duhet të kontribuojmë për ta bërë atë mjedis më të mirë. Nga këto 15 lista zgjedhore, njëra listë drejtohej nga një grua, ndaj duhet të përfshihemi edhe në afirmimin e asaj që i motivon gratë të marrin pjesë në politikë, duhet t'i përkushtohemi asaj. Çfare do të thote? Që të nuk mblidhemi për hir të rendit, të diskutojmë disa çështje në ato forume dhe që në fund i lëmë ato forume apo takime pa ndonjë përfundim që do të ketë rezultatin e tyre përfundimtar. Duhet ta vendosim si punë, rend, rezultat, atëherë ai rezultat duhet të ndodhë.

Pra, nëse kemi vërejtur se kemi më pak gra në procesin e vendimmarrjeve, që është një nga sfidat me të cilat përballet shoqëria malazeze, atëherë duhet të shikojmë ta ndryshojmë këtë së bashku. A është rritje kuotash në ligj kur subjektet politike nuk duan të punojnë vetë për këto çështje, ndoshta... Ne e kemi bërë, jo për ndonjë kuotë, por mund të bënim dy tre lista me të gjitha gratë në ato listat, të cilat do të ishin po aq të suksesshme sa kjo listë, ose ndoshta edhe më e suksesshme. Këtë nuk e them në nivel të ndonjë deklarate politike apo fjale boshe, por sepse roli i liderit është ta përcaktojë atë proces në një parti, të forcojë në veçanti rolin e forumit apo aleancës së grave. Më duket se shumica e partive kanë forume të grave në përbërjen e tyre dhe se afirmojnë pjesëmarrjen e grave në politikë përmes kësaj, dhe kur vijmë në momentin e vendosjes për më tej, pra ku gratë mund të gjejnë pjesëmarrje në periudhen në vijim, atëherë patjetër t'u jepet mundësia që të jenë në proces të vendimmarrjes nga pozicionet e caktuara. Ky është në thelb roli i atyre që janë në krye të listës apo partisë - për të fuqizuar një grua duke i dhënë mundësi të jetë kreative e vendimmarrjes në shoqërinë tonë.

## MILLOJKO SPAJIQ, bartës i listës Evropa tani

**QAQ: A e njej partia juaj politike rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Nëse po, si manifestohet në parti/lëvizje? A janë këto çështje tani apo ishin në axhendën zyrtare të lëvizjes?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Absolutisht, kjo çështje është ndër prioritetet tona. Kuptuam se kjo është një nga arsytet pse Mali i Zi është vend i prapambetur ekonomikisht - për shkak të pjesëmarrjes së dobët ose joadekuatë të grave në ekonomi, dhe përdorimit të pamjaftueshëm të atij segmenti, burimeve njerëzore, të neglizhuara dhe krejtësisht të padrejta, për shkak të disa arsyeve tradicionale, patriarkale apo të tjera. Mendojmë se ka një potencial të madh për përparim ekonomik dhe të përgjithshëm shoqëror, përmes aktivizimit ekonomik të asaj pjese të popullsisë në mënyrë adekuate, duke hapur mundësi për të rinjtë dhe gratë me përvojë, të cilët padyshim mund të kontribuojnë shumë në ekonominë dhe zhvillimi social të Malit të Zi.

**QAQ: Ku i shihni arsyet e përfaqësimit të ulët të grave në jetën politike dhe në poste drejtuese?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Mendoj se ka disa arsye. Një prej tyre është mentaliteti tradicional, i cili po ndryshon, por jo aq shpejt sa duhet. E dyta është ndoshta se skena politike malazeze është paksa sensacionale. Në atë rrëmujë krijohet politika më agresive dhe mesazhe sensacionale dëgjohen dhe shihen më mirë dhe transmetohen më mirë nga mediat, të cilët ndoshta kanë interesin e tyre të duan më shumë sensacione, sepse janë më të lexuara. Ndoshta nuk u përshtatet shumë grave dhe duket se burrat ia dalin më mirë në një hapësirë të tillë... Dhe e treta, padyshim që skena politike duhet të jetë shumë më e bazuar në fakte, në disa gjëra që janë progresive, produktive, të cilat janë konstruktive etj., dhe jam i bindur se atëherë do të kishim një përqindje shumë më të lartë të grave të interesuara për të dhënë kontributin e tyre, por edhe interes më të madh jo vetëm të grave por edhe të burrave profesionistë, që kujdesen për imazhin e tyre, integritetin e tyre. Tani kemi problem të madh sepse shumë njerëz të talentuar nuk duan të përfshihen në skenën politike, dhe kjo vlen edhe për gratë edhe për burrat. Thjesht, për shkak të diskreditimeve të mëdha si personale ashtu edhe profesionale dhe të çfarëdo natyre tjetër, kemi edhe pjesëmarrje të ulët të kadrit cilësor në përgjithësi në skenën politike në Mal të Zi.

**QAQ: Kur flasim për këtë lloj diskreditimi të grave, problem i madh është gjuha e urrejtjes në rritje që është përfaqësuar fuqishëm në Mal të Zi ndaj kësaj pjese të popullsisë vitet e fundit. Për zgjedhjet lokale të tetorit 2022, QAQ-ja ka kryer edhe monitorimin mediatik të zgjedhjeve nga perspektiva gjinore. Edhe atëherë kandidatet nga lista e LET-së janë ekspozuar ndaj përmbajtjeve të tilla, sidomos në rrjetet sociale, komenteve me përmbajtje ofenduese, gjuhës së urrejtjes etj. Si e shihni atë?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Kështu është, ato ishin në shënjestër në masë të madhe.

**QAQ: A është dekurajuese, a i demotivonë ata që t'i bashkohen skenës politike?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Absolutisht, sepse gratë e kanë atë presion shtesë, me gjithë diskreditimin që ndodh, për secilën prej nesh që jemi në skenën politike, ato duhen të "dëshmohen" shtesë. Është krejtësisht e padrejtë që atyre u është vënë një barrë e tillë. Mendoj se kjo është diçka që është trashëguar në Mal të Zi dhe shpresoj se do ta ndryshojmë në periudhën e ardhshme.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Çfarë duhet të bëjnë partitë dhe liderët e tyre për të folur më shumë për këtë dhe për t'i bërë këto çështje pjesë të fushatës dhe axhendës së partisë?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Mendoj se është padyshim roli i liderëve që ta drejtojnë punën për këto çështje diku dhe të udhëheqin partinë e tyre dhe shtetin e tyre duke drejtuar narrativën dhe t'i vendosin gjërat ashtu siç duhet dhe në mënyrë të drejtë. Besoj se kushdo që dëshiron të jetë lider në jetën publike duhet të ketë parasysh një potencial të tillë (femëror) të pashfrytëzuar për vendin tonë dhe aktualisht është plotësisht i pashfrytëzuar.

**QAQ: Siç e përmenda, të gjeturat e monitorimit thonë se këto çështje nuk e kanë gjetur vendin e tyre në fushatën aktuale për zgjedhjet parlamentare. Pse është kështu?**

**MILLOJKO SPAJIQ:** Sërish i kthehem atij sensacionalizmi. Është shumë e vështirë të shtysh në media disa tema progresive dhe konstruktive, pa pasur dëshirë për t'i kritikuar. Por, objektivisht, aty ka shumë hapësirë për sa i përket diskursit publik. Sado që t'i theksojmë këto tema, për disa arsye ato mbeten të padukshme dhe duhet të "gërmosh" në disa deklarata tona për t'i gjetur ato. I theksoj shpesh, por mediat thjesht nuk e raportojnë, sepse mendoj se nuk konsiderohet mjaft interesante për lexuesit apo shikuesit, për fat të keq. Dhe mendoj se ky është gabim. Mendoj se mediat duhet të marrin pjesë shumë më tepër në këtë, dhe të njohin interesin social dhe jo

vetëm dëshirën për fitim nga *clickbait* (më shumë klikime në poste), apo cilido qoftë motivimi i tyre.

**QAQ: Në listën zgjedhore për zgjedhjet parlamentare, LET kishte 35% gra. Në atë pjesë, gjatë krijimit të listës, u përballët me ndonjë sfidë, apo gratë treguan interes dhe iniciativë për të shënuar emrin e tyre? A ishin të inkurajuara?**

**MILLOJKO SPAJQI:** Ne kishim problem të madh në atë pjesë. Thjesht, bordet komunale (meqë jemi parti e re) kishin të drejtë të propozonin kandidatë, megjithëse iu tërhoq vëmendja të kishin ekuilibër midis grave dhe burrave. Mund ta imagjinoni që kishte 90% burra dhe 10% gra, dhe atëherë vërtet duheshim, si unë, ashtu edhe i gjithë ekipi, të theksonim seriozisht, të këmbëngulnim, të këmbëngulnim deri në fund që gratë duhet të kenë më shumë dritë dhe më shumë shanse, hapësirë, etj. që më në fund ndodhi.

A mund të jetë më mirë kjo përqindje? Sigurisht që mundet dhe do të jetë më mirë në të ardhmen.

**QAQ: A do të ketë më shumë gra në pozita vendimmarrëse?**

**MILLOJKO SPAJQI:** Absolutisht.

## NIKOLLA GJURASHKOVIQ, bartës i listës PSD – Për shtëpinë tonë

**QAQ: A e njuh partia juaj politike rëndësinë e çështjeve të barazisë gjinore, pjesëmarrjes politike të grave dhe fuqizimit të grave? Nëse po, si manifestohet në parti?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Partia Socialdemokrate e vlerëson çështjen e barazisë gjinore si të rëndësishme. Kjo është gjithashtu e vetmja parti parlamentare që kishte në krye të saj një grua presidente dhe një grua kandidate për presidente. Gratë brenda PSD-së kanë një formë të veçantë organizimi përmes Forumit të Grave, i cili ka programe të ndryshme arsimore për anëtarët, gjë që kontribuon dukshëm në fuqizimin e tyre.

Megjithatë, meqenëse shoqëria jonë është ende thëllësisht patriarkale, rruga drejt pozitave të pushtetit është shumë më e vështirë për gratë sesa për burrat, sepse mbështetja e nevojshme nga familja dhe shoqëria mungon në masë të madhe dhe kolegët e partisë në përgjithësi nuk janë të motivuar të kontribuojnë në pjesëmarrjen e barabartë të grave në politike, sepse ato rrallëherë kanë ndërgjegje gjinore. Si autoritet lokal vendosëm të financojmë edhe qëndrimin e fëmijëve në kopshte, që është një nga logjistikat për përfshirje më të lehtë të grave në jetën politike.

**QAQ: Si e vlerësoni përfaqësimin e ulët të grave në jetën politike dhe në pozitat vendimmarrëse?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Jemi dëshmitarë të fenomeneve të ndryshme në shoqërinë tonë që i dekurajojnë gratë nga angazhimi politikë. Mizogjia dhe seksizmi janë të pranishme edhe në Kuvendin e Malit të Zi. Fenomene të tilla i dekurajojnë gratë të angazhohen politikisht. Dhe nuk mjafton të dënohen publikisht gojarisht bartësit e aktiviteteve të tilla, duhet gjetur mekanizma për të vendosur forma të tjera përgjegjësie për sjelljen e paskrupullit të individëve që duan të nënçmojnë dhe dekurajojnë edhe ato gra që janë shumë të suksesshme në politikë dhe rezultatet e të cilave mund të kanë efekt motivues tek gratë e tjera që të bëhen aktive në politikë.

**QAQ: A janë këto çështje (çështje të përgjithshme të barazisë gjinore dhe pjesëmarrjes politike të grave, por edhe të drejtat e tyre kulturore, sociale, seksuale dhe riprodhuese, fuqizimi ekonomik, lufta kundër dhunës ndaj grave, etj.) tani/apo kanë qenë në axhendën zyrtare të partisë tuaj politike?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Forumi i Grave i PSD-së në vazhdimësi merret me këto çështje. Për momentin, çështja aktuale është "varfëria menstruale", avokatja kryesore e së cilës është deputetja e parë në listën tonë.

**QAQ: A ka bërë ndonjëherë partia, sidomos për këto zgjedhje parlamentare, ndonjë fushatë për këtë çështje, a ka pasur përpjekje brenda partisë për ta bërë publike dhe avokuar më fort për këtë çështje?**

**NIKOLA GJURASHKOVIQ:** Në zgjedhjet e mëparshme parlamentare, ne zhvilluam fushatën, slogani kryesor i së cilës ishte "Gruaja e fortë - Mali i Zi i fortë", kështu që dimensionin gjinor ishte i dukshëm gjatë gjithë fushatës. Ne kishim edhe billboard me atë mesazh, por askush nuk e komentoi, e as sektori joqeveritar. Çështja e varfërisë menstruale është përfshirë në programin tonë politik, gjë që dëshmon se nuk kemi lënë pas dore çështjet e barazisë gjinore. Megjithatë, nuk mund të themi se i kushtojmë hapësirë të mjaftueshme barazisë gjinore.

**QAQ: Kush në parti i ngre këto çështje - vetë gratë apo kolegët meshkuj?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Çështjet e barazisë gjinore gjithmonë inician nga gratë. Burrat besojnë se e bëjnë mirë dhe iniciativa u lihet grave. Temat që janë të natyrës së përgjithshme kanë përparësi.

**QAQ: Pse këto pyetje të natyrës së përgjithshme janë prioritet?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Tashmë e kam vënë në dukje se edhe e kemi provuar një qasje të tillë dhe se nuk ka pasur jehonë në publik, pra nuk ka mundur të sjellë pikë politike. Tashmë temat ekonomike kanë prioritet, pra publiku është më i interesuari për të, madje historia populiste nga sfera ekonomike ka një rezonancë më të madhe se problemi i dhunës ndaj grave, dhuna në familje, apo edhe problemi i dhunës ndaj bashkëmoshatarëve, që kohën e fundit është njohur si problem më i gjerë social.

**QAQ: A është partia juaj e vetëdijshme për pengesat me të cilat përballen gratë që janë ose dëshirojnë të jenë pjesë e jetës publike dhe të zënë pozita të caktuara në politikë dhe shoqëri?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Sigurisht që jemi të vetëdijshëm për disa aspekte, sepse si parti kemi hasur në këto probleme. Reaguam publikisht ndaj shkeljeve të dukshme të të drejtave të njeriut të grave. Në zgjedhjet e fundit presidenciale, presidenti aktual i shtetit kandidaten tonë për presidente e quajti "marxhinale politike", shembuj të ngjashëm ka pasur edhe më parë. Megjithatë, kjo është vetëm një lloj pengese.

Gratë tradicionalisht kanë më shumë përgjegjësi në familje se burrat dhe kjo perceptohet si problem personal dhe jo social. Përveç kësaj, gratë janë statistikisht më të arsimuara se burrat. Një numër më i madh i tyre kryejnë studimet master dhe doktoraturë, por e gjithë kjo nuk mjafton për përfaqësim të barabartë në pozitat vendimmarrëse.

**QAQ: Si është mjedisi për pjesëmarrjen politike të grave brenda partisë suaj dhe a u jepet grave hapësirë e mjaftueshme për të shprehur pikëpamjet e tyre brenda partisë suaj?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** PSD-ja edhe me statut lejon të drejtën e një mendimi tjetër dhe askush nuk mund të mbajë pasojat për këtë. Megjithatë, burrat janë më dominues në imponimin e temave dhe në mbrojtjen e pozicioneve, sepse teknikat e ndryshme të dominimit janë më afër burrave sesa grave. Gratë dorëzohen më lehtë për shkak të "paqes në shtëpi".

**QAQ: Çfarë keni bërë, brenda partisë, dhe tani si bartës i listës, për të motivuar/frymëzuar/inkurajuar gratë që të angazhohen më shumë dhe të flasin publikisht?**



**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Së pari, unë kam qëndrim afirmativ ndaj angazhimit politik të grave në politikë dhe mendoj se është shumë e rëndësishme që personazhet publike të afirmojnë vazhdimisht një qëndrim të tillë në publik për të inkurajuar sa më shumë gra. Në ekipin tim ka një numër të madh grash dhe kështu do të jetë edhe në të ardhmen. Gjithmonë do të angazhohem për mbrojtjen e të drejtave të grave që të jenë të lira për të bërë punën që duan dhe me daljet e mia publike gjithmonë do t'i mbroj gratë pavarësisht nga orientimi politik, sepse mendoj se jemi ende, për fat të keq, në situatë të tillë shoqërore që fillimisht duhet të kristalizojmë qëndrimet e zyrtarëve publikë në mënyrë që e gjithë shoqëria të përparojë gradualisht.

Le të fillojmë me gjërat elementare - qëndrimet personale, dhe pastaj të rregullojmë bashkërisht mjedisin legjislativ dhe të përgjithshëm shoqëror.

**QAQ: A organizon partia juaj trajnime, seminare për lidhshimin apo në ndonjë mënyrë tjetër edukon anëtarët/et e saj për barazinë gjinore dhe çështjet e lidhura me to?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Ka shumë programe trajnimi dhe edukimi të llojeve të ndryshme. Trajnimet organizohen nga Forumi i Grave dhe Aktorëve Ndërkombëtarë (Fondacioni Friedrich Ebert, Westminster Foundation for Democracy, IRI). Gratë janë të gatshme të punojnë të përparojnë. Sipas informacioneve të mia, ata janë duke punuar edhe për plan strategjik që besojnë se do të përmirësojë pozicionimin e tyre në parti, por aktualisht është në ndërprerje për shkak të aktiviteteve në këtë dhe në fushatën e mëparshme.

**QAQ: Çfarë force dhe ndikimi ka Forumi i Grave i partisë suaj?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Forumi ka rol të rëndësishëm në çështjet *gender*. Gratë janë të organizuara në forume lokale dhe të ndërlidhura me Forumin e Grave në nivel qendror. Ato ndërtojnë me sukses besimin dhe mbështetjen e ndërsjelltë. Megjithatë, jo të gjitha organizatat lokale janë njësoj të forta. Unë njoh forcë të veçantë në Forumin e Grave të Cetinës, Podgoricës dhe Plavës. Aktivizimi i tyre ka rëndësi të madhe për PSD-në.

**QAQ: Në numrin më të madh të rasteve, në të 15 listat zgjedhore për zgjedhjet e ardhshme parlamentare, gratë përfaqësohen pothuajse në masën minimale të kërkuar nga ligji. Pse është kështu?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Shoqëria malazeze është ende thellësisht patriarkale, që do të thotë se burrat janë në krye, jo vetëm në shtëpi, por edhe në skenën politike. Është mirë që ligji përcakton përfaqësimin e nevojshëm të grave, të paktën 30% të kandidatëve, pra të paktën një grua në çdo katër kandidatë, dhe nëse nuk do të ishte kështu, gratë do të ishin më pak të përfaqësuara në listat zgjedhore.

**QAQ: Pse nuk kishte më shumë gra në listën tuaj?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Për të njëjtat arsye si në listat e tjera. Burrat janë thjesht më dominues dhe më këmbëngulës në luftën për pozicionet e tyre. Ndërgjegjësimi gjinor nuk është pika jonë e fortë, edhe pse ne si parti socialdemokrate duhet të jemi avangardë edhe në këtë çështje, por kjo nuk ndodhi as në këto zgjedhje.

**QAQ: Sipas jush, cilët janë mekanizmat për përfshirje më të madhe të grave në politikë, dhe për forcimin e lidhshimit femëror në politikë, dhe ku e shihni ju pengesën më të madhe?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Fatkeqësisht, asgjë pa zgjidhje ligjore që do të rrisin kuotat dhe do të sigurojnë një shpërndarje më të mirë të grave në lista. Për më tepër, do të ishte mirë që burrat dhe gratë të edukoheshin së bashku për çështjet gjinore, sepse është e qartë se burrave nuk u jepen lehtësisht postet e pushtetit.

**QAQ: Pse nuk kemi më shumë lidere?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIC:** Gratë bëhen lidere me përpjekje dhe sakrificë të mëdha, ky rregull nuk vlen për burrat. Një grua si lidere është nën vëzhgimin e publikut, duke filluar nga pamja e saj, përmes narrativës e deri tek efektet e saj në pozicionin që mbulon. Shoqëria ka imponuar standard shumë më të lartë për një lidere grua sesa për një lidër burrë. Për më tepër, fenomenet shoqëruese si mizogjinia dhe seksizmi i demotivojnë më tej gratë për të luftuar për lidërsip. Askush nuk do të komentojë mënyrën e veshjes së burrit, edhe nëse, për shembull, ishte e papërshtatshme në momentin e caktuar, ndërsa gruaja duhet të jetë gjithmonë në lartësinë e detyrës për të shmangur ndjesi të pakëndshme. Një fjalim i keq publik shumë vështirë i falet një gruaje sesa një burri. Ne thjesht jetojmë në kontekst social ku është shumë më e vështirë të jesh lidere sesa lidër.

**QAQ: A ka mes vetë votuesve të ashtuquajturin seksizëm votues, pra vendosmëria e votuesve për të votuar për një burrë dhe jo për një grua, nëse po, pse është kështu?**

**NIKOLA GJURASHKOVIC:** Ne jemi të gjithë votues ose votuese dhe nuk ka ndonjë dallim të madh mes asaj se çfarë është skena publike dhe çfarë do të bëjmë kur të vendosim për kë të votojmë, përveç se anakronizmi në çështjen e zgjedhjes për kë të votojmë është më i fortë tek shumica e votuesve, sepse tradicionalja është ende përpara kuptimit bashkëkohor dhe modern të gruas dhe rolit të saj në shoqëri dhe politikë.

**QAQ: Si ndryshon ky ndërgjegjësimit tek votuesit?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIC:** Media është një nga mekanizmat kyç. Gratë kanë nevojë për mbështetje mediatike. Politika editoriale, të paktën në shërbimin publik, duhet të trajtojë çështjen e pranisë më të madhe të grave në media dhe të përcaktojë standarde që do të kontribuojnë në barazinë gjinore. Ndosht që disa media të nxisin mizogjininë dhe seksizmin duke publikuar përmbajtje të caktuara. Këtu duhet të ndërhyjë shteti përmes zgjidhjeve ligjore. Përmbajtja arsimore në sistemin formal duhet të orientohet drejt ndërgjegjësimit për çështjet gjinore që nga mosha parashkollore e në vazhdim, përmes të gjitha cikleve të tjera arsimore.

**QAQ: Hulumentimet tregojnë se gratë janë më të besueshme kur bëhet fjalë për fusha të tilla si arsimit, shëndetësia, edukimi, politikat sociale dhe burrat në fusha të tilla si siguria kombëtare, lufta kundër kimit, mbrojtja, etj. Mendoni se kjo duhet ndryshuar dhe në këto poste duhet të emërohen gratë profesionale dhe të kualifikuara për të tejkaluar këto stereotipe të tilla?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIC:** Hulumentimet vetëm konfirmojnë stereotipet. Nuk e mbështes një qasje të tillë sepse në këtë mënyrë do të thellojmë stereotipet dhe duhet t'i zhdukim ato. Nuk mendoj se dimensionin gjinor e profilizon dikë më shumë për të bërë punë të caktuara vetëm pse është burrë apo grua. Këto janë programe të rrënjësura thellë në kokën tonë që duhen fshirë, por nuk mund të bëhet me shtypjen e një butoni. Këto janë procese që do të zgjasin dhe që do të varen nga demokratizimi i përgjithshëm i shoqërisë dhe që do të lëkunden.

**QAQ: Si mund të kontribuojnë burrat brenda partive dhe çfarë veprimesh duhet të ndërmarrin për të rritur nivelin e pjesëmarrjes politike të grave?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIC:** Barazia gjinore nuk përparon gjithmonë në mënyrë të barabartë, ka ngecje dhe momente të ndritshme dhe kjo nuk është e panjohur për partinë tonë. Por është e nevojshme lufta e vazhdueshme për pozicionim më të mirë të grave në parti. Disa veprime afirmative në favor të grave mund të japin rezultatin e dëshiruar. Për shembull, udhëheqja e bordeve lokale, përfaqësimi në organet partiake në nivel qendror (Kryesia dhe Bordi Kryesor) në fakt mund të zgjidhin problemin e pozicionimit më të mirë të grave në pozitë vendimmarrëse

në parti. Pas zgjedhjeve parlamentare do të kemi Kongresin dhe shpresoj se mund të shkojë në atë drejtim.

**QAQ: Deri më tani, brenda partisë suaj, a keni pasur ndonjë strategji të zhvilluar që burrat do t'i adresonin për të reduktuar pabarazinë gjinore dhe për të promovuar pjesëmarrjen e grave?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Fatkeqësisht, nuk u morëm me këtë problem. Sipas njohurive të mia, gratë janë duke punuar në strategji që do t'i pozicionojë më mirë në parti.

**QAQ: Në vitet e fundit, gjuha e urrejtjes, komentet mizogjene, seksiste dhe fushatat negative të drejtuara ndaj grave në jetën politike dhe publike kanë qenë veçanërisht të theksuara. Edhe pse hulumtimi ynë tregon se në ditët e para të fushatës për zgjedhjet parlamentare është shënuar progres i caktuar në atë pjesë, disa media kanë vazhduar të bëjnë fushata negative kundër disa grave nga parti të ndryshme. Megjithatë, pothuajse vetëm gratë dolën në mbrojtje të kolegeve të tyre. Pse është kështu dhe pse meshkujt nuk e shohin këtë si problem?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Dënimi verbal publik i gjuhës së urrejtjes, komentet mizogjene dhe fushatat negative nuk mjaftojnë për të parandaluar ose minimizuar dukuri të tilla. Një sjellje e tillë e individëve dhe e mediave që e promovojnë duhet të sanksionohen nga shteti. Është mirë që gratë të dënojnë dhe komentojnë publikisht sjellje të tilla si të papranueshme, por nuk është mirë që burrat mos ta bëjnë të njëjtën gjë. Unë nuk jam ithtar i maksimës se çdo gjë lejohet në politikë dhe e dënoj me të vërtetë thellësisht edhe pse nuk kam folur për këtë.

**QAQ: Hulumtimi i QAQ-së tregon gjithashtu se në media, vetëm 2% e kohës dhe hapësirës në fushatën aktuale i kushtohet çështjeve të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave? Pse mendoni se është kështu?**

**NIKOLLA GJURASHKOVIQ:** Partitë vlerësojnë se cilat tema janë të rëndësishme për përparimin e mëtejshëm të shoqërisë dhe çfarë mund t'u ofrojnë votuesve potencialë përmes fushatës, sipas burimeve njerëzore në dispozicion dhe burimeve të shoqërisë. Ne iu afruam kësaj fushate në mënyrë të tillë. Problemet në arsim, shëndetësi, bujqësi dhe çështje të tjera ekonomike kanë prioritet në këtë fushatë, sepse ne kemi zgjidhjet më të mira për to. Të gjitha këto çështje, veçanërisht arsimit dhe shëndetësia, përfshijnë edhe dimensionin gjinor, por nuk është veçuar si prioritet.

# Rekomandime për raportimin mediatik të grave në proceset zgjedhore

1. Trajtimi i barabartë nënkupton që kandidatet të trajtohen në të njëjtën mënyrë në media si kandidatët. Mediat duhet të shmangin çdo diskriminim, komente seksiste apo stereotipe që mund të dëmtojnë integritetin dhe dinjitetin e grave në politikë;
2. Mediat, në raportimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore, duhen të paraqesin programin zgjedhor dhe synimet politike të të gjithë kandidatëve/eve në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga gjinia. Ndër të tjera, kjo përfshin fokusimin në platformën politike të listave zgjedhore dhe kandidatëve që përfaqësojnë atë, në vend të pamjes së një gruaje në politikë apo statusin e saj martesor, e të ngjashme;
3. Mediat duhen të kujdesen që të sigurojnë pjesëmarrje përafërsisht të barabartë të grave dhe burrave në intervista, debate, deklaratat dhe komente, të cilat mund të ndikojnë në mënyrë stimuluese për gratë në politikë për të paraqitur pikëpamjet e tyre politike në debate publike;
4. Raportimi mbi temat e pabarazisë gjinore, sfidat, paragjykimet, shembujt negativë dhe praktikatat e këqija me të cilat përballen gratë në politikë mund të rrisë ndërgjegjësimin e publikut dhe të pozicionojë më mirë rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në jetën politike të Malit të Zi;
5. Raportimet sensacionale për gratë në politikë që do të nxisnin stereotipet dhe perceptimet negative duhet të eliminohen dhe të evidentohen publikisht si shembull negativ i mbulimit mediatik, dhe mediat duhen të fokusohen në informimin për çështjet politike me rëndësi publike për të cilat flasin gratë;
6. Organizatat joqeveritare dhe mediat duhet të forcojnë kapacitetet e gazetarëve/eve (punëtori, seminare, etj.), dhe të përmirësojnë të kuptuarit e çështjeve të barazisë gjinore në mënyrë që të kontribuojnë në raportimin më të ndjeshëm për gratë në politikë;
7. Mediat duhen të kenë një dozë rishikimi autokritik përmes vlerësimeve të rregullta të raportimit të tyre për gratë në politikë, në mënyrë që ato vetë t'i përmbahen më shumë parimeve të barazisë gjinore dhe mekanizmat e vetërregullimit të brendshëm të mediave mund të ndihmojnë shumë në këtë drejtim;
8. Të gjithë aktorët/et duhen të njohin dhe në deklaratat e tyre publike më shpesh të theksojnë rëndësinë e përfshirjes së plotë dhe barazisë së grave dhe burrave në demokratizimin e shoqërisë,

dhe duhet të punohet më shumë brenda partive për ndërgjegjësimin gjinor, duke filluar nga rëndësia e portretizimit jostereotip të figurave femërore në hapësirën publike e deri te pengesat që qëndrojnë në rrugën e përfshirjes së barabartë të grave në vendimmarrjen politike;

- 9.** Vetë aktoret e fushatës zgjedhore, kryesisht kandidatet dhe bartëset, duhen të përdorin më mirë median dhe hapësirën publike në dispozicion të tyre për të reklamuar mesazhet e tyre politike ose të përgjithshme që mund të forcojnë ndërgjegjësimin e qytetarëve/eve kur bëhet fjalë për barazinë gjinore, dhe posaçërisht pjesëmarrjen politike të grave. Ekziston gjithashtu vend për edukimin e anëtarëve/eve të partive politike për rëndësinë e përdorimit të gjuhës së ndjeshme gjinore në paraqitjet në media, si dhe mënyrat për t'i përdorur ato paraqitje publike në mënyrë më efektive;
- 10.** Organizatat joqeveritare duhen të monitorojnë raportimin e mediave dhe aktivitetet në rrjetet sociale, për të kontribuar në edukimin dhe profesionalizimin e gazetarëve, por edhe për të kufizuar deklaratat mizogjene në rrjetet sociale duke vendosur komunikim me moderatorët e atyre rrjeteve (Facebook, Twitter, , etj.).





